

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË
INSTITUTI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

MITRUSH KUTELI NË
100-VJETORIN E LINDJES

Tryezë shkencore, 8 qershor 2007



PRISHTINË
2007

**KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS
SECTION OF LITERATURE AND LINGUISTICS**

**THE ACADEMY OF SCIENCE OF ALBANIA
INSTITUTE OF LITERATURE AND LINGUISTICS**

**MITRUSH KUTELI -
THE 100-TH ANNIVERSARY OF BIRTH**

Round Table, June 8, 2007

EDITORIAL BOARD

Enver Gjerqeku, Ali Podrimja, Eqrem Basha



**PRISHTINA
2007**

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË
INSTITUTI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

MITRUSH KUTELI NË
100-VJETORIN E LINDJES


Tryezë shkencore, 8 qershor 2007

KËSHILLI REDAKTUES

Enver Gjerqeku, Ali Podrimja, Eqrem Basha



PRISHTINË
2007



PËRMBAJTJA

<i>Sabri Hamiti</i>	
AUTORI: UNI I SHUMËZUAR (RASTI I KUTELIT).....	7
<i>Alfred Uçi</i>	
ESTETIKA BRENDA RRËFIMIT KUTELIAN	17
<i>Sali Bashota</i>	
TREGIMTARIA E MITRUSH KUTELIT (ngjarja, personazhi, rrëfimi).....	37
<i>Nasho Jorgaqi</i>	
MODELI KUTELIAN I RRËFIMIT	47
<i>Atalanta Pasko Pekmezi</i>	
MBI DISA NDRYSHIME NË GJUHËN E KUTELIT NË BOTIME PAS VITIT 1967 – KRIJIME ORIGJINALE E PËRKTHIME	53
<i>Enver Gjerqeku</i>	
MITI NË “TREGIMET E MOÇME SHQIPTARE” TË MITRUSH KUTELIT	65
<i>Behar Gjoka</i>	
PROZA REALITET LETRAR I MËVETËSISHËM.....	73
<i>Ali Aliu</i>	
MITRUSH KUTELI PËR POEZINË E LASGUSH PORADICIT ...	79
<i>Pandeli Pasko Kuteli</i>	
VËSHTRIM MBI SHPREHJEN E NDJESIVE SHQIPTARE PËR FE NË VEPRËN E KUTELIT.....	85
<i>Mehmet Kraja</i>	
MBI DISA VEÇORI TË VEPRËS “E MADHE ËSHTË GJËMA E MËKATIT...” E MITRUSH KUTELIT	99
<i>Sadik Bejko</i>	
NJERIU NË PROVËN E MËKATIT DHE TË NDËSHKIMIT TE TREGIMET “ATË SERGEJ” I L. TOLSTOIT DHE “E MADHE ËSHTË GJËMA E MËKATIT” I MITRUSH KUTELIT	103

Kujtim M. Shala

ELIPSA: VEPRA LETRARE E MITRUSH KUTELIT..... 111

Spiro Gjoni

KUTELI PROZATOR, POR... EDHE POET..... 121

Sabri HAMITI

AUTORI: UNI I SHUMËZUAR
(RASTI I KUTELIT)

1. Autori

Në vitet gjashtëdhjetë të shekullit të kaluar Rolan Barti pat shpallur (metaforikisht) *vdekjen e autorit*. Kjo më parë si klithmë për autonominë e tekstit, duke përjashtuar vlerën e intencës autoriale në tekst, qoftë si tendencë ideografike, qoftë si motivim psikobiografik. Sipas kësaj, përfundimisht, në tekst edhe idetë edhe *psikë* – ja (bota shpirtërore) janë prodhime strukturale të tekstit e jo shenja intencionale të autorit. Kjo teori e zhvilluar deri në skaj, më duket që është më tepër revoltë e hapur strukturale kundër “funksionit” të letërsisë, për të përjashtuar edhe “funksionin” e autorit në letërsi. Diçka si përfundim: “teksti shkruhet vetë”.

Po, çka të bëhet me autorët shqiptarë, misionarë në jetë, shoqëri e letërsi, për motivimet personale të tyre, për shkrimet personale, për shkrimet autobiografike, madje autoideografike? Po kujtoj këtu Jeronim de Radën, Naim Frashërin, Gjergj Fishtën, Fan S. Nolin, Lasgush Poradecin, Ernest Koliqin, për t’u ndalur këtë herë në rastin e Mitrush Kutelit.

Para një decenieje, duke shkruar për tekstet autobiografike të Mitrush Kutelit, kam hetuar që autori në këto shkrime është i shpallur, i afishuar, madje është shfaqur në *tri vetje*, në mënyrë të veçantë në veprën *Sulm e lotë*, të botuar më 1944. duke zhvilluar temën, në rastin e Kutelit, sot mund të provohet që *autori* shfaqet si *unë* i shumëzuar në *shumë vetje* e *shumë funksione*, jo vetëm në letërsinë e tij autobiografike, por në gjithë veprën e tij fikSIONALE e jofiksionale, duke përfshirë të gjitha format letrare.

2. Autori: shkrues i vetvetes

Në veprën *Sulm e lotë* autori shumëzohet në tri vetje: një racionale (Dr. Pas) dhe dy pasionale (Izedin Jashar Kutrulija e Mitrush Kuteli), kurse të tretë bashkë e japin Dhimitër Paskon si krijues të letërsisë. Sipërtheksimi i autorësisë këtu shkon shkallë-shkallë, duke zbuluar, madje, natyrën individuale identifikuese të secilës vetje me kreaturën e vet letrare.

D. Pas provon e saktëson që Izedin Kutrulija është autori i *Poemit Kosovar*, sepse njëjtësohet me heroin e poemës, për t'u bërë vetë esenca e saj: me pamjen, gjuhën, ritmin e të folurit e idetë, për të përfunduar që ky është një vetje epike. Dr. Pas provon e saktëson që Mitrush Kuteli është autori i *Poemit të Shëndaumit*, sepse njëjtësohet me ndodhinë e me dhembjen e pafund, për të përfunduar që ky është një vetje lirike. Pra, njëri është *sulm* e tjetri është *lot*.

Vetë Dr. Pas, që niset si vetje racionale, i studion dy të parët dhe veprën e tyre, duke u njëjtësuar me ta sado që artikulon dallimet e tyre, duke u shpallur si *alter ego* e tyre, kurse vetveten e gjen të njëjtësuar me ta në elementin e përbashkët që është *mistika e tokës shqiptare*.

Në këtë mënyrë në veprën *Sulm e lotë* autori dëshmon që është shkrues i vetvetes, në të tri trajtat e afishuara, qoftë kur shkruan për mistikën e përhershmerinë shqiptare.

Kujtesa është tekst autobiografik i shkruar më 1965. Teksti në dukje është racional, po në thelb mbetet tekst pasional. Qëllimi i tekstit është që t'i ikën *normës* shoqërore për të bërë *punë krijuese*. Mirëpo, në gjithë zhvillimin e vet ky tekst e shfaq paradoksin e madh: shkruhet për vetveten, por kjo destinohet për të tjerët, prandaj nisin të peshojnë plumb censura e autocensura, sa për ta zbuluar më thellë esencën. Kuteli evidenton gjeste e grimca pune të kaluar që do të tumireshin nga skema ideologjike e adresantit, po në të njëjtën kohë duke projektuar punën e vet të ardhshme (për përjetësitë) shqiptare ai zbuloi që nuk do ta përfillë këtë ideologji:

...do të përpiqem që t'i bëj që të flasin varret e lashta ilire, gurët e kështjellave tona të moçme...

Censura ishte kaq e ditur e dinake, që autori duke folur për vetveten po zbulohet me gjithë “naivitetin” e vet, se po shkruante vetveten dhe se nuk kishte shpëtim nga *norma* e nga *sistemi*.

Testamenti, i shkruar para vdekjes, është shkrim për veten, por tani me destinim për të dashurit, familjen, prandaj është kaq i hapur e kaq i dhembshëm. *Kam punuar shumë, kam dashur shumë, kam gabuar shumë*, shkruan Kuteli me sinqeritet të madh, ndërsa krejt teksti dëshmon se *ka vuajtur shumë*. E mbyt frika se nuk do të kuptohet ndonjëherë (mbas vdekjes), e mundon droja çka do të bëhet me gruan e fëmijët, të cilëve u lë në trashëgim ëndrrat e veta. Duke përshkruar zinë personale, Kuteli me shenja të shpejta bën portretin e ambientit, që prodhon injorancë, moskuptim e mosdurim. Prandaj, ai hyn përfundimisht në vetminë e në mallkimin e artistit, duke i përjashtuar të gjithë, përveç të dashurve të zemrës. Pena e tij shkruan për rrezikun e suksesit në provincë, duke shqiptuar frazën tragjike e të përzishme *Gjaku ujë s' bëhet...po bëhet qelb*.

Teksti është përjashtues, është një lamtumirë për jetën, është një përshkrim i vdekjes. Ai tashmë porosit ku e si të varroset, kush të jetë në varrim. Kështu fundi i tekstit është një *Kryeshkrim* (shkrim në gur të varrit).

Për nga natyra *Testamenti* është teksti autobiografik, që prek ekstremet, po ky i Kutelit prek thellësitë e territ e të zisë. Them kështu duke pasur parasysh, jo më njeriun, por artistin, kur nuk mund ta kursejë më askënd, as vetveten. As fëmijët, sepse ky mesazh i zbuluar nuk i dhemb askujt sa të dashurve të zemrës.

3. Autori: shkruet i ndodhisë

Lehtë është të identifikohet autori në shkrime autobiografike apo në poezi, që për nga lloji i diskursit është origjinarisht personale. Po si duket ky në prozë, sidomos në prozën me pretendime realiste (qoftë ky realizëm magjik), që nënkupton një neutralitet. Si konstruktor suprem i tekstit apo si kontraktues i lexuesit. Kemi parasysh që Kuteli prozat e veta i cilëson: si *rrëfime* (tregime) kur rrëfente të ndodhurat e jetës, e si *rrëfenja*, kur mbështeteshin në një rrëfim të parmë mbi të ndodhurën. Këto fenomene mund të kapen në dy novelat e tij

antologjike: *Vjeshta e Xheladin Beut e E madhe është gjëma e mëkatit*, duke ditur më parë që e para është *jetëshkrim*, kurse e dyta *shpirtshkrim*. Njëra ka të bëjë me trupin e tjetra me shpirtin, njëra me shkrimin realistik e tjetra me shkrimin imagjinar.

Novela *Vjeshta e Xheladin Beut* fillon në stilin elementar realist, ku teksti pretendon të thotë të vërtetën, kurse autori të dëshmojë besnikërinë e tij ndaj saj:

As vetë Xheladin Beu nuk dinte përse ndiente një zbrazëtirë aq të madhe në zemër atij mëngjesi vjeshte të dytë...

Po kjo novelë përfundon me një pikëpyetje të madhe autoriale, ku dëshmohet tërheqja e tij nga statusi i autorit të gjithëdijshëm:

Po Gurija ç'u bë?

Ku Ta dish...

Xheladin Beu e Gurija janë dy personazhet kryesore të novelës. I pari është përshkruar e ndërtuar me precizitet, duke kapur të tashmen e të kaluarën e tij, por të zhvilluar në ritmin dramatik të krizës. Njeriu, që nga beu ëndërron të bëhet pasha, që fuqi ka pasurinë po që nuk njih moralin, që pushtohet nga grykësia e posesiviteti, bie në krizë në çastin kur kupton që po plakët dhe që nuk ka trashëgimtar. Kjo krizë e tij e treguar në novelë, në mënyrë dramatike përfundon me çmendje e vdekje. Dhe ky është dënim moral, në trajtën e *qëndrimit autorial* të paafishuar.

Në anën tjetër Gurija, vajza e re e haremit të tij, është në krizë, se ka mbetur shtatzënë, duke mos njohur jetën dhe duke u frikësuar se do të flijohet, sepse po të bëhet nënë do të tretë funksionin lidhur me Xheladin Beun.

Pra, mosmarrëveshja është e madhe, tragjike. Marrëveshja do të ishte zgjidhje: beu fiton trashëgimtar e Gurija bëhet grua e nënë. Po, autori nuk e do këtë zgjidhje, as logjika e zhvillimit të tregimit nuk e duron këtë zgjidhje. Xheladin Beu duhet të pësojë, thotë moraliteti kutelian i pashpallur, dhe këtu autori është i sigurt në logjikën e vet.

Mirëpo, abstenon të shohë zgjidhjen për Gurijen, sepse ka frikë që bëhet i pabesueshëm përpara vetes e lexuesit. Për Gurijen ai ka vetëm një pikëpyetje, shtron enigmën e pazgjidhur. Dhe këtu, pikërisht këtu, ku pretendon që largohet nga teksti, ai është strukturalisht më i pranishëm se kudo tjetër.

Kjo tërheqje e prani e njëkohshme e autorit sugjeron tipin e leximit e të interpretimit të lexuesit, që krejt teksti i novelës *Vjeshtha e Xheladin Beut* të mund të interpretohet si një alegori për diktatorin, që nuk duhet të ketë trashëgimtar. E, pra, pyetja logjike mbetet në fund: *Po Gurija ç'u bë?*

4. Autori: kontratë me lexuesin

Prania e autorit, si dëshmitar i neutralitetit, si provues i tekstit të vetëmjaftueshëm, apo si kontraktues i besueshmërisë e marrëveshjes (pëlqimit) me lexuesin, del sheshit në novelën *E madhe është gjëma e mëkatit*. Tat Tanushi është i pushtuar nga mrekullia: nga dashuria për Zotin e dashuria për gruan, Kalien (shqip: Bukurijen). Por Tanushi rrëshqet në mëkat, qëkur brenda tij dy dashuritë rivalizojnë njëra-tjetrën. Dhe ai pëson dënimin e dyfishtë: i vdes Kalija, dhe Zoti e dënon me jetë. Mëkati i tij bëhet përtejshkullor kur ai bëhet krijues: e gdhend fytyrën e të dashurës në trajtë të ikonës. Tanushi vuan dhe fiton më në fund hirin e Zotit, dhe atëherë ai s'është më trup, po tretet e bëhet shpirt para syve të njerëzve. Tanushi është, pa dyshim, heroi autobiografik i Kutelit, modeli i krijuesit, që me veten personale do të përballojë normën universale, dhe kjo është e pazakonshme, është njerëzore dhe është heroike, se me gjestin e merr përjetësinë.

Mirëpo, ne duam të kthehemi te elementariteti i temës sonë. Autori tanimë në pëlhurën e tekstit rrjeton praninë e vet si kontratë e marrëveshje me lexuesin, për t'u bërë i afërt, për t'u bërë i besueshëm, për t'u bërë ndërmjetësi pasionant i një tregimi të moçëm (legjende) te dëgjuesi i ri, te lexuesi i ri. Këto ndërhyrje herë kanë trajtën e plotësimit të kuadrit të njohjes, herë të artikullimit të qëndrimit për të thënë e të dhënë, herë për të sugjeruar një mënyrë të leximit:

Këtë e kanë për të parë lëçitësit në qoftë se do të kenë durimin të këndojnë rrëfimin që do t'ju shtrojmë përpara.

....

Po veç kësaj, me sa di unë, të dashur lëçitës, dashurija nuk është as e bardhë, as e zezë as tjetër ngjyrë, po vetëm dashuri dhe asgjë tjetër. Ajo është si era: fryn kudo vetë dhe ne i dëgjojmë buçitjet.

....

Për ata që nuk dinë ne po u themi se Shpellat edhe Manastiri i shenjtë gjenden buzë liqenit të Ahridës, rrëzë malit që quhet Mal i Thatë.

Autori (tanimë Kuteli) heton dramacitetin e ndryshimit të tregimit gojor në tekst të shkruar dhe jep çelësin e ndërtimit (poetikës) së novelës *E madhe është gjëma e mëkatit* ku strukturohen harmonishëm diskursi popullor me diskursin biblik, që do të jetë dhe bazë e poetikës së prozës së tij në përgjithësi, duke krijuar dy diskutet themelore të saj.

5. Autori: rishkrues i letërsisë

Shqiptimi i pastër i statusit të autorit, tanimë jo si *krijues*, por si *rikrijues*, shfaqet në shembullin e Kutelit te vepra *Tregime të moçme shqiptare* (1965). Autori e pranon statusin e autorit të dytë duke rikrijuar tema e struktura letrare nga letërsia gojore shqipe: qofshin *balada, këngë të kreshnikëve* apo *përralla*. Mjeshtëria e shkrimit të dytë apo e shkrimit të **rishëm** provohet, para së gjithash, duke e kthyer tekstin e folur në tekst të shkruar, duke e kthyer autorin anonim në autor të fiksuar real, dhe duke transformuar trajtën e vargut në trajtën e prozës.

Ky fenomen i rikrijimit letrar e fitoi legjitimitetin letrar vetëm mbas paraqitjes së shkrimtarit argjentinës Horhe Luis Borhes, ndonëse u duk më herët, madje edhe te krijuesi ynë.

Këtë fenomen letrar e teorizoi deri në konsekuencat e fundit teoricieni francez Zherar Zhenet në veprën e vet të famshme

Palimpsestet: letërsia në shkallën e dytë, madje duke e rigjetur fenomenin thellë në kohë në letërsinë e Evropës.

Teoria e tekstit të parë dhe të dytë apo e *hipotekstit* dhe *hipertekstit*, në deceniet e fundit ka marrë ngjyrimin vendës në kulturën shqipe, duke përmbysur kuptimin (pejorativ) të ndikimit, që po sundonte për sa decenie të përparshme.

Kuteli është i pari ndër ne që derivimin letrar e bëri vepër në mënyrë sistematike, ani që këtë fenomen nuk arriti ta teorizojë, siç ka bërë në raste të tjera.

6. Autori: Kryeshkrimi

Autorin, në trajtën rezonuese e në trajtën pasionale, e gjejmë te Kuteli kritik dhe te Kuteli poet i orëve të fundit. Autori në vitin 1943 shkroi dy tekste të jashtëzakonshme: *Vargje mbi gurë varresh* dhe *Në Prizren, midis të vdekurve e të gjallëve*. Shkrimet në gurë të varreve, në vështrimin e formës i pagëzoi *Kryeshkrime*. Emri përmban kuptimin e dyfishtë: shkruhen te kryet (e varrit) dhe janë shënime të dendura që në formë të shkurtër japin një jetë, apo vështrimin e një jete. Dhe më tutje, një lloj shkrimi, që do të jetë njëherësh dokument dhe monument, në vështrimin e dëshirës, që do të bëhet përhershmeri. Edhe më tutje, simbas kërkimit të Kutelit, këto *kryeshkrime* nuk dëshmojnë vetëm një jetë, por paraqesin dhe një identitet kulturor. Dhe, kah fundi, nga statusi i teksteve subletrare kthehen në tekste letrare.

Kuteli, si nxënës i largët i formalistëve rusë (sidomos Tinjanovit) me idetë e veta të çuditshme, edhe pse jo të zhvilluara deri në fund, as që e dinte që po bëhej një ndërmjetës kah strukturalistët frëngë të viteve gjashtëdhjetë të shekullit njëzet, që zhvilluan teorinë e kalimit të formave letrare periferike në qendër.

Kryeshkrimi si formë letrare ka disa karakteristika: është formë shumë e shkurtër, lidhet me një njeri konkret, përmban shenjat themelore të kësaj jete dhe ajo, që është themelorja, artikulon raportin e drejtpërdrejtë tragjik të jetës e të vdekjes. E shkruan i gjalli për të vdekurin, duke mëtuar të rikrijojë esencat e jetës së të vdekurit, por duke u përpjekur që t'i ngjajë atij, të identifikohet me të. Ndodh që i

vdekuri për të gjallë të sugjerojë tekstin e *kryeshkrimit* për veten. Ndodh që kryeshkrimi të marrë dhe trajtën universale, për aq sa jeta me vdekjen ndeshen dhembshëm kudo, dhe për aq sa kryeshkrimi, në fakt është një komunikim ndërmjet të gjallëve dhe të vdekurve, apo më gjerë të jetës me vdekjen. Ende jemi në zonën e heshtjes e të qetësisë.

Por, çka kur kryeshkrimin e shkruan njeriu për vetveten, çka kur shkruasi është autor i madh, çka kur Kuteli e shkruan *Kryeshkrimin* e vet në ditët e fundit të jetës së vet. Dhe ky mban atë statusin e dhembshëm, tragjik e të pandërmjetshëm, ku kurrgjë më s'është fantazi, po ndodhi e parajetuar (përjetuar): personale e empirike:

*O ju që mbeti pas në jetë
Të fle në liri – të fle i qetë
Harresën dua...
Këtu tani jam mirë
Shumë i dëlirë,
Me peshën e dheut tim mbi mua.
As imi s'jam. As juaji, por mosgjë,
Gjithnjë gjumash që nuk bën zë,
U ktheva prapë si isha nisur
Në amzën time ku qesh stisur.
Ku rrojta, vujta – por njëmend
Nuk ndjej, nuk vuaj, se s'jam gjësend,
Veçse një tingull...
O ju që mbeti pas në jetë,
Bini tingullit si të doni vetë...
Askush s'ju mban dorën kurrë
Hithni gurë, hithni gurë!*

Kjo është poezia personale në shkalën sipërore si monolog i vetmisë, në udhën kah mosgjëja, qetësia e harresa. Por, teksti paradoksalisht dramatizohet, duke kërkuar që nga monologu të

kthehet në dialog, qoftë nëpërmjet vargut të mbështetur në invokacion (grishje, thirrje) të të gjallëve, që përsëritet dy herësh:

O ju që mbeti pas në jetë.

Një invokacion jotradicional: nuk griset as Zoti, as Engjëlli, as Muza, as Zana, griset Njeriu. Kjo është thirrja që i bën Vdekja Jetës (nga përtej varrit), duke ruajtur mallin e saj.

Një ndodhje, që bëhet poezi, pastaj dokument, pastaj monument i Poetit. Kujtesë e Kutelit.

7. Autori i zbuluar

Në njëqindvjetorin e Dhimitër Paskos, ne pohojmë një dëshmi njerëzore, në të vërtetë zbulojmë autorin, krijuesin me të gjitha *unë*-t e tij të shumëzuar, në librat, në shkrimet e tij. Pra, Kuteli gjendet në botën letrare që ka krijuar, por autori gjendet aty shumëfish i strukturuar edhe si botë e vetvetes, kur i fshehur, kur krejt i zbuluar. Loja me shpirtin është loja më e rëndë, këtë e dëshmon më së miri Kuteli, me jetën e vet, që bëri vepër deri në çastet e fundit. E gjejmë autorin në veprën e tij, në stilin e tij.

Stili është Vepra. Jo, stili është Njeriu.

LITERATURA

1. Roland Barthes, *La mort de l'auteur* in *Oeuvres Complètes* III, Seuil, Paris, 2002.
2. Mitrush Kuteli, *Sulm e lotë*, Rilindja, Prishtinë, 1997.
3. Mitrush Kuteli, *Vera letrare* 1, Naim Frashëri, Tiranë, 1990.
4. Mitrush Kuteli, *E madhe është gjëma e mëkatit*, Grand prind, Tiranë, 2006.
5. Mitrush Kuteli, *Shënime letrare*, Botim i autorit, Tiranë, 1944.
6. Sabri Hamiti, *Mitrush Kuteli; Krijuesi pasional; Tregimi i dashurisë; Kujtesa e Mitrush Kutelit* in *Letërsia moderne* 8, Faik Konica, Prishtinë, 2002, f. 605 – 656.

7. Mitrush Kuteli, *Kujtesa e përkthenjësit Dhimitër Pasko* (Mitrush Kutelit, 1965, *Hylli i Dritës*, nr. 3–4).
8. Mitrush Kuteli, *Testamenti*, 1965 (?), *Hylli i Dritës*, Tiranë, 1994.
9. Gérard Genette, *Palimpsestes, la littérature au second degré*, Seuil, Paris, 1982.

Prishtinë, Dita e Shëngjergjit, 2007

Alfred UÇI

ESTETIKA BRENDA RRËFIMIT KUTELIAN

Kohët e fundit janë shtuar studimet kritike rreth veprës letrare të Dhimitër Paskos, prirje pozitive kjo, aq më fort që gati të gjithë përmendin e pranojnë ekzistencën e një “**estetike kuteliane**”, (siç është folur për “estetikë *lasgushiane*”, “estetikë *fishtiane*”, “estetikë *naimiane*”, “estetikë *migjeniane*” etj.), por kjo s’do të thotë se janë përcaktuar qartë gjithë vlerat origjinale të saj. Tani janë mënjanuar në përgjithësi disa nënvlerësime, që lidheshin me të kaluarën, por në mendimin e sotëm kritik ka shenja të një prirjeje, në dukje si të kundërt me nënvlerësimet e mëparshme, të një mendimi kritik ende të pakonsoliduar mjaftueshëm, që i vendos *veprat konkrete letrare* nën një breshëri “**izmash**”, një “koktej” syresh që, në fund të fundit, i minimizon, i redukton ato thjesht në *shembuj ilustrues* të një morie konceptesh teorike abstrakte, konceptesh të vërteta në vetvete, por të nxjerra nga përvoja kohësh e praktikash të tjera letrare, kryesisht të gjysmës së dytë të shek. XX, të cilat e thërrmojnë copa-copa, e atomizojnë **tërësinë** e strukturës estetike të veprave të përsosura letrare të autorëve tanë; kështu ndodh sidomos, kur elementet e këtij instrumentari konceptual aktivizohen si kallëpe Prokursti, të mbështjella me “lodra fjalësh” pa kuptim, me klishe xixëlluese të zbrazëta, në mos për më keq, për të fshehur mungesën e analizës konkrete me ndihmën e fjalive absurde, por tejet pretencioze. Të tilla procedime të kujtojnë barnat e hidhëta farmaceutike, që mbështillen me një cipë të ëmbël me ngjyra feksëse, të dobishme sidomos për sëmundje adoleshence ose amatoreske të mendimit kritik. (Ja një shprehje të këtij tipi:”*Pentagrami prizmatik njëmbëdhjetë rrathësh, tashmë i ferrit mbitokësor, pra si kundërvënie totale, në të gjithë pejëzitet ekzistencialë, si për të sjellë te qenia me një lëvizje të*

pakushtëzuar objektin e vetëm dhe absolut që është universi” dhe që na tregon se ç’është letërsia, e formuluar qysh herët prej Sartrit”?!).

Unë mendoj se nuk është kjo rruga më produktive e më e saktë për të arritur në *rivlerësime* të mëtejshme e njohje të thelluar edhe të veprës letrare të Kutelit; përkundrazi, metodologjikisht ka përparësi të nisesh e të mbështetesh **së brendshmi** në krijimtarinë konkrete, prej së cilës mund të nxirren konkluzione *estetikisht të vetëmjaftueshme* e madje me rëndësi universale. E them këtë, sepse në kritikën bashkëkohore vërej mjaft raste kur ndiqet një rrugë e kundërt, që subjektivisht synon glorifikime “të reja”, por zbaton *së jashtmi* “terma” me etiketa kinse të fjalës së fundit të “modernitetit”, duke shpërfillur *origjinalitetin e mirëfilltë* dhe *veçoritë individuale* të krijimtarisë të Kutelit e autorësh të tjerë madhorë, të cilët pak nga pak të gjithë autorët tanë të mirënjohur tranvestohen me të njëjtin petk të “modernitetit” të papërcaktuar qartësisht. Kjo është një “lojë”, që braktis vlerat e mirëfillta estetike të autorëve tanë, duke kryer akte servilizmi për nder të disa teoricienëve të spikatur, që s’kanë nevojë për lavdërime foshnjarake. Teoricienëve, që herë pas here i braktisin vetë krijimet e tyre teorike, duke kaluar në pozicione të reja teorike.

Tubime, si ky i sotmi, do të duhej të ndihmonin edhe në përcaktimin e instrumentarit teoriko-metodologjik të mendimit bashkëkohor kritik, që ndihmon për të bërë edhe rivlerësime kritike aspektesh ende të panjohura të letrarëve tanë krijues. Po sjell disa shembuj. Na duhet të arrijmë në një kuptim të qartë e pak a shumë të përbashkët në mendimin kritik e estetik të kuptimit që futim jo vetëm në konceptet e “modernitetit”, “modernes”, “bashkëkohores”, por edhe të “realizmit”, që përdorej prej kohësh në mendimin kritik e teorik letrar. Unë kam vërejtur se disa kritikë këtë term e përdorin për të shënuar kryesisht ose vetëm *realizmin kritik* të Balzakut, Stendalit, Floberit, Tolstoit, Dostojevskit, Dikensit, domethënë autorësh kryesisht të shek. XIX. Ndonjë kritik nuk gjen asnjë dallim midis “realizmit” dhe “realizmit socialist” dhe të dy këto koncepte i quan si “diçka të ndotur”, e kjo nuk ndihmon të kuptohet drejt as i pari, as i dyti. Por, në këtë rrugë mbeten jashtë jo vetëm vepra dinjitoze *realiste* të letërsisë dhe të arteve tona, por edhe të vendeve të tjera të shek. XX-XXI. Po kështu termi “sociologjizëm”, përdoret shpesh si nofkë, për të meta, por harrohet se një pjesë e pandarë dhe e rëndësishme

pozitivisht e estetikës moderne, bashkëkohore është *estetika sociologjike*, e cila nuk bën të identifikohet me “sociologjizmin vulgar” ose variantet e tij.

Përmenda vetëm pak terma, për ta konkretizuar rëndësinë që ka problemi i semantikës të instrumentarit të mendimit tonë kritik bashkëkohor, përndryshe, keqkuptimet e paragjykimet me dashje ose pa dashje nxitin rrëshqitje në skaje, nga ku shtohen grindje e sherre, që duket sikur nuk na mjaftojnë ato që po na servir me bollëk politika shqiptare; të paktën kritika letrare le të tregohet e pavarur tashmë nga batërdia e luftërave politike, ideologjike dhe të përqendrohet në *katarsisin* e vetes së vet dhe të fushës ku “militon” ose, më mirë, ku mendon e gjykon për letërsinë dhe artet.

S’ka dyshim se cilido studiues, që niset për të analizuar një vepër konkrete artistike, ka një *këndvështrim* të tij *teorik, metodologjik*; pa një të tillë përgatitje më mirë njeriu të mos i hynte fare profesionalisht kritikës, e cila s’bën të paraqitet si “vitrinë teorike” e performansë zbukuruese “miqësish klanore” ose kallëpesh të jashtme ndaj letërsisë sonë. Në qoftë se pranohet se ka vërtet “**estetikë kuteliane**”, ajo ekziston *brenda* në krijimtarinë e tij konkrete, të gjallë, individuale dhe nuk i vjen së jashtmi si një tërësi shembujsh të ndonjë doracaku shkollaresk mësimor ose për të provuar “erudicionin” teorizant të predikuesve të saj. Atëherë, cilat janë, sipas mendimit tonë, tiparet qenësore, që e bëjnë së brendshmi të vetëmjaftueshme “**estetikën kuteliane**”?

1. Cilido që ka shkruar për krijimtarinë letrare të Dh. Paskos ka përmendur lidhjen e saj të ngushtë me **folklorin**, të cilin e njihte shumë mirë dhe e adhuronte, por më përfaqësuese për estetikën e saj shfaqet sidomos te rrëfenjat, pamfletet dhe tregimet, të ngarkuara me motive e figuracion përrallor, pjesë që përbën një dukuri unike në letërsinë shqipe, që vazhdon të jetë më e pëlqyera edhe tani. Kuteli e ka çmuar lart përvojën estetike të folklorit dhe kjo gjë e afronte me letërsinë e Rilindjes kombëtare, ndonëse u zhvillua nja tre-katër dekada më vonë. Me frymën liridashëse, humanizmin, atdhedashurinë e demokratizmin e tij, Kuteli është, *nga njëra anë*, vazhdues i *idealeve të Rilindjes Kombëtare*, të cilat në kushtet e pavarësisë nuk kishin gjetur realizim të plotë. *Nga ana tjetër*, M. Kuteli, ndryshe nga

shkrimtarët rilindës, shfrytëzoi përvojën e një pjese të folklorit, që nuk ishte përdorur prej tyre, përdori sidomos elementet e *kulturës gaztore popullore*. Ai dëshmoi me këtë se, ndonëse e vonuar në kohë, për arsye të veçanta historike, çdo letërsi kombëtare nuk mund t'i shmangë e “t'i djegë” disa etapa e drejtime të rëndësishme të letërsisë botërore, një prej të cilave ka pasur lidhje me përvojën estetike të kulturës gaztore popullore (Bokaçio, Rable, Servantes, Shekspir etj.). Disa krijime si “Vjeshta e Xheladin beut”, “Xha Brahua i Shkumbanares” etj. dëshmojnë aftësinë e tij për ta konceptuar jetën nga pozitat e estetikës së *realizmit social*. Por shumica e krijimeve të tij, që përbëjnë pjesën më origjinale, më të papërsëritur e më të pëlqyer, del tej caqeve e kufijve të kësaj estetike; me këtë pjesë Kuteli nuk ka qenë kthyer prapa në platformën e iluminizmit ose të romantizmit, nuk u është përshtatur madje as formave të ezauruara të realizmit të mëparshëm, por ndërtoi e afirmoi një lloj realizmi modern të shek. XX, që e kemi quajtur “*realizëm grotesk*”.

2. Dikujt nuk i ka pëlqyer termi “*realizëm grotesk*”, madje e ka konsideruar shprehje “*sociologjizmi vulgar*”(?!) dhe, në vend të tij, ka sugjeruar, si një konkluzion të ri të tij, termin “*realizëm magjik*”. Me këtë rast duam të përmendim se termi “*realizëm grotesk*” nuk është shpikje artificiale imja; aq më pak, e sajuar për të fshehur kinse “*sociologjizmin*”; këtë term e ka përdorur për herë të parë studiuesi i mirënjohur Mihail Bahtin (M. Bakhtine - *L'Œuvre de François Rabelais et la culture populaire au Moyen Age et sous la Renaissance*. Paris, 1970) dhe A. Gureviç (*Les catégories de la culture médiévale*, Gallimard, 1983). Prandaj s'është aspak korrekte që nuk i referohet artikullit tim (1992) të revistës “Kultura Popullore”, në të cilin termi “*realizëm grotesk*” për ne ka pasur pak a shumë kuptimin që ka edhe termi “*realizëm magjik*”, në kufijtë e të cilit edhe shpërfaqet “estetika kuteliane”. Përse autori pret vitin 2003 për të na kujtuar se paskemi shkruar për Kutelin? Prandaj detyrohemi të citojmë se qysh në atë artikull të 1992-ës, të ribotuar edhe herë të tjera, ne kemi shkruar:

“Në përgjithësi, krijimtaria e Kutelit, sidomos rrëfenjat “Lugetërit e fshatit tonë”, “Fshati im e pi rakinë”, “Rusa-Papusa”, “Kryengritje për lugat” etj., mund të karakterizohen si një lloj

“realizmi grotesk”, që përbën një variant të realizmit modern të shek. XX. Ky cilësim nuhaste diçka të veçantë në krijimtarinë letrare të Kutelit, sidomos atë pjesë të saj, që paraqitet si më pak e zakonit për traditat e deriatëhershme të letërsisë sonë. Me këtë variant Kuteli nuk ka qenë kthyer prapa në platformat e iluminizmit ose të romantizmit, nuk u është përshtatur as formave të ezauruara të realizmit të mëparshëm. Veçoria kryesore e këtij realizmi qëndron, nga njëra anë, në lidhjen e ngushtë të tij me kulturën popullore, me folklorin, me përvojën e tyre estetike, me historinë e jetën e mëvetshme kombëtare, duke shtruar probleme universale të ekzistencës njerëzore përmes kësaj përvoje, të përthithur në mënyrë krijuese brenda letërsisë të kultivuar. Nga ana tjetër, veçoritë e këtij varianti, që mund të quhet edhe “realizëm magjik”, janë kushtëzuar estetikisht nga përfytyrimi mbi një “realitet të zgjeruar” të artit. Realiteti estetik, me të cilin merret M. Kuteli, nuk përkon me përfytyrimin iluminist, i cili e ngushtonte dhe e varfëronte botën në frymën e racionalizmit, duke pranuar si objekt të artit vetëm ose kryesisht atë çka e pranonte arsyeja “e kulluar” dhe përjashtonte prej tij gjithçka që nuk përkonte me të vërtetën racionale shkencore. Këtë “ngushtim” të objektit të artit e vëmë re edhe në krijimet me frymë didaktiko-racionaliste të disa shkrimtarëve iluministë të Rilindjes sonë Kombëtare.

M. Kuteli përfshinte në objektin e artit edhe shumë gjëra që nuk pranohen për realitet as nga shkenca, as nga arsyeja e shëndoshë. Në objektin e artit ai përmbliidhte, përveç dukurive të rëndomta të realitetit, edhe invencionet e konvencionet artistike (simbole, aludime, hiperbola, grotesk etj.), produktet e fantazisë e të imagjinatës, madje edhe paragjykime, iluzione, besëtytni, ëndrra e dukuri të tjera, që e zgjerojnë konceptin e realitetit, e objektit të letërsisë artistike. Megjithëkëtë, Kuteli nuk vjen në këto pozita si një romantik i vonuar. Tjetër burim ia pati imponuar atij këtë koncept. Ai përvetësoi përfytyrimin e një “realiteti të zgjeruar”, që e bart folklori, kultura popullore, e cila përfshin në tërësinë e qenies atë që është, që ka qenë, por edhe që mund të jetë; përfshin të vërtetën e natyrës, por edhe të shpirtit, forcën krijuese jo vetëm të së parës, por edhe të imagjinatës, fantazisë, atë që është e mundshme, por edhe atë që është virtuale e deri e pamundshme. Në këtë kuptim, kur Kuteli sajon tregime me lugetër e fantazma, me hiperbolizime groteske e me trillime

*përrallore, me paragjykime e besëtytni, kjo nuk mund të shikohet e të vlerësohet si largim nga realiteti, nga problemet e kohës, si varfërim i përmbajtjes sociale të artit, si largim nga realizmi, pra, si kufizim. Përkundrazi, Kuteli në këtë rrugë ka afirmuar një trajtë të **realizmit magjik**, duke e pasuruar konceptin estetik të realitetit në art me krijimtari origjinale letrare të kombit tonë”.*

Duke e cilësuar krijimtarinë letrare të Kutelit “realizëm grotesk” ose “realizëm magjik” jo vetëm nuk ulet shkalla e vlerësimit estetik të saj, por as rrëshqet drejt imitimit thjesht të realizmit kritik të shek. XIX. Ne mendojmë ndryshe, se realizmi në trajta të reja moderne vazhdoi të ekzistojë dhe ekziston edhe në kohën tonë dhe nuk e ka humbur vitalitetin novativ, që nuk i pat munguar Kutelit, i cili qysh në kushtet e Shqipërisë të viteve 20-40, krijoi një variant origjinal të “realizmit magjik”, *pararendës*, në krahasim me variantin latino-amerikan që nuk ekzistonte e nuk njihej në kohën kur jetoi e krijoi Kuteli as si koncept teorik, as si praktikë artistike, e kjo i bën nder atij dhe letërsisë shqipe, duke e përfshirë në proceset e afirmimit të letërsisë evropiane moderne të shek. XX. Dhe në këtë kuptim është absurde të mendosh se ai paska ecur në rrugën e Markesit, Asturiasit, Borhesit ose të ndonjë përfaqësuesi tjetër të “realizmit magjik” latino-amerikan, pale pastaj të Sartrit, Kallerit, Todorovit, Ekos, Fromit, Kalvinos ose procedimeve numerike aritmetike dhe abeceiane të zberthimit kirurgjikalo-anatomik në fjali të shkëputura, të cilat e vrasin tërësinë strukturore organikisht dhe estetikisht të organizuar. Copëzimi sipas kësaj metode kirurgjikale i tregimit të mrekullueshëm “Lumi i madh”, që një ziliqar në kohë të largëta e çoi në burg Kutelin edhe për “faj” të “*formalizmit*” të këtij tregimi, do ta vdiste bukurinë e tharmin, sharmin e lezetin estetik të tërësisë estetike të tij dhe sidomos fuqinë emocionuese ekspresive të tij.

3. Pasi e përthithim veprën letrare të M. Kutelit në rrjedhat e “realizmit magjik”, na duhet t’i japim përgjigje problemit të *mëvetësisë, origjinalitetit estetik të variantit kutelian të këtij realizmi*, çka nënkupton zberthimin e *thelbit të stilit të tij të veçantë*, duke pasur parasysh ato elemente përbërëse, që Dh. Pasko i ka quajtur qenësore në strukturimin e stilit artistik në përgjithësi. Duke hulumtuar vlerat

brenda veprës kuteliane, tharmin e mëvetësisë estetike të veprës së Kutelit e kemi parë jo thjesht e vetëm në lidhjen e ngushtë të saj me folklorin, që e kanë pasur edhe shkrimtarë të tjerë, por në faktin se *idetë estetike dhe tematika e subjekteve të prozës së tij përkojnë kryesisht me atë sistem idesh e me atë tematikë që bart folklor, domethënë me estetikën e folklorit*. S'ka shkrimtar tjetër shqiptar që në një kuptim ta ketë ngushtuar qerthullin tematik të krijimtarisë së vet në atë të folklorit aq sa M. Kuteli. Ky konstatim provohet jo vetëm me krijime të tilla, si “Tregime të moçme shqiptare” dhe “Përralla”, që mbështeten tërësisht në lëndë folklorike, fushë ku spikat mjeshhtëria e Kutelit për të krijuar *përrallën letrare shqiptare*, të lartësuar artistikisht.

Lënda folklorike përcakton edhe përmbajtjen e një grupi tjetër krijimesh, siç janë “Netë me përralla në fshatin e qepëve”, “Xinxifilloja” etj., në të cilat Kuteli ka bërë një **shartim origjinal, estetikisht produktiv** të lëndës së mirëfilltë folklorike (të përrallave, që rrëfejnë teto Ngjela dhe e bija, Fija, e të stilizuara nga shkrimtari) dhe të lëndës me tematikë jetësore të kohës, me tematikë aktuale ekstrapolklorike. Struktura tërësore e “Netëve me përralla...” nuk mund të qëndronte si vepër krejt e pavarur; në të lënda përrallore mund të qëndronte edhe e shkëputur nga ato ndërhyrje, intermexo, biseda e dialogë, që ndërpresin ose ndërmjetësojnë rrjedhën e rrëfimeve dhe të përrallave, duke sjellë jehonën e atmosferës shoqërore e psikologjike të jetës shqiptare në vitet ‘30.

Kurse në *grupin e tretë* të krijimeve të M. Kutelit përfshihen **tregimet e rrëfenjat** (tek të cilat nuk mungojnë frymëzime dhe ide estetike nga folklori), por ato dallohen, sepse kanë gjithë tiparet, veçoritë dhe epërsitë estetike të *krijimtarisë artistike të kultivuar*. Në to spikat krijimi dhe interpretimi estetik i ekzistencës njerëzore në kapërcyellin e një bote në *muzg*, në perëndim, të pasigurisë e shqetësimeve, por edhe paralajmërimeve të një të ardhme, të pritme në *agim*, shpresash të ndritshme, paksa të mjegullta, të turbullta e frikësuese, që po trondiste themelet, deri atëherë të patunduara, të jetës patriarkale. Tregimet e rrëfenjat e Kutelit prekin temën e plagëve sociale të periudhës së fundit të feudalizmit, të jetës patriarkale, temën e kurbetit e të mallit për vendlindjen, temën e dashurisë së lumtur ose fatkeqe, temën e jetës së njeriut të punës e të psikologjisë së tij, temën

e qenies së njeriut në momente e situata ekzistenciale. Fati tragjik i njeriut dhe gëzimet e jetës, situatat dramatike, luftërat e përpjekjet e popullit për liri, dinjitet, për nder e drejtësi, jeta baritore e njeriut të fshatit me mentalitetet, besëtytnitë, paragjykimet e tij, me kërkesat materiale, trupore e shpirtërore, morale, në raportet e tij me të kaluarën historike dhe me shpresat për të ardhmen - të tilla ishin parapëlqime tematike të Kutelit.

Këndi i autorit në vështrimin estetik të jetës rindërton botëkuptimin e botëpërjetimin, që bart masa anonime krijuese e folklorit, me sinqeritetin e naivitetin e saj, me ndjenjën e drejtësisë e të solidaritetit, të dinjitetit e të ndershmërisë popullore. Jeta e shthurur e sundimtarëve me zakone mesjetare, me arbitraritet, të pabesë e të poshtër, të pangopur e të pacipë, të egër e çnjerëzorë, por pa të ardhme, është përqeshur e stigmatizuar nga krijimet e bukura të M. Kutelit. Për jetën e kaçakëve që nuk duronin zullumet e pushtetit e që parapëlqenin të bridhnin e të luftonin të lirë maleve, duke marrë në mbrojtje vegjëlinë e të drejtat e saj (“Netë qershori”, “Si u takua Ndoni me zallorët” etj.), për vuajtjet e mërgimit e të nizamllëkut, që përcilleshin me tragjedi, që i vidhnin vendit rininë, popullsinë më vitale, që prishnin zakonet e traditat popullore, që fushnin zakone të tjera, së bashku me tragjedi e drama, që përcillnin thyerjen e mënyrës së mëparshme tradicionale të jetës (“Xha Brahuja i Shkumbanës”, “Qetësi përpara fërtyme” etj.), për zakone të mbrapshta, të egra e barbare si gjakmarrja (“Gjonmadhë e Gjatollinj”), për gjitha aspektet e jetës fshatare me të mirat e të këqijat e saj, me mundimet e gëzimet e trupit e të shpirtit (“Natë kallozheku”), për festat e ritet popullore (“Rusa-Papusa”, “Kryengritje për lugat”, “Fshati im e pi rakinë” etj.), për përfytyrimet morale e mendësitë e vegjëlisë (“Qysh e gjeti Ago Jakupi rrugën e Zotit”, “E madhe është gjëma e mëkatit etj.). M. Kuteli merrte nga folklori vetëm motivin e idenë e përgjithshme tematike, që i ndizte shkrimtarit frymëzimin fillestar, pastaj, përmes imagjinatës, forcës inventive, autori i konkretizonte, i mbushte si skeletin me mish e jetë të gjallë, me përshkrime, dialogë, urime, mallkime, betime, përgëzime, humor etj., që e kishin prejardhjen nga burimet e ligjëritit popullor – gjithë ky ristrukturim i lëndës artistike realizohet sipas frymës së **“estetikës kuteliane”**.

4. Në “estetikën kuteliane” shpërfaqet e fuqishme edhe mjeshtëria e jashtëzakonshme për ta ndërsuazuar materialin jetësor folklorik brenda përfytyrimeve të “*kohës së mbyllur*”, që është karakteristike për zhanre të tilla, siç janë: *rrëfimet mitike, përrallat fantastike dhe epika legjendare*. Sigurisht, aktivizimi i principit të “kohës së mbyllur” nënkupton në përgjithësi mjeshtëri dhe përsosmëri epore artistike. Kuteli përpiquej me vetëdije të plotë t’i mbështillte gjithë ngjarjet, situatat e veprimet, motivet e personazhet me tisin e një kohe të kaluar, të një të shkuare përrallore dhe eterne. I detë estetike Kuteli i aktualizonte kryesisht në trajtën e *kujtimeve* për një kohë të largët. *Mënyra legjendarizuese, përrallore e të rrëfyerit* përbën një nga *gjetjet më të rëndësishme estetike* të tij, që e ndihmoi formatimin e stilit të tij të mëvetësishëm artistik.

Kjo mënyrë rrëfimi nuk ishte një huazim i thjeshtë formal e i jashtëm, por ngjizej brenda konceptit të “*realitetit të zgjeruar*” të artit; ajo lindte nga nevoja për të përfshirë në objektin e artit jo vetëm atë që është, por edhe atë që mund të kishte qenë, edhe invencionet imagjinare, virtuale, edhe konvencionet artistike. Kuteli i ndërtonte me vetëdije të plotë tregimet e rrëfenjat sipas principit e formulës së fillimit dhe të mbylljes së përrallave, formula që theksojnë *karakterin konvencionalo-artistik* të përmbajtjes së tyre. (“*Qe dhe s’qe*”; “*Ishte dhe nuk ishte*”; “*Na ishte njëherë një i mirë me mall e gjë shumë e na bënte dasmën e të birit*” (“Natë muaji maj”); “*Asaj kohe, kur flisnin dallëndyshet edhe kocominjtë, kur të Bardhat rrëmbenin njerëz, kur kuajt kishin krahë e fluturonin si shpesëri*”(“Babalja”); “*Kështu ishte asohere: muaji lypsej të hynte e të dilte me një gjë të shënuar. Maji hynte me Ereminë, delte me Rusicat*” (“Rusa-Papusa”); “*Kam parë e s’kam parë vite të begatshme, po mot si atë kur lashë të shtatat e mora të tetat, s’kam parë e s’kam dëgjuar*” (“Natë vjeshte të tretë”); “*Asaj vere...*” (“Natë qershori”). Edhe kujtimet e fëmijërisë së shkrimtarit jepen të përrallëzuara, të ndërsuazuara në strukturën e një kohe të mbyllur. Në trajtën e rrëfimeve *mitologjike* ndërtohen rrëfimet: “Lugetërit e fshatit tonë”, “Kryengritje për lugat” etj. Në trajtën e legjendave ndërtohen edhe rrëfimet “Natë muaji Shëmitër”, “Më kot...”, “Natë marsi” etj., që kanë një material jetësor me karakter disi historik. Edhe krijimeve të tjera Kuteli u imponon stilin e rrëfimeve përrallore, duke i inkuadruar në një kohë të largët, të mbyllur.

Kujtimet përbëjnë *substancën* e shumicës së krijimeve në prozë të Kutelit.

Në tregimet e rrëfenjat e Kutelit mungon koha e sotme, por mbizotëron e shkuara, e kryera; e tashmja ndeshet vetëm në trajtën e saj historike. Kur autori e identifikon veten me rrëfyesin, kujton gjithsesi ngjarje të harruara, që të largojnë fort nga e tashmja, që kanë ndodhur shumë kohë më parë ose që kanë qenë rrëfyer gojë më gojë ose nga ata që s'rrrojnë më (“Ç’më pat shkrepur në fiqir një pyetje: - Vallë, ku gjendet këtij moti ky Argjiri ynë, Argjiri Vlonjati?”). Kështu nisnin rrëfimet për ngjarje të së kaluarës. Edhe ngjarje, që duket se janë pranë bashkëkohësisë, vishen me vello lashtësie, mjegullohen e i afrohen “kohës eterne”. Përrallëzimi i materialit jetësor realizohet nga shkrimtari edhe duke përfshirë në të ngjarje të *jashhtëzakonshme, befasuese, të çuditshme e të pabesueshme*, që nuk ndodhin më në jetën e rëndomtë e që mund të inkuadrohen vetëm në një botë e në një kohë mitiko-përrallore.

Konceptit të “kohës së mbyllur” i nënshtrohet edhe prirja për t’i lidhur ngjarjet me muajt e me stinët ciklike, që përsëriten e që na largojnë nga e tashmja. Në tregimet, vendi i gjerë që zënë subjektet e motivet për festat e motmotit dhe popullore (“Vjeshta e Xheladin beut”, “Natë muaji Shëmitër”, “Natë kollozhegu”, “Natë marsi”, “Natë prilli”, “Natë qershori”, “Natë vjeshte të tretë”, “Natë muaji maj”), duket sikur autori e thekson besimin në kohën e mbyllur, që përsëritet si ciklet e kalendarit popullor. S’ka në krijimet e Kutelit ngjarje e veprime konkrete historike, s’ka lëvizje njëlineare historike. Rrjedha e tyre mbledh copëra, fragmente kohore të ndara, i përfshin brenda kohës së mbyllur përrallore, ciklike, rrethqarkulluese. Jeta, e zhveshur nga konkretësia historiko-kronologjike, afrohet me substancën e kohës eterne. Konceptin e kohës së mbyllur përrallore e përforcon edhe stili i mbylljes së tregimeve të Kutelit, që është gjithashtu stil përralle: “Kaq të më kujtosh ti e të tjerat t’i them unë vetë”. (“Lugetërit e fshatit tonë”); “Edhe sot e kësaj dite, kur i kujtoj këto të gjitha, më duket sikur më shtyp krahërorin një gur mulliri me rreth hekuri”. (“Vendosa të shkoj në mërgim”); “Edhe i morën që të gjithë së bashku me djalthin e vogël për ne ajo botë tjetër, ku s’ka dhembje e brenga, ku maji s’ka të sosur dhe lulja s’ka të shkundur, në jetën e jetës, në jetën e jetëve” (“Rinë-Katerinëza”).

5. Prirja për ta ndërsuazuar materialin jetësor në strukturën e kohës përrallore e bën të nevojshëm edhe sqarimin e një problemi tjetër me rëndësi: *raportin e aktuales, bashkëkohores me të kaluarën*. A mund ta quajmë M. Kutelin një shkrimtar të distakuar, të distancuar nga aktualiteti e nga bashkëkohësia dhe problemet e saj? Kuteli nuk e qasi konceptin *vulgar* të “aktualitetit”, të “bashkëkohësisë”. Çdo shkrimtar i vërtetë e i talentuar nuk mund të ketë shtysë tjetër përcaktuese për krijimtarinë e tij veç aktualitetit, bashkëkohësisë, por letërsia artistike nuk është vetëm thjesht një pasqyrim i drejtpërdrejtë i jetës. Ajo është *krijim estetik*. Është apo s’është vërtet i talentuar një shkrimtar, kjo duket në radhë të parë në aftësinë e tij për të krijuar një *realitet të ri estetik, vlera të reja estetike*, të cilat, sigurisht, kurrë nuk mund t’i shpëtojnë ndikimit të aktualitetit, të bashkëkohësisë. A mund të dyshohet e të mos përcaktohet saktësisht koha e krijimtarisë letrare të Kutelit, duke u nisur ekskluzivisht prej saj? Kjo kohë përcaktohet jo vetëm me anë të *aspektit të drejtpërdrejtë pasqyrues* të aktualitetit e të bashkëkohësisë, që aty-këtu elemente të frymës së saj i përmban vepra letrare e Kutelit. Ky kuptim manifestohet në qëndrime kritike të autorit ndaj regjimit sundues, mbeturinave feudale, sistemit të shtypjes e të shfrytëzimit, ligësisë, varfërisë e mjerimit etj.

Motive e ide të tilla ka në veprën letrare të Kutelit, por ai e kuptonte se mbivlerësimi i “*pasqyrimit realist kritik të realitetit bashkëkohor*”, e shtynin t’u largohej disa *principeve estetike*, që e patën frymëzuar në krijimtarinë e vet qysh para Çlirimit. Në suazë të *ripunimit* që u bëri tregimeve të tij, një pjesë fituan vlera të reja, por të tjera humbën vlera, sepse hyri në to lëndë jetësore “aktuale”, “bashkëkohore”, që ishte në kundërshtim me gjithë principet krijuese estetike, mbi të cilat ishte ndërtuar vepra e tij letrare. Vlera kryesore e mirëfilltë e kësaj vepre letrare nuk qëndron në realitetin imediat natyralist, por në atë “*univers të ri*” të *bukurisë, të artit*, në atë “botë estetike”, të panjohur deri atëherë në letërsinë tonë, që krijoi ai dhe që ka zënë një vend të përhershëm në fondin e artë të letërsisë kombëtare.

Shoqëria ka nevojë të përhershme për krijime, për “botë” e dukuri të reja estetike. Nevojat e saj në këtë drejtim s’mund të ezaurohen kurrë. Krijimet e mirëfillta artistike, si të tilla, prandaj janë gjithnjë aktuale e u përgjigjen nevojave estetike bashkëkohore. Shumë shkrime gazetareske që trajtonin e preknin probleme të mprehta

aktuale të viteve '20-'30, janë harruar tashmë, kurse krijimet letrare të L. Poradecit e të Dh. Paskos, ndonëse nuk shquheshin në atë drejtim që shquhej publicistika gazetareske e kohës, vazhdojnë të jetojnë e do ta ruajnë vlerën e tyre *mbihistorike* me mesazhet *estetike* që bartin.

6. Në rrafshin botëkuptimor, legjendarizimi e përrallëzimi i lëndës jetësore i lejon shkrimtarit që ta rritë te njeriu dashurinë për jetën me atë optimizëm natyror e të shëndoshë që bartin përrallat e folklori dhe që zbut, me nostalgjinë e mallin e së kaluarën, brengat e vuajtjet e dramave jetësore bashkëkohore. Shumë tregime të tij mbarojnë me vdekjen e natyrshme të heronjve, që “*shkojnë me të shumtë*”. Por në to nuk ka pesimizëm, sepse edhe vdekja konceptohet me atë frymë botëkuptimore që bart **urtësia popullore**. Vdekjen shkrimtari e shikon jo vetëm si përfundim, si mbarim e fund të jetës, por edhe si aspekt të domosdoshmërisë natyrore të vazhdimësisë biologjike, si një moment të pandarë të jetës, e cila përjetohet përmes unitetit të këtij momenti me momentin tjetër, po aq të domosdoshëm, me lindjen, që e ripërtërin jetën. Lindja dhe vdekja janë për shkrimtarin dy momente normale e themelore të jetës. Nuk është e rastit që heronjtë e Kutelit vdekjen e natyrshme e kërkojnë vetë ose e presin pa frikë, sepse ndjejnë se jetën e kanë ndërtuar vetë, e kanë jetuar, e kanë shijuar, e kanë çmuar dhe kanë vjelur gjithçka që ajo e darovit njeriun, prandaj askush s'i bën dot bisht asaj dhe gjithsecilit domosdoshmërisht i bie të largohet për të mos iu rënduar dheut. Me këtë botëkuptim ndahet nga jeta Papu Tira, i cili “*punoj si rob, këndoj si zog dhe e bëri njerëzinë të qeshë dhe, duke bërë mirë, shkoi në të shumtë...*”. Edhe Ago Jakupi, kur e ndjeu vdekjen, tha: “*Tani do çlodhem, se jam i lodhur e më vishen sytë. Edhe u shtri në rrogoz, mbi pllashet e vdekjes, që i kish punuar vetë dora e tij. Edhe pastaj, sa ndizet e shuhet vetëtima, Ago Jakupi mbylli sytë*”.

Ky lloj konceptimi i aktit sublim ekzistencial të jetës e të vdekjes vjen ngaqë Kuteli di të kapë edhe gëzimin e të jetuarit, por edhe momentet tragjike, vdekjen si humbje, ndërprerje të jetës. Këtë konceptim bartin tregimet: “*Xha Brahua i Shkumbanares*”, “*Më kot...*”, “*Gjonomadhe e Gjatollinj*”, “*Rinë-Katerinëza*” etj.

Jeta e josh njeriun me gjithë të mirat e trupit e të shpirtit. Toka amë paraqitet nga Kuteli e begatë e bujare, e pasur e dorëlëshuar, që e

mbush dheun me të mirat e saj, me bukë të bardhë e mish të majmë, me fruta sherbet e me blerime të njoma, me verë e raki. Në vargun e ditëve të vitit autori ndalet në ditët e dasmave e të gostive, në ditët e festave popullore e të të korrave, ku shpërthejnë ngazëllimet e jetës, që e bëjnë njeriun të lumtur duke përjetuar çdo ditë e çdo çast të saj.

Në përfytyrimet e utopisë sociale empirike të vegjëlisë, momenti qendror i saj ka qenë *gostia e bollshme*, e përshkruar në trajta groteske. Mos vallë ky përfytyrim optimist është fals, është i stisur e i gënjeshtërt? Në të vërtetë, ai është një anë e pandarë e botëkuptimit të kulturës popullore, që bart me vete edhe një fillesë utopike për të ardhmen. Ajo është utopike, sepse ka mbështetje të kufizuar *në kohë*. Gëzimi i jetës lidhet vetëm me *ca momente* të saj, *me gostitë e lindjes, martesës, me festat e motmotit, me momentet e korrjeve dhe të argëtiveve popullore*. Dhe dihet se në gostitë, në festat popullore e familjare, vegjelia përfshihej në një “*jetë të dytë*”, manifestim i gëzueshëm i kundërshtimit të skamjes e mjerimit, i lirisë së mendimit, i ëndrrave e shpresave për mirëqenie. Në të tilla raste, momente e situata fitonte të drejtë qytetarie *e vërteta e vegjëlisë*, zbohej hipokrizia sociale, rrëzoheshin konvencionet e pabarazia sociale, shpërthente gazi e hareja e gëzueshme e të jetuarit. Tipike për këtë frymë janë tregimet “Fshati im e pi rakinë” ose “Lumi i madh”.

7. Tipar qenësor i “estetikës kuteliane” është edhe *grotesku popullor*. Vetjakësia e stilit të Kutelit u ngjiz në magjen e *kulturës gaztore popullore*, që e begatoi veprën e tij me thesaret e **groteskut**, me *karakterin ambivalent* të të gjitha elementeve të tij, që përcillen nga e qeshura dhe e përqeshura dhe që shprehin lëvizjen e pangurtësuar, fleksibël e difuzore jo vetëm të mendimit e të ndjeshmërisë, por edhe të jetës, të qenies në përgjithësi. Vlera estetike e një vargu tregimesh e sidomos rrëfenjash të Kutelit nuk ka qenë kuptuar, veç të tjerash, edhe ngaqë s’kanë qenë njohur e pranuar vlerat estetike të veçanta të kulturës gaztore popullore. Rrëfenjat, si: “*Fshati im e pi rakinë*”, “*Lumi i madh*”, “*Lugetërit e fshatit tim*”, “*Rinë-Katerinëza*”, “*Kryengritje për lugat*”, “*Papu-Tira*”, “*Babalja*”, “*Rusa-Papusa*”, “*Fije nga jeta e Theofil Kastorit*” etj., në rastin më të mirë janë quajtur rrëfime “argëtuese”, “zbavitëse”, por pa ndonjë përmbajtje të rëndësishme social-estetike. Në të vërtetë, siç e pohuam,

ato formojnë një krah me rëndësi e një traditë origjinale në letërsinë tonë kombëtare, **krahun grotesk** të saj.

Nevoja estetike për realizëm grotesk i lindi M. Kutelit qysh se vuri në qendër të krijimtarisë së tij letrare një *botë kalimtare*, kur po perëndonte ajo mesjetare dhe kur njeriu po përfshihej në një jetë tjetër, e cila ende s'e kishte treguar qartë fytyrën e saj dhe prandaj dukej *enigmatike*. Në këtë atmosferë sociale Kuteli vendosi ta përcillte ndarjen nga Mesjeta, duke qeshur e duke e përqeshur, me stilin grotesk, siç e patën bërë edhe shkrimtarët e adhuruar prej tij - Rableja dhe Gogoli. Ky stil dallohej për **frymën kritike**, por edhe **gaztore**, për përqeshje të hidhëta, por edhe për humor të gëzueshëm. Duke përdorur një arsenal të pasur mjetesh të kulturës gaztore, të nginjura me ëndrrat e aspiratat social-utopike të popullit, shkrimtari i shndërroi në elemente të ceremonisë së varrimit artistik të asaj bote, që i kish ikur koha. Kuteli zgjodhi rrugën e *realizmit grotesk* për të shprehur atë të vërtetë të jetës, që përkundej në djepin e kulturës popullore gaztore, si botëkuptim e përjetim i vegjëlisë, si të *vërtetë artistike jozyrtare*, që përleshej me “*të vërtetën zyrtare*”.

E vërteta artistike në letërsi arrihet e shprehet me mjete e mënyra të shumta e të ndryshme, sipas veçorive të kohës, dhe përmes tyre formohet e ekziston historia e saj. Kuteli na dha një variant të veçantë të kësaj të vërtete me ca histori, që të bëjnë të qeshësh e të përqeshësh, me ironi e satirë groteske afirmohet një e vërtetë më e mençur dhe më e thellë sesa ajo që bartin modelet aristokratike të letërsisë klasike apo neoklasike. Do të mjaftoj të kujtoj tonalitetin grotesk humoristiko-satirik të karakterizimit të shpurës së familjeve të tregtarëve të Korçës, që turren drejt fshatit “të humbur”.

Përse i duhet grotesku artistit? Ai i duhet për të arritur tek ajo e vërtetë, që nuk mund të kapet e të shprehet me mjetet e format racionale dhe sipas idealit të klasicizmit. Grotesku është një rrugë më “e djallëzuar”, “dredharake” për të arritur, kapur e shprehur një thelb të thellë të qenies, të jetës, tek i cili nuk arrijnë të depërtojnë mjetet tradicionale të estetikës së klasicizmit. Grotesku është rruga e aktivizimit të figuracionit *befasues*, që kombinon në mënyrë konvencionale realen me irracionalen, të zakonshmen me të jashtëzakonshmen, normalen me anormalen, të dukshmen me të padukshmen, që kombinon të kundërtat (të bukurën me të shëmtuarën,

tragjiken me komiken, të madhërishmen me të ulëtën, seriozen me qesharaken) për të arritur në *thellësitë* e lëvizjes së jetës e të ligjësorive të qenies. Grotesku dallohet nga një liri e madhe e imagjinatës, e invencionit artistik, të cilat ndihmojnë për të kapur e shprehur *karakterin kontradiktor e paradoksal* të jetës e të qenies, karakterin e papërfunduar e të ndryshueshëm të saj.

M. Kuteli ka krijuar vepra, të cilat janë groteske në tërësinë e tyre, si: “Gjanomadhë e Gjatollinj”, “Lumi i madh”, “Fshati im e pi rakinë”, “Lugetërit e fshatit tonë” etj. Groteske janë subjektet e fabulat e tyre, personazhet e ngjarjet. Mirëpo grotesku luan rol të rëndësishëm si element i stilit të mëvetësishëm kutelian jo vetëm në këto rrëfime, por edhe si tip universal mendimi artistik, që aktivizohet gjerësisht edhe në tregime e novela që s’kanë subjekt, personazhe ose ngjarje të drejtpërdrejta groteske. Peshat specifike e subjekteve, fabulave, karaktereve, personazheve në tregimet e Kutelit nuk është shumë e rëndësishme, por ato begatohen me përmbajtje *poetiko-figurative groteske*. Me figuracion poetik grotesk paraqit Kuteli çdo gjë: dukuritë e natyrës dhe portretin fizik të çdo qenieje, edhe të personazheve, të veprimeve, të situatave, ndodhive e sjelljeve, mendimeve e ndjenjave. Në stilin grotesk, në hiperbolizimet groteske të Kutelit duket jo vetëm pasuria e figuracionit grotesk popullor, por edhe *forca krijuese imagjinative poetike* e artistit mjeshtër, edhe karakterizimit komik satiriko-humoristik. *Nënqeshja e përqeshja* përcjellin shpeshherë figurat groteske që shprehin një thelb të fshehtë, të padukshëm komik. Në frymën e groteskut popullor Kuteli e përdor groteskun për të paraqitur sidomos pamjen e jashtme fizike të gjërave në trajta të deformatuara, të ndryshuara, të shëmtuara, në një plan karikaturizues, satirik. Kjo mënyrë është mbizotëruese në novelën “Vjeshta e Xheladin beut”.

Estetika e groteskut popullor lidhet fort me *estetikën e së shëmtuarës*. Në qendër të objektit vihet e shëmtuara, së cilës i jepen *trajta të përçudnuara*. Në këtë stil edhe Kuteli me mjeshtëri të lartë e përshkruan Hanëmen, gruan “shterpë” të Xheladin beut, personifikim i qenies pa vazhdimësi biologjike. Shëmtimi i Hanëmes së beut hiperbolizohet aq sa të ngjall neveri. Pra, grotesku, si mjet për të karakterizuar fenomenet negative, kalon nga trajta e tij *tmerruese* (kur këto dukuri marrin pamje të përbindshme, paraqiten si qenie të

përçudnuara, si lugetër, vampirë, kuçedra, katallanë, gjigandë) drejt një humori të lehtë, të paqedertë, të gëzueshëm, që e zbut dhe e shndërron në një katarsis artistik atë frikë e tmerr që përcjellin emocionalisht përjetimin e dukurive të llahtarshme, të tmerrshme.

8. Personazhet e Kutelit s'kanë mendim e gjykim individual për ngjarjet e hidhura, por reagojnë me *formulat e gatshme* të kulturës popullore, me *sharje fyese, me mallkime ose me lutje*. Duke i zgjedhur me shije e duke ua përshtatur rrethanave e situatave, ato fitojnë një kuptim e vlerë të mirëfilltë botëkuptimore dhe estetike dhe e plotësojnë në një drejtim të rëndësishëm stilin e mëvetësishëm kutelian. Ato nuk duhen vlerësuar si një element ornamental folklorik në krijimet letrare të Kutelit, sepse janë më shumë, janë një mjet që sjell gjykimin, mendimin e lirë popullor, sjell zërin e protestës sociale të vegjëlisë. Jeta ishte e ngarkuar me vështirësi të shumta, me dhembje e mundime, me skamje e vuajtje, që e ndiqnin njeriun nga lindja e deri në varr. Njerëzit bënin grurë e hanin misër. Sëmundjet u vinin kosën të vegjëlve e të mëdhenjve; shtëpi e fshatra të tëra mbeteshin të shkreta. Vegjelia e ndjente veten të pafuqishme ndaj kësaj jete të mjerë, rënkonte dhe mallkonte. Qëndrimi kritik i autorit ndaj këtij realiteti të hidhur shprehet me mënyra të ndryshme, midis të cilave luajnë një rol të rëndësishëm *të sharat e mallkimet*. Ato luajnë një rol psikologjikisht kompensues dhe nuk e lënë njeriun të bjerë në dëshpërim. Të lindura në kuadër të besëtytnive e riteve fetare, ato fituan një lloj pavarësie në kulturën popullore dhe kanë funksionuar si shprehje të *lirisë së mendimit* dhe të *protestës sociale*. Te “Vjeshta e Xheladin beut”, përballë arbitraritetit e fuqisë së pakufizuar të beut, njeriut të thjeshtë, që e pësonte prej tij, s'i mbetej veçse ta shante, ta mallkonte, të nxirrte dufin duke lëshuar një varg fjalësh të rënda, siç thotë autori, “nga ato që s'i ngre kandari”. Ja një shembull i një ligjërimi mallkues nga novela “Vjeshta e Xheladin beut”: “*Po ta bësh edhe këtë punë, s'të djeg as zjarri i xhehnemit, Xheladin bej. S'të tret dheu! Ta dish, o pushtanik, po të bësh atë punë do të të hanë mërshën krimbat, do të t'i qitin sytë galat! Y-y-y, murtajë. Pusht Stambolli! Matuf! Më ke marrë nderin, të marrtë zoti mëndtë! Më ke lënë në turp të rri, më të lëntë perëndia pa sy, të heqshin për peri! Më ke ngrënë jetën, të hëngërt mortja! Ja theve, thefsh arrëzën e qafës! U kalbsh së*

gjalli, përmbys, siç u kalb yt atë, që e hëngër krimbat!... Me të sharat dhe mallkimet bashkohen edhe llagapet groteske: *zorraxhi plak, duvaxhi, derr, domuz, qafir, gomar, rrozgë e nxirë; bushi kokëqoshe, maçok i zi etj.*

Ana tjetër e jetës është *e gëzueshme*. Dhe pikërisht këtë mesazh sillnin ca tregime e rrëfime që, në frymën e kulturës popullore, bartnin kujtime e përfytyrime utopike të një “shekulli të artë”, një shekulli bollëku e mirëqenieje materiale, që e ëndërronin brez pas brezi njerëzit e varfër. Jeta e këtij “shekulli të artë” përshkruhet në stil grotesk, gjithë optimizëm utopik, me një bollëk të pafundmë, me gjithë të mirat e trupit e të shpirtit. Urimet, përshëndetjet, lutjet, dollitë janë shprehje e idealit utopik të vegjëlisë, e një morali që ka në qendër të tij mirësinë e dëlirësinë e shpirtit. Ato sjellin një mesazh të *gëzueshëm* për jetën. Si në çdo rast, në frymën botëkuptimore të kulturës popullore. Kuteli e rrok jetën si univers të kundërtash. “*Zia zi, po edhe jeta jetë*”- thotë shkrimtari në një rast. Prandaj në tregimet e rrëfenjat e tij ka plot motive *gostish, festash e dëfrimesh*, që kanë funksione jetësore kompensuese, që shprehin atë bazë natyrore, instinktive, e cila e ruan jetën, e përtërit, e bën të amshuar, të pavdekshme.

Tipik për këtë kuptim është tregimi “Netë qershori”. Subjekti është i thjeshtë, bën fjalë për takimin e një grupi mjeshtërish mërgimtarë me një bashkatdhetarin e tyre të larguar prej kohësh nga vendlindja e të pushtuar nga nostalgjia e mëmëdheut e të kohëve të shkuara. Por subjekti i thjeshtë ngrihet në art i pasuruar me dialogë të zhdërvjelltë, i ngarkuar me urime, shprehje e fjalë të urta popullore, lavdërime, të shara e mallkime, me dolli e me përshëndetje, me *atmosferë të gëzuar e të çiltër, të singertë gostie*. Spikat në këto rrëfime edhe shpresa e ëndrra për një jetë më të mirë, më të bukur, më të begatë, utopike për të ardhmen. Ajo është utopike, sepse ka mbështetje të kufizuar *në kohë*. Gëzimi i jetës së vegjëlisë lidhet vetëm me ca momente të saj, me *gostitë e lindjes, martesës, me festat e motmotit, me momentet e korrjeve dhe të argëtive popullore*. Dhe dihet se në gostitë, në festat popullore e familjare vegjëlia përfshihej në një “*jetë të dytë*”, manifestim i gëzueshëm i kundërshtimit të skamjes e mjerimit, i lirisë së mendimit, i ëndrrave e shpresave për mirëqenie. Në të tilla raste, momente e situata fitonte të drejtë

qytetarie e vërteta e vegjëlisë, zbythet hipokrizia sociale, rrezoheshin konvencionet e pabarazia sociale, shpërthente gazi e hareja e gëzueshme e të jetuarit.

Pa të sharat, mallkimet, lavdërimet, urimet, përshëndetjet popullore është e pamundur të përfytyrohet *dialogu* kutelian, që zë një vend të rëndësishëm në strukturën e të *rrëfyerit* kutelian. T'u heqësh atyre këtë lëndë dialogjike do të thotë t'i bësh memece. Ky element është po aq i rëndësishëm, sa ç'është edhe *fillesa narrative*, *rrëfyese*, *përshkruese* në krijimet letrare të Kutelit. Të rrëfyerit si i tillë, i përvetësuar nga proza folklorike popullore, është një vlerë kaq e rëndësishme në tregimet e Kutelit (krahas dialogut) sa ç'është melodia, ritmi e harmonia tingëlluese e vargut poetik të L. Poradecit.

9. Pa përdorimin e *potencialit estetik të shqipes* s'do të kish pasur "*estetikë kuteliane*". Dh. Pasko ishte një nga ata krijues, që e dinte fort mirë se letërsia, që të jetë vërtet *artistike*, para se të bëhet ide estetike ose formë estetike, është *gjuhë*. Aspekti gjuhësor përbën premisën më të domosdoshme fillestare të letërsisë artistike, e cila në krahasim me llojet e tjera të krijimtarisë artistike, është, para së gjithash, *art gjuhe*. Ky kriter përbën një nga premisat kryesore, që i skarton grafomanët, (që s'bëjnë dot pa redaktorë e korrektorë letrarë) nga shkrimtarët e vërtetë, *mjeshtër të fjalës*.

Aktivizimi i gjuhës në *letërsinë artistike* kryhet me funksion *estetik*, domethënë shërben si lëndë, si mjet material për të ndërtuar një "*botë të re estetike*", që mishëron në vetvete *përvetësimin estetik* të realitetit, të jetës. Në zotërimin e potencialit estetik të gjuhës, në spontanitetin e begatinë gjuhësore të shkrimtarit, poetit qëndron burimi e themeli i parë i talentit dhe gjenisë letrare artistike. Në këtë drejtim Dh. Paskoja që një magjistar i vërtetë i fjalës shqipe. Begatia e "*estetikës gjuhësore kuteliane*", që shpesh quhet në mënyrë jo fort të goditur "*letraritet*", përmbledh modele të mrekullueshme stilistike dhe përbën një shkollë të vërtetë të *gjuhës letrare shqipe*. Po atë punë që bëri Lasgushi, duke shfrytëzuar potencialin, *poetikën e brendshme* të shqipes, e bëri Kuteli në fushën e prozës letrare shqipe.

Është thënë se Dh. Paskoja ka përdorur fjalë dialektore, leksik të të folmeve krahinore. Është e vërtetë, por këto nuk e zbehin e nuk e

ulin aspak vlerën stilistike gjuhësore të krijimtarisë letrare të Kutelit. E theksojmë këtë, sepse në dekadat e fundit, në suazë të përpjekjeve për normativizimin e njësisë së gjuhës kombëtare, janë mbajtur herë pas here edhe qëndrime denigruese e mospërfillëse ndaj *vlerës letrare* të shkruar në dialekte a të folme krahinore.* Prandaj kemi theksuar prej kohësh se interesimi për të kapur thelbin e stilit të mëvetësishëm të krijimtarisë letrare të M. Kutelit duhet të përcillet me saktësimin e koncepteve të *gjuhës standarde kombëtare, gjuhës letrare, gjuhës popullore, gjuhës së folklorit, të dialekteve, nëndialekteve dhe të të folmeve krahinore*, të raporteve midis tyre. Ky problem nuk mund të mos përfillet po të marrim në konsideratë krijimtarinë e larmishme të shumë poetëve e shkrimtarëve tanë të shquar. Ne mendojmë se normativizimi nënkupton *gjuhën standarde*, që dallohet nga gjuha e mirëfilltë *letrare* (gjuha e krijimtarisë letrare *artistike*), e cila, sigurisht, ndikohet nga njësia e gjuhës standarde, por ekziston jo vetëm përmes saj, por edhe përmes vlerave gjuhësore ekspresive të dialekteve, nëndialekteve, të folmeve krahinore, madje edhe të gjuhës së përveçme të çdo individualiteti krijues letrar. Këtë të vërtetë duhet ta pranojmë plotësisht edhe për M. Kutelin. Sikur, botimi i veprës letrare të M. Kutelit të shqyrtohej sipas do rregullash standarde dogmatike, gjuha e tij do të sterilizohej, do të humbiste gjithë shkëlqimin, magjinë, origjinalitetin e saj, që është një nga vlerat kryesore estetike të krijimtarisë së tij letrare. Gjuha e veprës së tij letrare është *shqipja letrare*, e pasuruar me vlera të gjuhës standarde kombëtare, të dialekteve dhe të folmeve, e mbështetur sidomos në *gjuhën popullore*. Një variant i begatë i gjuhës popullore, që mund të shërbejë për të ushqyer praktikat e letërsisë së kultivuar, është *gjuha e folklorit*, domethënë e krijimtarisë artistike kolektive, e poezisë dhe e prozës popullore. Në gjuhën e folklorit gjenden ato vlera të poetikës

* Këto qëndrime sillnin sterilizimin e së ashtuquajturës “gjuhë letrare”, që merrej nga disa si gjuhë e fabrikuar në laboratorët e shkencave linguistike, e imponuar me metodën e preferuar të drejtimit administrativ, gjuhë e cila, ndonëse e njësuar, bëhej disi artificiale, e zbatuar nga “censura” e disa korrektorëve, që e varfëronin nga pasuria e gjuhës popullore, e dialekteve, e të folmeve, nga pasuria e letërsisë artistike dhe nga spontaneiteti i gjuhës së folur të rëndomtë të jetës së përditshme të kombit. Kjo vërejtje nuk i nënvlerëson përpjekjet që janë bërë nga gjuhëtarët tanë këtej e përtej kufirit për njohjen dhe përmirësimin e gjuhës standarde kombëtare.

gjuhësore popullore, të cilat mund të integrohen e të pasurojnë edhe letërsinë e kultivuar artistike. Dhe, prandaj, është pak të pohosh se Kuteli u mbështet në gjuhën e popullit, sepse ai mundi të përthithë dhe të aktivizojë në mënyrë krijuese sidomos *potencialin e poetikës të gjuhës popullore, të folklorit*. Kjo gjë bëri të mundur që gjuha e tij, edhe pse e ngarkuar me dialektizma, tingëllon, si gjuhë e një stili të madhërishëm e të natyrshëm letrar artistik, të ngjizur me gjithë vlerat e shqipes.

* Është për t'u përmendur se redaksia e botimit të “Veprës letrare” të Kutelit (1990) ka vepruar drejt duke ruajtur të paprekur stilin gjuhësor origjinal e të spikatur të tij.

Sali BASHOTA

TREGIMTARIA E MITRUSH KUTELIT

(ngjarja, personazhi, rrëfimi)

Ndërtimi tematik i tregimeve të Mitrush Kutelit tregon për hapësirën e hulumtimit ku vrojtohet një ambient i tejmbushur me ngjarje, që "flasin" për ngjarjet, me kallëzime që "flasin" për kallëzimet. Këtu shtresohet bota e ndjeshme e karaktereve dhe kërkohet, doemos, forma e veprimit. Kuteli me një sensibilitet narrativ e shpalos jetën njerëzore dhe fatin e personazhit nëpërmjet pamjeve dhe vizioneve të renditura shkallë-shkallë njëra pas tjetrës, madje përmes një rrëfimi gojor, që kalon në rrëfimin letrar modern.

Pra, Kuteli i paraqet në trajtën e rrëfenjave letrare, me një stil të veçantë shkrimi, një varg temash e motivesh, të cilat mishërohen përbrenda përmbajtjes dhe ideve të prozës së tij. Natyrisht, prirja e tillë realizohet në kuptimin e paraqitjes së ambientit, thurjes fabulative apo karakterizimit të personazhit, gjithsesi, duke i sistemuar përbrenda indit të rrëfimit ngjarjet në mënyrë të dramatizuar, me ndërprerjen e veprimit përmes ndërhyrjeve të narratorit dhe funksionalizimit të digresionit lirik.

2.

Në novelën "Vjeshta e Xheladin beut", Mitrush Kuteli e ka krijuar kodin e heroit negativ. Përfaqësues i këtij kodi është vetë Xheladin beu, figurë e përshkruar midis amoralitetit dhe aventurave çudibërëse. Kësisoj, novela i ka situatat e përjetimit, të cilat shkallëzohen sidomos në pjesën e dytë në relacionin konfliktuos: Xheladin beu-Mara. Prandaj, duke i kërkuar motivet e qarta të

ndodhisë nëpërmjet prapavështrimit shkallëzohen situatat tragjike, të cilat ndërlidhen me moralin, mallkimin, incestin, çmendinë, vdekjen.

Në novelën “Vjeshta e Xheladin beut”, shënjohej perspektiva mrekullitare fantastike e përfytyrimit dhe e shpërfytyrimit (në vargëzimin dhe shprishjen e ngjarjeve ky element ka të bëjë me përmasën e realizmit magjik).

Pra, ndeshja, ballafaqimi i veprimit amoral dhe i nderit është element thelbësor i novelës që jepet nëpërmjet retrospeksionit të Xheladin beut, duke e bartur nëpër kujtesë bashkimin e dhunshëm seksual. Narratori, Xheladin beun prej shkallës perceptuese të heroit letrar negativ e rikthen në hero të mundur tragjik.

Në këtë pikë përmbyllëse, novela “Vjeshta e Xheladin beut”, e thur ëndrrën dhe zhgjëndrrën e një karakteri, i cili me një zgjidhje tragjike të fabulës e përfaqëson klasën e vet shoqërore. Fundja, Gurija mbetet vetëm ëndërr magjepsëse edhe për narratorin.

Rrjedha e rrëfimit ndërtohet me një stil të veçantë poetik, duke përmbledhur në mënyrë sublimë situata, ngjarje, karaktere, që jepen me një shprehje të arrirë dhe funksionalizuese gjuhësore.

Novela “Vjeshta e Xheladin beut”, në tërësi e paraqet një realitet interesant moral e social, i cili goditet, denoncohet, çmaskohet.

3.

Vepra “Net Shqiptare” e Kutelit kodin tregimtar e nyjton në tipin e personazhit-emblemë. Tashmë klasa e privilegjuar shoqërore e përfaqësuar me tipat e bejlerëve dhe të agallarëve skicohet përmes karaktereve të tyre. Në rrëfenjën “Natë kollozheku”, tregohet ngjarja e pandërprerë e funksionalizuar dramatikisht përmes gojës së Xha Martinit, i cili rrëfen për ndodhitë e Olloman beut, për ndëshkimet e tij, për konfliktet dhe aventurat. Në tekstin narrativ figuron rituali i ëndrrave që mbretërojnë në botën e gjallë.

Në këtë rrëfenjë të Kutelit, parimi poetik i kundërvënies së personazhit trajtohet në formë të përkujtimit të ndodhisë, ku ndjenja për heroizmin e personazhit lëviz fuqishëm, e rilindur në vizionin e Malush Katunishtit.

Edhe në rrëfenjën “Natë muaji Shëmbitër” (Rrëfimi i parë i Argjir Vlonjatit), kundërvënia e personazhit varet nga "bartja e momentit memorial në vepër "(Bahtini). Kështu rrëfenja është dhënë në formë të dialogut të imagjinuar të narratorit me personazhin, madje në formë përkujtimi dhe enigme.

Kjo, mbase, është një rrëfenjë romantike, që i kthehet herë pasioneve, herë kundërshtive. Kur Argjiri e refuzon martesën me Argjirën, mollën majoshe të Belortasë, atëherë e aktivizon dashurinë ndaj Selvijes, që gjithnjë ia bren zemrën dhe ia rrit tensionin përvëlimgjitar të mallit.

Mirëpo, kjo dashuri mahnitëse, e cila evokohet nga distanca kohore, përfundon tragjikisht. Përmes Usta Komit, personazh që paraqitet në rolin e lajmëtarit, shpjegohet vrasja e të dashurës së Argjirit.

Dhe "bartja e elementit memorial" (Bahtini), ka të bëjë me shtresimin e ngjarjes mbi ngjarje, në situata të vargëzuara problematike ku ngatërrohet "historia e ndodhisë", duke lëvizur midis ndjenjave të narratorit dhe veprimeve të personazhit.

Rrëfimi i parë i Argjir Vlonjatit në një “Natë muaji Shëmbitër”, në fund, shpërthen me një zemëratë për të shpjeguar dinjitetin dhe moralin e gjuhëzuar nga të papriturat jetësore. Ndërkaq, vasha e dashuruar dhe ëndërrimtare është një gjakndezje, që lëviz përbrenda ritmit tragjik të shpirtit njerëzor. Vdekja e saj është një boshllëk, që e pushton bashkë me peripecinë e gjëllimit.

Është e qartë se lajmëtari, kronisti apo vrojtuesi, e bart të ndodhurën deri te personazhi që dëgjon për vdekjen e së dashurës pikërisht në ditën e shenjtëruar. Ky kod i tematizuar biblik është prani e shpeshtë argumentuese në rrëfenjat e Kutelit.

Në veprën “Net Shqiptare”, si temë-dilemë narrative trajtohet edhe tema e gjakmarrjes, pikërisht në rrëfenjën “Gjonomadh e Gjatollinj”, që gjatë rimarrjes së dytë të tekstit konceptohet në novelë. Këtu gërshetohet poetikisht tema sociale-patriotike-erotike. Intriga kryesore përkufizohet përbrenda vëllavrasjes si dhe hakmarrjes që lind ndërmjet fiseve gjonomadh e gjatollinj, për shkak të një vashë, ngjarje të cilën autori nuk e motivon nëpër situata të caktuara sociale e psikologjike, por vetëm e përfytyron dhe shpërfytyron.

Në këtë novelë, për shumë arsye, është interesante paraqitja e figurës së gruas, e cila në prozën e Kutelit zë pak hapësirë rrëfimore. Zonja e Madhe simbolizon gruan, e cila e përfytyron fatin e personazhit që lufton. Autori, sigurisht, këtë krijesë e lidh me mitin, besimin, legjendën. Ajo, bie fjala, mund të jetë sikundër Nëna e Madhe, e cila njihet në letërsi si simbol i shenjtërisë dhe i plleshmërisë. Siç thuhet, në tekstet psikologjike, figura e gruas së këtillë, po ashtu, lidhet me seksin dhe shtatzënesinë, me tokën dhe të vdekurit, ngjyra e saj është e kuqe, ndërsa kulti i përgjakshëm.

Ky është pozicioni i dramatizuar, që fanitet thellë në shpirtin kryengritës të vashës dhe njëkohësisht dilemë e që zgjidhet me mbylljen e shtegut të gjakmarrjes. Mirëpo, edhe pse nuk motivohet tërësisht kjo dashuri, është fjala për zgjidhjen fatlume të intrigës kryesore.

Tema e vdekjes, që ndërlidhet në një formë me problemin e moralit kristian, del te personazhi Ago Jakupi në tregimin “Qysh e gjeti Ago Jakupi rrugën e Zotit”, ndërkaq te novela “E madhe është gjëma e mëkatit” (Tat Tanushi), projektohet, procedohet e realizohet më fuqishëm.

Tregimi i Kutelit, pothuajse, e përvijon besueshmërinë hyjnore përbrenda motivimit të vullnetit të tij shpirtëror, edhe atëherë kur karakteri i tij është në ballafaqim etik e social me ambientin real apo eterik.

Askund tjetër si në këtë tregim të Kutelit nuk e hasim metamorfozën botëkuptimore të personazhit, pra atë ndërlidhje kundërvënëse midis dy gjendjeve shpirtërore të Ago Jakupit. Në fillim të tekstit del sheshit lakmia, ndërsa në fund funksionalizohet mirësia. Nëpërmjet ëndrrës, që bëhet formë e zhvillimit fabulativ, madje formë letrare, projektohet përfytyrimi, vizioni i veprimit të personazhit, për të arritur teksti statusin e një mesazhi etik.

Fryma e krishterimit projektohet si pikë e vdekjes së ngadalshme të personazhit ku duhet të spastrohen mëkatet, ndërkaq ëndrra dhe halucinacioni, së bashku si fikSION e rrumbullakojnë, botëkuptimin dhe botëpërjetimin e tij. Këtë formë kërkimore të narracionit dhe këtë modelim të personazhit të lidhur ngushtë me realen dhe irrealen (jeta dhe ëndrra), nuk e hasim më në tregimtarinë e

Kutelit. Prandaj, Ago Jakupi në kërkim për të gjetur rrugën e Zotit, kësisoj duke e ndërruar botëkuptimin për njerëzit dhe jetën, paradoksalisht e kërkon dhe e gjen vdekjen e vet.

Rrëfenja “I vdekuri dhe i gjalli”, si e tillë, është model i përrallës, e cila transformohet në tekstin narrativ të Kutelit (... na ish njëherë...) sikundër që është edhe rrëfenja “Të vdekurit”, ku shpalosen fijet nga jeta e Theofil Kostorit.

Në rrëfenjën “I vdekuri dhe i gjalli”, narratori e aktivizon dialogun midis dy karaktereve që prezantojnë, i pari botën e vdekur dhe i dyti botën e gjallë. Kësisoj, duke e përshkruar veprimin e tyre, narratori i vijëzon retrospeksionin duke gjetur bashkëbiseduesin tjetër për të dëshmuar ndodhinë. Kjo bartje e veprimit dhe e ngjarjes, pothuajse, është e pranishme në pjesën më të madhe të tregimtarisë së Kutelit, madje kemi edhe veprimin trefishor: narratori-personazhi i veprimit-komentuesi i ngjarjes:

Në rrëfenjën “Të vdekurit”, tema e vdekjes dhe e pavdekësisë strukturohet nëpërmjet metempsikozës së personazhit, bartjes së shpirtit prej botës së gjallë në botën e vdekur dhe anasjelltas, prej njeriut në insekt.

Këtu, evokohet nga pozicioni i personazhit infantil, dashuria e Tërfilit dhe e Limbit (shpirti i saj i rikthyer, i shndërruar në flutur). Edhe kjo rrëfenjë një ëndërr magjepsëse e protagonistit, që e nënkupton përrallëzimin e tekstit dhe jo veprimin e personazhit.

Edhe rrëfenja “Rinë Katerinëza”, e procedon dhe e zhvillon rrëfimin fantastik. Rrëfenja e Kutelit e krijon një ambient të vet fantastik duke u mbështetur në rregullat e gojëdhënës, legjendës, përrallës. Kështu figura e Rinës konceptohet nëpër rrathët e shëmbëllimit, të vuajtjes e të çastit të vdekjes në bashkëbisedim me të vdekurin (e ëma), për të ringjallur imazhin e jetës në atë dashuri fantastike.

Rrëfenja e Kutelit “Rinë Katerinëza”, kështu e shtreson, fund e krye, dialogun e të gjallit (Rina) me të vdekurin (Kirollojn). Pra, i kemi personazhet e gjalla dhe personazhet e vdekura. Një dimension të këtillë apo të ngjashëm të prozës rrëfimtare fantastike e gjejmë edhe në tregimin “Andërr e një pasditje vere” të Ernest Koliqit, ku Neta e

vetmuar në dhomë «komunikon» me të dashurit e saj, por edhe ata janë shpirtra të vdekur.

Narratori i rrëfenjës “Rinë Katerinëza”, e hulumton një ëndërr dashurore në shkallën më të lartë të halucinacionit ku pikëshikimi ka të bëjë me bashkimin seksual të të gjallit (Rina) me të vdekurin (Kirolojn), ku u lind edhe foshnja. Në thurjen e ngjarjes, pra përfytyrohet irrealja.

Në rrafshin tjetër interpretues, narratori e kërkon dykuptimësinë e veprimit, duke i paraqitur personazhet në një pozicion të ri: në rrëfimin alternativ të situatave ku shfaqet kodi popullor i ligjërimit: foli Trimi, e pastaj foli Vasha. Ky është një shembull që tregon se teksti narrativ i Kutelit, jo rrallë, e kërkon edhe motivimin e dytë apo situatën e dytë të shtresimit. Karakterizmi i këtillë ka të bëjë edhe me procesin e ringjalljes së karaktereve. Kështu rrëfimi përqendrohet te shpirtrat e vdekur (teksti i Kutelit ka ngjashmëri me rrëfimin e Gogolit): Kiroloj te “Rinë Katerinëza”; Engjëllina te “Natë gushti”, Limbi te rrëfenja “Të vdekurit”, ku procedohet tema e dashurisë fantastike dhe, në anën tjetër, Petrushi te “Natë qershori”, Zef Karanxolli, Xemë lugati te “Lugetrit e fshatit tonë”, Llambi i Dangos te “Kryengritje për lugat” etj., ku thuren situatat misterioze me shpirtrat e ringjallur në lugetër dhe besëtytnia e misticizmi bëhen modele të rrëfimit kutelian përbrenda hapësirës eterike.

Kodi tregimtar i Mitrush Kutelit, në të cilin shtresohet nata si procede e shkrimit, e muzës apo si konvencion i kohës, siç do të thoshte Shkllovski, ndër të tjera, sikur lëviz nëpër labirintin e thënies së moçme aristoteliane: se karakteret janë më të mirë se ne.

Modusi përfytyror i rrëfenjave kuteliane e zotëron fuqinë për të riprodhuar ngjarjen, personazhin, veprimin, kohën e saktësuar në një intrigë. Dhe kështu valë-valë fuqia e mendimit dhe e fjalës bartet nëpër kujtesën e karaktereve.

Në rrëfenjën “Natë gushti” (Përtej valëve të kohës), precizohet ambienti: Katjelli i Mokrës dhe Kisha e Shën Djelës, karakterizohet situata misterioze e valëvitur midis ëndrrave të frikshme, por durimtare të narratorit, ku piqen, takohen, bashkëdyzohen realja me fantastiken (Radavani i gjallë me Engjëllinën e vdekur). Dhe vetvetiu shpaloset tema biblike e përvujtnisë (jo e veprimit, por e fokusit

ëndërrimtar) përmes fantazisë së narratorit kur e projekton aventurën mrekullitare në përcaktimin e një situatë të ringjallur dashurore.

Kjo, gjithsesi, është një temë e kodit të shtresuar biblik me situatë zotëruese psikologjike, në të cilën bëhet përfytyrimi i të vdekurve, ringjallja, urata etj., dhe ku simbolizohet bota pavdekësore përmes imazheve të shkrirjes së abstraktes në konkretën.

Te vepra “Kapllan Aga i Shaban Shpatës”, përkatësisht te rrëfenja “Rinë Katerinëza”, vasha e gjallë (Rina) e dashuron djalin e vdekur (Kirolojn).

Dimensioni i temave të tjera, që ndërlihen me raportin e jetë-vdekjes, del në rrëfenjën “Natë qershori”, mirëpo ky tematizim i këtillë tashti shtresohet përmes temës sociale, mërgimit dhe temës historike, veçan kur shquhet heroizmi i Bendo Shapërdanit, i zbërthyer nga kallëzimet e Marko Arbënashit.

Në këtë rrëfim dyshtresor, prova e narratorit ka të bëjë me krijimin e situatës sociale (mërgimi), që rrjedhimisht kalon në një situatë irrealë, ëndërrimtare, eterike (Petrushi-lugat), në situatën e karakterit.

Edhe në rrëfenjën “Natë listopadhi” (në versionin e ri “Natë vjeshtë të tretë”), shpaloset bota e ëndrrave dhe modeli i personazhit lëviz nëpër qarkun mitik e përrallor, duke e kapur si motiv esencial rrëfenjën apo kallëzimin për hanzën e Rrapsallit një nga format përkatëse narrative të dimensionit fetar (kësaj radhe, murgu Zafir Kulira), narratori e sugjeron forcën misterioze të kallëzimit për të sprovuar rrëfimin tjetër, atë të Babagjyshit, i cili rrëfen për Gropën e qoftëlargut. Po në këtë rrafsh të narratologjisë, Kuteli në shikimin e situatave aktivizon personazhe-bartëse të veprimit apo vrojtues qëllimorë, që bëhen detyrimisht bashkëbisedues midis narratorit, vetë personazheve dhe lexuesit.

Ky fakt, vetvetiu e riprodhon narracionin përrallor të ngjarjes me fiksionin, botën e ëndrrave, duke e veshur tregimtarinë me velin e fantastikës e të misticizmit dhe herën tjetër me një imazh irreal. Parimi poetik i tekstit narrativ ka të bëjë me personazhin e rikthyer emocionalisht e moralisht në figurë apo për të fshehur fytyrën e tij të vërtetë në një «botë të përjetme».

Rrëfenja “Lugetrit e fshatit tonë”, që e ka mbititullin “Letrat e ndajnatës”, e përfaqëson tipin e shkrimit kutelian që gjithnjë i rikthehet një veprimi të protagonistit «gjysmë të gjallë e gjysmë të vdekur», apo një bote të vdekshme, bie fjala, si në tregimet e Çehovit.

4.

Novela “E madhe është gjëma e mëkatit” (Tat Tanushi i Bubutimës), së bashku me “Vjeshtën e Xheladin beut”, qëndrojnë në krye të letërsisë tregimtare të Mitrush Kutelit. Kjo vepër si kompozim tekstori poetik e shqipton kodin biblik, mitologjik dhe fantastik. Novela i ka tri pjesë: e para - esenciale, e dyta- fragmentare, e treta, vetëm epilog i shkurtër.

Pikëshikimi i narratorit përqendrohet te thelbi i narracionit, i cili ndërlihet me Kalijen dhe mëkatit dhe me renditjen e ngjarjeve të vargëzuara nga ana e Tat Tanushit, prift ortodoks, i cili ungjillëzonte «atëbotë» në një katund të Ilirisë, që quhej Bubutimë, por më vonë i hiqet e drejta e të meshuarit. Dhe rrëfimi rrjedh valë-valë nga Liqeni i kaltër... (i Lasgushit dhe i Kutelit), duke hyrë dhe ngulitur nëpër qarkun e metatekstit.

Tat Tanushi i modelit biblik e hyjnor e zbërthen vërtetësinë e së ndodhurës, atë legjendë ilirike të dëgjuar nëpër gojën e karaktereve fetare dhe atë shëmbëllim të përvujtnisë nga Shkrimi shenjt ku synohet ngjallja dhe imitimi i një veprimi lutësor e predikues. Kësisoj, Shkrimi shenjt, këtu bëhet përmbajtje esenciale e rrëfimitarisë së Kutelit, ku historia, legjenda, urata, dashuria etj., bëhen tregues tematiko-motivor.

Tat Tanushi nuk mediton, por vepron me predikimet e tij. Në shpirtin e tij përpëliten fuqimisht temë-dilemat e jetë-vdekjes apo tokësorja e qiellorja, lënda apo shpirti. Kjo novelë me shtresimin e temës dhe me funksionalizmin e idesë abstenon nga ekzistencializmi i vet.

Narratori në këtë novelë «detyrohet» ta rishfaqë dashurinë, aktin dashuror të Tat Tanushit me Kalijen. Kodi i tekstit liturgjik nuk e lejon dhe tashmë Kalija është botë e humbur dhe e vdekur, sepse të pamundurat bëhen vetëm me hirin e fjalës. Kështu vetvetiu lind drama

e brendshme shpirtërore e kryeprogonistit në momentin kur nuk pikturohet figura e saj mrekullitare, por mbetet e përhumbur shpesh në kujtesën dhe vizionin e Tanushit.

Në këtë novelë rrëfimi bëhet në vetën e tretë dhe gjithsesi me kthesa të papritura. Shpirti njerëzor i personazhit nuk pajtohet me gjendjen, me praninë vetmitare dhe si i tillë e shenjon faktin, edhe atëherë kur lëçitësit mund të mos i pëlqejë. Pra, Gazi i dytë i Uratës pas Tenëzot që ish-Kalija, e shoqja e Tat Tanushit, shpërfytyrohet nëpër tisin e atij rrëfimi të këputur fantastik, që kërkon ndryshimin e ndjenjave e që ndërlidhen me ngjalljen apo në dialogimin e dy shpirtave dhe të dy botëve, pikërisht atëherë kur Noemi i Galileë bëhet Kalije.

Novela “E madhe është gjëma e mëkatit”, sikur e vijëzon, fund e krye, karakterizimin burimor të teksteve biblike që kanë të bëjnë, veçan, me lëndën dhe frymën (mbillet trup lëndor e ngjallet trup shpirtëror). Ky kod i përfytyruar biblik, lëviz në botën e ndjenjave të Tat Tanushit, i cili Kalijen e përkund dashurisht në misterin e ëndrrave të tij.

Teksti narrativ i Kutelit në thurjen e tij sikur i shtreson dy rituale të intrigës kallëzimtare: ritualin e lëndës, që ndërlidhet me trupin e gjallë të Kalijes, pra me vizionin e jetës dhe ritualin, që ndërlidhet me frymën, me çastin e përfytyruar vdekjesor të Kalijes, që shndërrohet si skelet në duart e Tat Tanushit. Këtu puqen mendimi me ndjenjën, realiteti me irrealitetin, jeta me vdekjen, lënda me shpirtin apo, madje, edhe thënia misterioze se: "i vdekuri ishte gjallë".

Pjesa e dytë e novelës “E madhe është gjëma e mëkatit” ndërlidhet tashti me instinktin adhurimtar të vdekjes së Tat Tanushit, pra me vdekjen e dëshiruar.

Në vijim, detyrimi i tij shpirtëror, pasi që e kuptoi se nuk vdiste dot, në ceremoninë e ekzistimit e të përvujtnisë, Tanushi, megjithatë, e duronte jetën. Ritmi tragjik mbaroi me skicimin, portretimin e fytyrës së Kalijes dhe ritmi i katarsisit, i spastrimit nga mëkati e synon perceptimin e ri të gjendjes së tij. Pra, drita e njerëzimit apo drita e Hyjnisë ia dëfton rrugën e mundimeve dhe Tat Tanushi, jo befas, bie në asketizëm.

Novela “E madhe është gjëma e mëkatit”, është shembull karakterizues ku mbizotëron sensibiliteti biblik-mitik-përrallor. Prania e veprimeve të karaktereve është kundërthënëse përbrenda lidhjeve

vargëzore të situatave në formën ligjërimore me një pamje fotografike: jeta brenda varrit, drita brenda natës, hiri brenda shtatit mëkatar.

Arti i thurjes së situatave prapë e shenjon përfytyrimin tjetër të figurës së ëndërruar (Kalijes), plasaritet në shpirtin e protagonistit (Tat Tanushi), ai përmallim i hirit të fjalës apo ajo dritë hyjnore, që e nënkupton përsëritjen ciklike të ëndërrimtarisë së imazhit të përhumur në ndërdije.

Kjo skenë e ringjalljes e kap domethënien psikologjike të përfytyrimit dhe të rishfaqjes engjëllore pas atij çasti lutësore, duke e thurur në vete dramën morale të qeniesimit shpirtëror në atë marshim të pafund të dhembjes, në atë lirim prej saj, kur motivimi i novelës e zmadhon figurën e së dashurës, atë "plagë të pashëruar", që pikturohet me ngjyrat më të tejdukshme me hisen e fajit të Tat Tanushit, personazh i veçantë në tërë tregimtarinë e Mitrush Kutelit.

Pjesa e tretë dhe e fundit e novelës është epilog i shkurtër, që e dëfton dialogun ndërmjet Tat Tanushit dhe Imzot Nikanorit. Aty, flitet për gjunjëzimin, mëkatet për ndjesë, për kungatën dhe bekimin. Pastaj, bëhet shfaqjesimi i Tat Tanushit, i cili hyn në altar për të bërë meshën e madhe dhe e "zgjidh" fjalën nga mallkimi.

Personazhi Tat Tanushi e hulumton dashurinë njerëzore dhe detyrimin hyjnor në rrafshin e ideve. Kalija është vetëm një figurë e adhurimtarisë së tij, një figurë e përsosur: një herë e gjallë, e gjithmonë e vdekur. Në novelë, shëmbëlltyra e Hyjnisë është e paprekshme, ndërkaq, priftërinjtë janë vetëm vështrues të ndodhisë prej nga bartet mëkati. Teoria e shkrimit i dëfton edhe këto gjendje: veprimi i novelës është përqendruar në kohën e Ilirisë. Bubutima është e po atij ambienti. Nga koha objektive bartet fabula në kohën subjektive dhe rrëfimi i këtyre dy legjendave të dëgjuara tregohet nga Liqeni i kaltër. Rrjedhimisht, fill e fund, në tekstin narrativ përfytyrohet e shpërfytyrohet situata themelore, e cila funksionalizohet përmes mëkatit. Prandaj, Tat Tanushi, Kalija e vdekur dhe mëkati, së bashku, e thurin një dramë shpirtërore në kohën metaforike të përvujtnisë.

(Fragmente nga një studim i gjatë)

Nasho JORGAQI

MODELI KUTELIAN I RRËFIMIT

Vepra e gjerë letrare e Mitrush Kutelit përbën, pa dyshim, një nga përvojat artistike më të vyera dhe më interesante të prozës sonë. Një përvojë origjinale, që mban vulën e një personaliteti të spikatur krijues.

Njohja dhe studimi i këtij individualiteti artistik kërkon doemos që të depërtohet në hapësirat e artit të tij, të hyhet në laboratorin e punës së shkrimtarit, të zbulohen të fshehtat e mjeshtërisë së rrëfimit. Pa hetuar e studiuar nga afër këto, nuk mund të përcaktohen si duhet tiparet origjinale të artit kutelian, të dalë i qartë vokacioni që ai përfaqëson në letërsinë tonë.

Rrëfimi, si një nga llojet e prozës tregimtare, që e shohim të nisë të lëvrohet në letërsinë tonë nga fundi i Rilindjes e më pas, në penën e Kutelit u ngrit në një shkallë të paparë, duke fituar cilësitë e vërteta të llojit të vet. Ai, jo vetëm krijoi një tip të ri tregimi, por i dha këtij lloji epik vulën e individualitetit të tij. Për këtë gjë, Kuteli thotë se nuk ndoqi asnjë model të huaj, po u mbështet në traditën e pasur të prozës sonë popullore, fryma dhe poetika e saj u bënë për shkrimtarin modeli më i mirë. Kjo mënyrë të treguari dhe të enduri i dha mundësi atij të ngërthente një lëndë sa më të pasur nga jeta e historia, por dhe të realizonte edhe ato synime themelore që kërkon tipizimi dhe individualizimi artistik i personazheve, thurja e konflikteve, ndërtimi i situatave, përshkrimi i mjediseve, shfrytëzimi i detajit etj.

Rrëfimet e Kutelit kanë një varg tiparesh që përcaktohen nga brendia e laryshia tematike, por edhe nga veçanësia e mjeteve shprehëse, nga poetika që ai ka shfrytëzuar në raste të ndryshme. Poetika e rrëfimeve të tij është poetika e rrëfimit popullor, veçse e përpunuar artistikisht nga mjeshtri, e kthyer në një mekanizëm të të

strukturuarit artistik. Një shqyrtim nga afër nxjerr në pah natyrën dhe veçoritë e poetikës kuteliane. Së pari, në të, ashtu siç ndodh dhe në rrëfimin popullor, një rol të rëndësishëm luan figura e rrëfimitarit. Ai krijon raporte të caktuara me dëgjuesin, me kohën dhe me hapësirën dhe kthehet në personazh unik i gjithë prozës së tij tregimtare. Rrëfimtari dhe autori shpesh shkrihen në një ose zëvendësojnë njëri-tjetrin.

Funksioni i rrëfimitarit të Kutelit është i gjithanshëm. Me anë të tij bëhet zbulimi i tipit dhe karakterit të personazheve, përshkrimi i situatave psikologjike dhe i gjendjeve shpirtërore, shtjellimi i konflikteve. Nga mënyra si ai tregon ngjarjen, si zbulon figurën, çfarë thotë e çfarë lë pa thënë, detaji që përdor, të gjitha këto i shërbejnë strukturimit artistik të veprës. Nga ana tjetër, në këtë lloj tregimi merr rëndësi të veçantë raporti i rrëfimitarit me lexuesin, pasi ai synon të jetë më i natyrshëm e komunikues e të krijojë lidhje të drejtpërdrejtë mbi një bazë të përligjur psikologjike. Në këtë mes, fjala ka një peshë të madhe semantike dhe emocionale dhe artikulimi i saj gjatë rrëfimit varet në një shkallë të madhe nga ritmi i të treguarit.

Elementet e poetikës në rrëfimet e Kutelit duhen parë dhe në veçoritë e subjektit e të fabulës, në pasurinë e detajit, në variacionet e ligjërit, në origjinalitetin e kompozicionit. Fabulat kuteliane paraqiten në dukje të thjeshta, pa ndërlikime e me një zhvillim të natyrshëm, por rrokin shumë anë të realitetit, duke depërtuar në thellësi e duke u shtrirë në hapësirë e në kohë. Në qendër merren ngjarje të rëndësishme, çaste kulmore të jetës dhe ndërthuren konflikte të ashpra me tension dramatik. Përveç kësaj, Kuteli, në prozën e tij rrëfimtare e historike, udhëhiqet nga sqarimi retrospektiv që i bën kohës së fabulës dhe kohës së veprimit. Kjo do të thotë se largësia kohore është veçori e poetikës së tij. Një gjë e tillë vërehet qartë nga mënyra e të perceptuarit të ngjarjeve, nga sistemi i ndërtimit të personazheve dhe raportit midis tyre, si dhe nga dialogu e monologu dhe, veçanërisht, nga pikëvështrimi i rrëfimit.

Zakonisht rrëfimet ngrihen mbi një subjekt të përbashkët, por ka dhe sosh që subjekti përfshin brendapërbrenda ngjarje dhe episode, personazhe dhe mjedise, që i bashkon filli i rrëfimit të rrëfimitarëve ose autorit. Disa herë kemi ngjarje të lidhura zinxhir, apo brenda tregimit thuren rrëfenjëza për të bërë pastaj kalimet përmes disa

nyjave lidhëse. Kjo s' duhet parë si dobësi kompozicionale, por në natyrën e rrëfimit popullor.

Në rrëfimin kutelian detaji është një nga mjetet më efektive të procedurës artistike dhe si i tillë paraqitet i shumëllojshëm. Me vetitë e tij artistike, detaji i shërben drejtpërdrejt procesit të individualizimit e të tipizimit, konkretizon natyrën e fenomenit në përputhje me logjikën psikologjike e artistike.

Ashtu si te tregimtarët e tjerë dhe te rrëfimet e Kutelit gjejmë edhe gjykimin e rrëfyesit mbi atë që tregon, siç gjejmë dhe përshkrimin, dialogun e monologun. Por merita e autorit tonë, në këtë rast, është se këto forma e mjete të njohura i ka përdorur e shfrytëzuar me origjinalitet e me mjeshtëri të lartë artistike. Kështu, vërejmë se të treguarit e Kutelit është sa analitik aq edhe sintetik, i shprehur zakonisht me ritmin e kadencën e bisedës, me një dinamikë të brendshme. Mënyra si tregon e rrëfen jo vetëm pasqyron e vizaton, por bën të përftohen veprime e lëvizje.

Shprehja më e plotë e mënyrës së rrëfimit të Kutelit janë përshkrimet. Përshkrimi tek ai është i fuqishëm, karakterizues dhe i harmonishëm. Autori e përdor si për të dhënë situatë e mjedise, ngjarje dhe ndeshje, por ai merr vlera të veçanta kur është fjala për peizazhin e portretin. Në këtë vështrim, Kuteli paraqitet mjeshtër i shquar. Mjeshtër i pikturimit të natyrës dhe mjeshtër i fizionomisë njerëzore, peizazhist e portretist i dorës së parë. Prandaj, me të drejtë mund ta quanim poet i shpirtit shqiptar dhe këngëtar i natyrës shqiptare. Në përshkrimet e natyrës, proza tek ai kthehet në poezi dhe faqe të tilla, që hasen me dhjetëra në rrëfimet e tij, tingëllojnë si proza poetike të denja për çdo antologji. Përshkrimet e Kutelit janë copa të gjalla jete, plot nerv e lëvizje, krejt të vetvetishme, mburjtur me gjendje shpirtërore dhe mendim fisnik, me larmi figurative e nota të fuqishme emocionale.

Pjesë e pandarë e prozës së Kutelit janë dhe dialogu me monologun, të cilët së bashku me përshkrimin ndërtojnë veprën. Ato shfaqen në situata të caktuara, si një nga burimet e informacionit, por akoma më shumë, me funksion tipizues e individualizues. Mënyra e thurjes së tyre, veçoritë gjuhësore, leksiku dhe ndërtimi sintaktik i bëjnë ato që, objektivisht, të bartin psikologjinë e personazheve, botëkuptimin dhe mentalitetin, shkallën e kulturës dhe temperamentin.

Në qoftë se dialogu qëndron brenda kufijve të gjuhës së bisedës, është i gjallë e i shtruar në varësi nga rrethanat, ruan ritmin e saj, monologu ka nëntekst të qartë, rrjedh pa artifice dhe në harmoni me komponentët e tjerë. Në të dy rastet ndihet qëndrimi ideoemocional i autorit dhe është i pranishëm tendencioziteti i tij.

Poetika e prozës së Kutelit nuk mund të kuptohet pa poetikën e kompozicionit të rrëfimeve. Ndërtimi që u bën ai atyre është origjinal dhe me veti artistike të qarta. Zakonisht ato janë në varësi nga rrëfimtari dhe rrëfimtari luan rol organizues në kompozicionin e tregimit. Ai paraqet hyrjen, subjektin, ka fillin e intrigës, bën zgjidhjen. Ekzistojnë marrëdhënie të brendshme të vazhdueshme në mes rrëfimitarit, heroit dhe lexuesit dhe janë këto që përcaktojnë karakterin e ndërtimit të tregimeve. Ato mund të përputhen ose mund të diferencohen nga njëri-tjetri. Dhe janë këto marrëdhënie që u japin laryshi trajtash rrëfimeve. Po pavarësisht nga kjo, rrëfimet në përgjithësi kanë një gjë të përbashkët: autori përpara se të tregojë, e përgatit lexuesin. Është ai që ndjell atmosferën, përgatit mjedisin dhe njerëzit që do të dëgjojnë e pastaj i fut në labirintet e rrëfimit.

Subjekti i rrëfimeve të Kutelit ndërtohet në mënyrë të atillë që të rrokë gjithë jetën e heroit ose një pjesë të saj. Brenda subjektit ai integron organikisht, si komponent të përgjithshëm edhe digresione të ndryshme, të gërshetuara këto me përshkrimin dhe dialogun. Në këtë pikëpamje gjejmë struktura origjinale, si shprehje të poetikës së autorit.

S'ka dyshim se thesari më i çmuar që na ka lënë Kuteli si shkrimtar është gjuha. Me të drejtë, ai cilësohet një nga mjeshtrit e mëdhenj të saj, një nga stilistët e mbarë letërsisë shqiptare. Adhures dhe ndjekës besnik i gjuhës së rilindësve, i ushqyer në gurrën e pasur të të folmes së vendlindjes, Kuteli do të formohet si shkrimtar sa në shkollën e gjuhës shqipe, aq edhe në atë të jetës shqiptare. Konceptet e tij për gjuhën amtare, janë jo vetëm ato të një atdhetari të flaktë, që e sheh atë si një nga tiparet e qenësishme të kombit dhe pasuri të madhe shpirtërore të popullit, po dhe të një artisti të shquar, që i përkushtohet asaj shpirtërisht, intelektualisht e fizikisht. Kuteli mahnitet pas forcës e bukurisë së gjuhës shqipe, pasurive dhe hireve të saj, e shenjtëron dhe e kthen në kult. I ndërgjegjshëm për vlerat dhe rolin e gjuhës në jetën dhe kulturën e kombit të vet, ai punon pa u lodhur për t'i njohur

e përvetësuar thesaret e saj, për të depërtuar në hapësirat dhe skajet e saj, për të pushtuar majat dhe thellësitë, por dhe për t'u kredhur në shpirtin e fjalës shqipe. Vetëm kështu Kuteli arriti të krijojë veprën e vet letrare. Puna e tij e nisur në vitet 20-30, bën pjesë në përpjekjet madhore të atyre prozatorëve, që e ngritën gjuhën shqipe dhe këtë gjini në nivelin e një gjuhe me të vërtetë artistike me vlera të reja estetike dhe ideioemocionale. Kjo ishte një çështje themelore për prozën tonë, sepse ajo s'mund të bënte atë kapërcim cilësor që bëri, pa iu shmangur gjuhës retorike, skematike e sentimentaliste që zotëronte përgjithësisht.

Duke e studiuar nga afër gjuhën e Kutelit, do të vëmë re se ajo përbën një nga kapitujt më të pasur e më me vlerë të prozës sonë të traditës dhe jo vetëm të asaj. Ajo dallohet si një gjuhë e mbrojtur me jetë të gjallë, me forcë të brendshme, me begati dhe bukuri të madhe. Veç kësaj, gjuha e Kutelit karakterizohet nga cilësi të larta të ligjëritit artistik, jo vetëm për nga leksiku i pasur dhe i pastër, por dhe nga fryma ngjizëse, nga aftësitë analitike e sintetike, nga vetitë ndërtuese, të një sintakse thjesht shqip. Vitaliteti i saj duket dhe nga pasuria figurative e muzikore, nga nuancat e holla stilistike.

Kuteli është një nga stilistët që i ka të paktë shokët në letërsinë tonë, një stilist me individualitet, me tipare krejtësisht të vetat. Ai u krijua si i tillë duke përvetësuar me themel gjuhën e popullit, duke iu përmbajtur me konsekuencë ligjeve të rrëfimit popullor. I ndjeshëm në një shkallë të lartë ndaj gjuhës, me sensin e një artisti të hollë, me një kulturë të gjerë letrare dhe me synime ideoartistike të ndërgjegjshme, ai diti të krijojë një stil origjinal. Stili i tij ligjëron shqip, është sa lirik aq edhe epik, elegant dhe me ngjyrim poetike, i pasur me frazeologji dhe i nuancuar. Ai paraqitet sa i qetë e i shtruar, aq edhe i shqetësuar dhe shpërthyes, sa analitik aq edhe lakonik, por gjithnjë plazmueshëm dhe me natyrë rrëfimtare. Fraza e tij rrjedh natyrshëm dhe me një harmoni të brendshme, me kadenca nga më të ndryshmet. Variacionet që merr ligjërimi artistik në gjuhën e Kutelit janë të pasura dhe të shumëllojshme, ato ndërrojnë në përshtatje me brendinë ideore, me psikologjinë e personazheve dhe tensionin dramatik.

Në prozën e Kutelit gjejmë një përvetësim krijues të gjuhës së prozës popullore. Në këtë pikëpamje, ai është treguar artist me sens mase, ka ditur ç'të marrë e ç'të lërë. Merita e tij është se ka arritur të

depërtojë në shpirtin e ligjëritimit e të rrëfimit popullor. Fjala e nuancuar dhe frazeologjia popullore në gjuhën e Kutelit qëndrojnë në harmoni të plotë me stilin e tij. Kultura dhe erudicioni i pasur i autorit nuk arrijnë asnjëherë të intelektualizojnë prozën e shkrimtarit. Bile, duke u distancuar së jashtmi, ai rrëfen e përshkruan në natyrën e mjeteve tipike të gjuhës e rrëfimit popullor, pa u bërë rob i tyre, larg çdo natyralizmi.

Marrëdhëniet e Kutelit me folklorin dhe, përgjithësisht, me krijimtarinë popullore janë të gjithanshme, të thella e të frytshme. Ndoshta, askush në prozën tonë të traditës nuk diti dhe nuk arriti të përfitojë nga kjo pasuri në dimensione aq të gjera sa bëri këtë Kuteli. Pa lënë anash traditën e letërsisë sonë kombëtare, adhures i Naimit e i Nolit, po dhe njohës i thellë i letërsisë së huaj, Kuteli në mënyrë të ndërgjegjshme u mbështet në radhë të parë në modelet dhe përvojën artistike të popullit dhe i dha fizionominë e tij. Kjo ndodhi, se në këtë proces të gjatë e të vështirë, shkrimtari ynë bëri për vete shpirtin dhe frymën krijuese të popullit, përvetësoi ligjet estetike dhe etike të rrëfimit, mekanizmin e brendshëm të të treguarit dhe të gjitha këto arriti t'i japë brenda natyrës gjuhësore të fjalës së popullit.

Pesha e Kutelit në letërsinë tonë të traditës e veçanërisht në prozën e saj nuk është vetëm ajo e një talenti të shquar, por edhe i një fenomeni që rrezatoi dhe jashtë vetes. Me individualitetin e tij artistik, si krijues i një tipi të veçantë të tregimit, me stilin dhe gjuhën që përdori, ai hapi një brazdë të re në prozën tonë tregimtare, krijoi një shkollë të tregimit shqiptar. Nëpër të do të kalonin disa nga tregimtarët e brezave të mëvonshëm si, J. Xoxa, N. Prifti, A. Kondo, S. Andoni etj.

Trashëgimia letrare e Kutelit është e gjerë, e pasur dhe e fuqishme. Në të gjejmë, po të shprehemi me fjalët e tij, *“botën e vogël shqiptare, që pasqyron botën e madhe”*. Është toka dhe qielli ynë, janë malet dhe fushat tona, ndrisin ditët dhe netët shqiptare, janë zërat e ngjyrat e tyre. Në këtë botë jeton e mbijeton njeriu shqiptar, të cilin shkrimtari e ka dhënë përmes rrëfimeve të tij me fizionomi e relief të qartë shpirtëror e fizik.

*Atalanta Pasko PEKMEZI***MBI DISA NDRYSHIME NË GJUHËN E KUTELIT NË
BOTIMET PAS VITIT 1967 – KRIJIME ORIGJINALE E
PËRKTHIME**

Fjala, lënda e parë e çdo vepre letrare, mban në krijimtarinë e Mitrush Kutelit peshën e mendimit dhe kuptimit po aq sa edhe peshën e detyrës për të tingëlluar sipas zgjedhjes dhe shijes së Autorit dhe për të transmetuar nuancat më të holla përmes gjithë elementeve të saj përbërëse – të afta për të ndryshuar në hapësirë dhe kohë.

Kur kalonte nga njëra fushë në tjetrën, nga shkrimet ekonomike në letërsi artistike, ai ndryshonte “lëndën e parë”, gjuhën që përdorte, jo vetëm si tërësi leksiku, që u takon fushave të ndryshme, por bënte dhe kapërcime dialekti e kapërcime kohe dhe përdorte jo vetëm fjalë, po edhe trajta gramatikore të vjetra apo të vjetëruara, për të rritur efektin artistik edhe përmes drejtshkrimit.

Tipari që mbetet i pranishëm kudo, si një fill që dallon tërë krijimtarinë e tij, është muzikaliteti.

Megjithatë, kur flasim për gjuhën e Kutelit, që të jemi të saktë, duhet të bëjmë një ndarje sipas vitit kur është bërë botimi. Kjo, për shkak të disa faktorëve që kanë ndikuar pavarësisht dhe madje kundër vullnetit të Autorit. Nga ky këndvështrim, dallojmë katër periudha:

1. Botimet para vitit 1945, kur Kuteli vendoste vetë për gjuhën e shkrimeve dhe përkthimeve të veta.

2. Botimet pas vitit 1944 (më saktë pas vitit 1949), deri në vitin 1967, kur Kuteli u përpoq, me sa mundi, të ruante gjuhën e vet në shkrimet dhe përkthimet e veta, duke u ndeshur me redaktorin dhe korrektorin zyrtar.

3. Botimet e viteve 1967-1990, kur redaktori dhe korrektori zyrtar diktuan gjuhën e Kutelit.

4. Pas vitit 1991, kur ndryshimet në marrëdhëniet autor-botueshtet, i dhanë tjetër ngjyrë funksionit “redaktor” e “korrektor”.

Pesha e ndryshimeve që pësonte gjuha e veprave origjinale ose përkthimeve dhe marrëdhëniet redaktor e korrektor, nga njëra anë, dhe autor ose përkthenjës, nga ana tjetër, janë pasqyruar në disa relacione dhe në sa e sa fletë e fletushka me shënime që Kuteli i ka kushtuar këtij procesi të punës së botimit. Themi “janë pasqyruar” dhe jo “janë dokumentuar”, pasi Kuteli ka shkruar, madje me guxim, atë që mund të thuhej, por jo atë që nuk mund të thuhej, ndonëse të gjithë mund ta dinin. Të mos harrojmë, bëhet fjalë për vitet ’50-’60 të shekullit të kaluar!

Ndër relacionet është një me titullin **“Disa kundërshënime mbi shënimet e redaktorit Halit Qendro për përkthimin e librit me emër të vështirë të autorit A.E. Fersman”** – gjithsej shtatë faqe të daktilografuara. Në krye të faqes së parë, në të djathtë, nën shënimin “Motto”, ka disa vargje:

“Arzuhallet venë e vinë

“Mbi Moisi Efendinë:

“Moisi, medet-medet,

“Bëj një punë për rahmet

“Se na bënë ... për ibret.

“... Dhe, të fala me shëndet!”

(Sipas një kënge të vjetër popullore)

Kjo, mbase, shenjë nostalgjie për bashkëpunimin me redaktorin Moisi Zaloshnja, në një kohë kur puna me një redaktor tjetër i kish dhënë shumë gjakprishje.

Në një material tjetër, dhjetë faqe të daktilografuara, me titullin **Disa shënime mbi relacionin e redaktorit Razi Brahimi lidhur me**

përmbledhjen time “Rrëfime të vjetra”, Kuteli i ndan në tri grupe vërejtjet që i bëhen: grupi i parë – ortografi e gjuhësi; grupi i dytë – lënda përbërëse e vëllimit; grupi i tretë – struktura e disa rrëfimeve me propozime për të bërë disa ndryshime.

Po riprodhojmë disa pjesë nga përgjigjja e Kutelit ndaj vërejtjeve të grupit të parë, ku ai shpjegon dhe mbron zgjedhjet dhe shijet e veta gjuhësore.

Siç dihet, rrëfimet e paraqitura në këtë përmbledhje janë shumë të vjetra. Ato janë shkruar dhe botuar midis viteve 1927 (po të brumosura më parë) dhe 1943, me ndërprerje të gjata. Gjuha, në përgjithësi, është ajo e toskërishtes së përbashkët, por me shumë leksik dhe shprehje nga e folmja e rrethit të Pogradecit në kohën kur janë shkruar.

Ortografia ndjek, në përgjithësi, udhën e së folmes, pra të tingullit.

Razi Brahimi sugjeron të përdorë ortografinë e sotme. Jo vetëm sugjeron, por edhe ka bërë ndryshime në tekst, me bojë. Megjithatë një veprim i tillë sjell pas veti edhe ndryshime tingujsh, prapëseprapë nuk kundërshtova dhe bëra një sërë ndryshimesh të tilla.

Më tej, Kuteli thotë se:

ka pranuar që “i math”, të bëhet “i madh”, “rrjeth” të bëhet “rrjedh”, “mbleth” të bëhet “mbledh”, etj., por vëren se kjo e largon gjuhën e shkruar nga shqiptimi;

ka pranuar që foljet “gjetmë”, “fjetmë”, “vajtmë” etj., të bëhen “gjetëm”, “fjetëm”, “vajtëm”, por shkruan se kjo trajtë “i largohet së folmes reale të zonës ku zhvillohen tregimet dhe kohës përkatëse”.

Po ashtu, thotë se ka pranuar që trajtat lokale “fellë”, “Qamilë”, të bëhen “thellë”, “Qamilin”. Për këto lëshime, Kuteli shkruan: “... kjo punë më dhemb, sepse ndryshon realitetin e gjallë gjuhësor të kohës, ndryshon kumbimin e fjalisë, etj. dhe gjuha ime bëhet lara-lara.”

Po aty, rendit dhe çfarë nuk ka pranuar të ndryshojë:

Në trajtat “tregonja”, “mësonja”, “largonja”, shkruan se ka ruajtur “tingullin real ‘nj’” dhe nuk e ka zëvendësuar me “j”. “Kjo do të më sillte një shtrembërim tepër të madh të së folmes së vjetër, reale,

të protagonistëve, një shtrembërim tingulli. Siç dihet, ndryshe flet mokrari, ndryshe vlonjati. Sidomos flisnin ndryshe sot e 30-40 vjet, kur janë brumosur tregimet e mia”, shkruan Kuteli.

Trajtën e përëmrir “ay”, nuk pranon ta zëvendësojë me “ai”, që thotë se është një tingull më i butë dhe nuk i përshtatet së folmes të heronjve të tij. Prandaj shkruan: *“Lutem të m’i ruani, të paktën këta tinguj”.*

Nuk pranon ndryshimin e trajtës “shëmbitër” me “shëmitër” dhe as “shkumbë” me “shkumë”: për të parën, për shkak të prejardhjes nga trajta e vjetër “Bitri”; për të dytën shkruan se kjo do kërkonte ndryshimin edhe të toponomastikës, duke e bërë “Shkumbanoren” – “Shkumanore”.

Nuk pranon që “njëri”, “njëra”, “qënë”, të bëhen “njeri”, “njera”, “qenë” dhe shkruan: *“Kam frikë se duke vepruar në këtë mënyrë do të kalojmë dalngadal në shqiptimin e shëmtuar çalaman të minoritarëve ‘unë bej’, ‘unë kam berë’ në vënd të ‘unë bëj’, ‘unë kam bërë’, etj. etj”.*

Edhe në këto shënime mbi një relacion, Kuteli shkruan me emocion dhe pranon se nuk i pëlqen “ajo ‘ë’-ja zgjatëse, jugorçe, zvarritëse, gjarpërore”. Këtu rreshton “mallkuar”, “vjetra”, “ujra”, “femra”, në vënd të “mallëkuar”, “vjetëra”, “ujëra”, “femëra”, që, vëren ai, ia kanë ndryshuar në shkrimet e tij origjinale dhe në përkthime.

“... të përpiqesh t’i detyrosh të tjerët – shkrimtarët dhe përkthenjësit pleq – të përdorin trajtat e tua dialektore (siç bëjnë disa redaktorë ose korrektorë letrarë) më duket abuzim fuqie, shpërdorim detyre”, shkruan ai.

Në fund, pasi kundërshton prerë “këshillat” e redaktorit për ndryshime në strukturën e disa tregimeve, Kuteli bën dhe një rrëfim të dhimbshëm:

“Autori i do veprat e tij si fëmijët e vet. Sidomos ato që ka shkruar në të ri, spontaneisht. Edhe unë i dua të miat. Po të doni botojeni këtë përmbledhje, po të mos doni – ç’të bëj unë i ngrati? – mos i botoni. T’ju them të drejtën, e ndjej veten shumë të lodhur nga puna që kam bërë dhe sorollatjet dhe i ndjej krahët të prerë për atë që dua të bëj, për një përmbledhje të dytë, të ripunuar (që më e mira ta

mundë të mirën). Mirëpo ne po bëjmë më shumë bisedime, polemika e ecejakë, se sa punë, art...”

Ky material mban datën 29 maj 1966.

Kuteli nuk i pranoi “këshillat” për ndryshime dhe e tërhoqi përmbledhjen, ndonëse e kishte ripunuar dhe bërë gati për botim me kërkesën e vetë shtëpisë botonjësë “Naim Frashëri”. Ai u largua nga kjo botë pa u mbushur viti.

Gjuha e botimeve të mëpasme dhe ribotimeve të veprës dhe përkthimeve të Kutelit shënohet nga dy faktorë, njëri subjektiv – predispozita e redaktorit (bashkë me korrektorin) dhe tjetri objektiv – Kongresi i Drejtshkimit i vitit 1972. Mënyra si u zbatuan vendimet e Kongresit përmes një sërë shtrëngimesh e darash, kapërcente kuadrin gjuhësor e merrte ngjyrimë politike.

Përmbledhja me rrëfime të vjetra u botua në Tiranë më 1972. Meqenëse familja e Kutelit ngurronte të dorëzonte materialin, pasi druante mos bëheshin ndryshimet që Autori nuk i kishte pranuar, prof. Nasho Jorgaqi, redaktori i vëllimit, dha fjalën se nuk do bëhej asnjë ndryshim, nga ato që mund të tjetërsonin veprën. Dhe, vërtet, nuk u bë asnjë ndryshim në strukturën e rrëfimeve. Ndërsa ana gjuhësore dhe ortografia pësuan mjaft ndërhyrje dhe ndryshime, aq më shumë se ishim në vitin e Kongresit të Drejtshkimit.

Ky libër doli në kuadër të serisë me tregime të zgjedhura nga autorë të ndryshëm shqiptarë, më 1972. Ndërkaq, në Prishtinë ishte botuar vëllimi *Ago Jakupi dhe rrëfime të tjera*, që më 1968.

Prof. Jorgaqi e pajisi përmbledhjen me një parathënie – studim të gjatë për vlerën e gjerë të veprës së Kutelit. Një studim edhe më i plotë i prof. Jorgaqit për Kutelin do të shoqëronte dhe *Veprën e Zgjedhur 5-vëllimshe*, botuar po nga “Naim Frashëri”, më 1989.

Ajo që bie në sy nga botimi në ribotim, është se në përgjithësi ishte zakoni të shtoheshin ndërhyrjet dhe ndryshimet: çdo grup i ri botues duhej të sillte dhe ndryshime të reja. Megjithatë, si botimi i

vitit 1972, ashtu edhe ai i vitit 1989, flasin në tërësi për punën që është bërë me respekt e dashuri dhe për ndërhyrje pothuaj vetëm të rendit ortografik. Për ndryshimet mbi origjinalin, redaktorja e botimit 5-vëllimësh, Rozeta Uçi, ka bërë edhe një shënim në fund të vëllimit të parë.

Në të dy botimet është ruajtur trajta **ne** që Kuteli e përdor në rrëfimet e tij në vend të parafjalës **te** (këtë të fundit ai e përdor rëndom në përkthime), ndërsa përemri **ay** është bërë **ai**, përveç disa rasteve të botimi i vitit 1972, ku mund t'i ketë shpëtuar korrektorit. Trajta foljore **zunë të shkrijnë, na ftoi t'ja marrim**, etj., janë bërë shumë herë (por jo gjithnjë) **zunë të shkrinin, na ftoi t'ja merrnim. Qënë dhe qënka** janë bërë **qenë dhe qenka**. Tingulli **nj** në folje si dëgjonje, është bërë **j** (dëgjoje).

Në botimin e vitit 1972, **ardhi** u bë **erdhi**, **kini** u bë **keni**, **pluhrosur**, u bë **pluhurosur**, **kohra** dhe **ujra** u bënë **kohëra** dhe **ujëra**, **be** (beu) u bë **bej**, **prallë** u bë **përrallë**, mullxhi u bë mullixhi.

Ndryshe nga botimi i vitit 1989, ai i vitit 1972 kishte ruajtur trajtën **ja** për **ia** (ja tha, ja dha, siç e përdornin rëndom shkrimtarë e përkthyes para Kongresit të Drejtshkrimit. Megjithatë, diku-diku, ndonëse rrallë, si të harruar, e gjen ndonjëherë këtë **ja** edhe në botimin e vitit 1989).

Në vitin 1989 u ndryshuan edhe disa trajta historike ose lokale, p.sh **gërqiisht**, u bë greqiisht, Shatrivani (toponim), u bë **Shatërvani**, **Selenik** u bë **Selanik**. Në këtë botim, edhe fjala **badjava**, e përdorur siç shqiptohet, me ndikimin dhe asimilimin e shqipes, u bë **badihava**.

Botimi i Prishtinës *Ago Jakupi e rrëfime të tjera*, ka ndjekur në përgjithësi ortografinë e origjinalit me disa përjashtime të vogla, që nuk përbëjnë rregullsi dhe duken më shumë si aksidente shtypi.

Edhe në ribotimet e librit *Tregime të moçme shqiptare* – 1969 e 1987 (Tiranë), 1971 (Prishtinë) dhe 1989 (*Vepra letrare* - Tiranë), janë bërë pak a shumë të njëjtat ndërhyrje gjuhësore (ato redaktoriale do të përbënin një kaptinë më vete) në krahasim me botimin e parë (1965): **krypë-kripë, hyp-hip, qënë-qenë, ndjen-ndien, t'ja-t'ia, ardhur-erdhur, lbardh-lëbardh**. Shtimi i ë-së në ribotime bëhet i

ndjeshëm sidomos në trajtat e ngurosurat si **dalngadal-dalëngadalë, ik'e ikë – ikë e ikë, udh'e mbarë-udhë e mbarë**, në trajtën e folur **misardhe**, që bëhet **mirë se erdhe**, etj.

Në fund të shënimit të redaksisë, në vëllimin e parë të *Veprës Letrare*, thuhet se hartuesit e kësaj përmbledhjeje kishin konsultuar botimet e mëparëshme të veprës së Kutelit, por jo *Në një cep të Ilirisë së Poshtme* (1983).

Në shënim nuk është thënë, por arsyeja pse u bë ky dallim ishte se te *Në një cep të Ilirisë së Poshtme*, ndërhyrjet kapërcejnë “detyrimet” e vendosura nga Kongresi i Drejtshkrimit dhe reflektojnë shijet personale apo dialektin e korrektorit letrar. Procedura e ndjekur gjatë këtij botimi ish e njëjta që kish ndeshur dhe Kuteli 20 vjet më parë: korrektori punonte mbi materialin e dorëzuar nga Autori ose përkthyesi, pastaj ky material daktilografuhej dhe pa e kontrolluar askush për ndonjë gabim teknik, e merrte redaktori, që tashmë kishte radhën të bënte vërejtjet e veta. Te *Në një cep të Ilirisë së Poshtme*, këmbëngulja e familjarëve të Autorit për të ndjekur botimin duke e konfrontuar dy herë me origjinalin, rresht për rresht, edhe në bocat, në kundërshtim dhe me praktikën e kohës, ndihmoi që ky libër të shpëtonte nga kaq e kaq gabime dhe gafa: fjalë e shprehje të ndryshuara pasi korrektori nuk i kuptonte, fjalë e rreshta të tërë që mungonin pasi ishin harruar gjatë daktilografimit dhe grupi botues, duke i marrë për “difekte” të Autorit, ish përpjekur “t’i ndreqte” me operacione ose arna, fjalë të ndryshuara thjesht për punë shije, etj. etj.

Por në këtë punim nuk ia vlen të rreshtojmë rreziqet nga të cilat shpëtoi ky libër. Mjaftojnë ato nga të cilat nuk shpëtoi, për ta klasifikuar botimin si një dështim të dhimbshëm.

Ndër ndryshimet që janë bërë në ribotimin e novelave dhe tregimeve të gjata të vëllimit *Në një cep të Ilirisë së Poshtme*, përmendim:

fjalë si **këndonjës, vepronjës**, u bënë **këndues, veprues**;

mbiemri **i pafaj**, u bë **i pafajshëm**; **e hidhët – e hidhur**; **të rrumbullta – të rrumbullakta**; **i tej pamshëm-i tejdukshëm**, etj.

emri **pagëtyrë** u bë **pagesë**; **xhaxho** – **xhaxha**; **mot** – **vjet**; **Tete Ngjelua** – **Teto Ngjela**; trajta lokale **Poradec**, e thënë nga personazhi, është bërë **Pogradec**;

janë shtuar shpesh parafjalë si: **pres padurim**, është bërë **pres me padurim**, **pothuaj gazmend** – **pothuaj me gazmend**; **kish qënë ëndërr** – **kish qenë në ëndërr**; etj.;

foljet **sos**, **shkisnin**, u bënë **mbërrij**, **rrëshqitnin**; **ish** dhe **kish**, u bënë kudo **ishte** dhe **kishte**;

ka ndërhyrje në trajtat e shkurtra, pa asnjë arsye gramatikore, p.sh. **t'iu**, bëhet **t'u**; **t'u**, bëhet **t'iu** dhe **t'ua**; **të** bëhet **ta**; **ia**, bëhet **i**; etj. etj.

është ndryshuar shumë herë numri i emrit, si në rastin **prehëret e malit**, që është bërë **prehëri i malit**;

një numër pafund **po** janë bërë **por** dhe **te** janë bërë **tek**, ose e kundërta;

presjet janë ndryshuar pothuaj kudo, janë hequr, po më shumë janë shtuar me bollëk, pika dhe pikëpresja janë bërë presje, presja dhe pika janë zëvendësuar me pikëçuditëse, etj, etj...

Këto janë disa nga ndryshimet që iu shtohen ndërhyrjeve të tjera, të cilat në një farë mase i diktonte zbatimi i ngurtë i drejtshkrimit dhe janë të njëjta me ato që përmendëm për botimet e tjera. Shënojmë se krahasimi i rrëfimeve të botuara të *Në një cep të Ilirisë së Poshtme*, është bërë me botimin e tyre të parë në disa numra të revistës *Nëntori*.

Ashtu si ribotimi i krijimeve origjinale, edhe ribotimi i përkthimeve shoqërohej përherë me ndryshime gjuhësore e drejtshkrimore. Por në ribotimin e kryeveprës së Gogolit, *Frymë të Vdekura*, më 1974, redaksia pati kujdes të ndryshonte edhe titullin, që në botimin e parë, në vitin 1974, Kuteli e kish përkthyer *Shpirtra të vdekura*. Më pas ai e kish lënë porosi që në ribotim, fjala **shpirtra** të bëhej **frymë** – dhe kështu u bë si në titull, ashtu edhe në brendinë e librit. Ndërsa për të tjerat, kuptohet, më 1974, s'mund të përfytyrohej që të mos respektoheshin normat e vendosura nga Kongresi i Drejtshkrimit.

Botimi *Frymë të Vdekura* i vitit 1974 mund të cilësohet si një shembull klasik i zbatimit të ngushtë të kërkesave të reja, të sapomiratuara, të drejtshkrimit. Përveç presjeve që janë shtuar e ndryshuar sipas një logjike sqaruese e lodhëse, ndryshimet e tjera kanë të bëjnë tërësisht me normat dhe ndalesat e vendosura më 1972, që Kuteli pati fatin e keq, po edhe fatin e mirë, të mos i njihte.

Ndër ndryshimet renditim:

foljet **kish** dhe **ish**, janë bërë kudo **kishte** dhe **ishte**;

trajtat si **nisi të tregojë, kërkoi të flasë**, etj., u bënë kudo **nisi të tregonte, kërkoi të fliste**, etj.;

u vendos ë në fjalë si **piksëpari**, që u bë **pikësëpari; kqyrte-këqyrte; tridhjet-tridhjetë; n'atë çast-në atë çast**, etj.;

ja (ja thashë), u bë **ia**;

fjalët si **vëndi, qënë**, u bënë **vendi, qenë**;

emrat **rrëfenjës, mësonjës**, u bënë **rrëfyës, mësues**;

parafjala **tek**, shumë herë është bërë **te**;

Në botimin e dytë u ndryshuan dhe disa fjalë që në të folmen e përditshme nuk përdroreshin më në ato trajta, si **komedinë**, u bë **komodinë, doli-doli**, (folja **dal**), **arqitekt-arkitekt**, etj.

Si përfundim, bie në sy, se ata që kanë punuar për këtë botim (s'janë shënuar emra korrektori e redaktori), në përgjithësi janë përpjekur të bëjnë sa më pak ndërhyrje.

Ndryshe ndodhi me ribotimin e veprave të zgjedhura të Gorkit më 1986, kur redaktori Jorgji Doksani mori përsipër të përmirësojë punën e përkthyesit. Ndërhyrjet e tij ishin të të gjitha llojeve dhe preknin leksikun, sintaksën, pikësimin, madje duke dëmtuar shpesh dhe besnikërinë ndaj origjinalit. Këto ndërhyrje, edhe kur janë të barasvlefshme me trajtat e botimit të parë, dëmtojnë shumë vrazhdë kompleksin tingëllor të fjalisë, sjellin kakofoni, hiatus e përsëritje fjalësh.

Po renditim ndryshimet e lehta:

foli, bëhet **tha**, **pra** bëhet prandaj, **gazi** bëhet **gëzimi**, **porta e kështjellës**, bëhet **dera e kështjellës**, **udha** bëhet **rrugë**, **siç është**, bëhet **si është**, etj.

Disa ndryshime të një lloji tjetër:

e nuk më vjen keq bëhet **e nuk ka për të më ardhur keq** (originali rusisht është në kohën e tashme); **vajzë po vajzë paska qenë**, bëhet **vajzë po vajzë qenka**; **kjo fytyrë dukej**, bëhet **fytyra e tij dukej**; **nuk dua të rrish këtu** bëhet **unë nuk dua që ti të rrish këtu**; **të parët e kozakëve** bëhet **më të moshuarit**, etj. etj.

Redaktori bën shumë herë ndryshime krejt të kota aq sa vihet në dyshim dhe vetë arsyeja e ndërhyrjes dhe shembujt që sollëm këtu janë një pjesë e papërfillshme e masakrës që është bërë mbi përkthimet e Kutelit në këtë seri të Gorkit. Kësaj nuk i kanë shpëtuar as shenjat e pikësimit, ndryshimi i të cilave shpesh ka ndryshuar ritmin e të folurit të personazheve, madje dhe kuptimin e fjalisë. Kuptohet, në këto ndërhyrje nuk është fjala për drejtshkrim po për një estetikë tjetër, të një njeriu tjetër. Dhe po të ketë ndonjë kureshtar që do të donte të studionte pak këtë fenomen, do ta ftoja të bënte një krahasim të dy-tri faqeve nga Çellkashi, apo Makar Çudra mes botimeve të vjetra e ribotimeve të redaktuara nga Doksani dhe bëj be se do mblidhte material sa për tri referate!

Në mbyllje, disa fjalë për ribotimet nga vitet '90 e këtej.

Disa nga botuesit u çliruan shpejt nga ngurtësia dhe ngushtica që kishin krijuar disa rregulla (të cilat mbase edhe vetë janë vjetruar e duhet të rishikohen) dhe patën guximin ta trajtojnë gjuhën si një mekanizëm të gjallë, që ndryshon e zhvillohet, por njëkohësisht paraqet dhe realitetin gjuhësor të një vendi dhe të një kohe të caktuar (siç kërkonte dhe Kuteli).

Kështu u botua *E madhe është gjëma e mëkatit*, të cilën Kuteli e shkroi me një gjuhë krejt të veçantë, për ta tërhequr lexuesin më lehtë në thellësinë e viteve të shkuara. Po kështu doli edhe botimi i tretë i *Frymëve të vdekura* (botues Onufri).

Më i vështirë është botimi i rrëfimeve të Kutelit, një pjesë të të cilave ai dhe arriti t'i ripunojë në vitet 1960-1965. Ribotimi i tyre është mbështetur në tekstin e fundit të rishikuar e ripunuar nga vetë Kuteli, me shënimet dhe korrigjimet e tij. Kështu, janë ruajtur **qënë**, **qënka**, është ruajtur zanorja **y** tek përemri **ay** dhe emrat **krypë**, **pyperka**, etj. Për disa trajta si **mielli-mjelli**, **dielli-djelli** dhe për bashkëtingëlloren **nj** në të pakryerën e foljeve si **mësonja**, **punonja**, **ja** dhe **ju** për **ia** dhe **iu**, në dorëshkrimet e fundit të Kutelit nuk ka qëndrim të njëjtë kudo, kuptohet, për shkak të trysnisë së madhe të redaksisë së shtëpisë botuese “Naim Frashëri”. Kemi vendosur për variantin e dytë të këtyre trajtave, pas shumë mëdyshjesh dhe me dyshimin nëse kemi vepruar drejt apo jo.

Së fundi, një vrojtim:

Nga puna prej vitesh me krahasimin mes dorëshkrimesh origjinale dhe botimesh e ribotimesh, të Kutelit, po edhe të autorëve e përkthyesve të tjerë, bie në sy largimi në 40-50 vjetët e fundit, i shqipes së shkruar nga ajo e folur. Përpyekjet e gjuhëtarëve për të pajtuar parimin morfologjik me atë fonetik, ka shtuar shumë **ë**, që ndërgjegjja gjuhësore e shqiptarit, kur i shikon të shkruara, e ndjen “për detyrë” t'i lexojë. Nga ana tjetër, janë nxjerrë nga përdorimi disa tinguj që dikur shmangnin takimin e dy zanoreve – hiatusin, ose apostrofet, që pengonin zvarritjet e gjuhës. Tashmë në rregullat tona gjuhësore s'ka asnjë rregull që të mbrojë shqiptimin. Prandaj, mbase ka ardhur koha që në diskutimet e gjuhëtarëve të hyjë edhe tema e drejtshqiptimit dhe më fort ajo e pasqyrimin në shkrim të anës fonetike të gjuhës.

Kjo do të nxirrte edhe më në pah vlerat e veprës së shkrimtarëve, gjuha e të cilëve jo vetëm lexohet, por edhe tingëllon në veshët e lexuesve. Dhe mbase do të shtonte vlerësimin dhe dashurinë e shqiptarëve për gjuhën shqipe.

8 qershor, 2007

Enver GJERQEKU

MITI NË “TREGIME TË MOÇME SHQIPTARE” TË MITRUSH KUTELIT

Nga krijimtaria letrare e Mitrush Kutelit, për temën e shtruar në këtë tryezë shkencore të Seksionit të Gjuhësisë dhe Letërsisë të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë zgjodha veprën e shquar *“Tregime të moçme shqiptare”*.

Kjo vepër e rrallë e llojit të vet kapërthen njëzetepesë tregime, të cilat Mitrush Kuteli, nga lënda e baladave, e rapsodive dhe e legjendave popullore edhe me pikënisje historike”, është përpjekur t’i kthejë në prozë – në tregime. Në parafjalën e vet të këtij vëllimi, Mitrush Kuteli, me modestinë e vet të njohur si një njeri dhe krijues i mirëfilltë i artit letrar, pohon: *“Doemos, duke u kthyer në tregime, pra në prozë, baladat dhe rapsoditë kanë humbur shumë nga bukuria dhe nga freskia e tyre, nga hovi këngëtar, nga ngjyrat e shumta të poezisë. Shkurt, kanë humbur thelbin e tyre poetik. Aty ka mbetur vetëm skeleti apo zhvillimi i ngjarjeve, ndërsa është zhdukur tërë endëshmëria magjepsëse e poezisë”*.

Mirëpo, një krijues me vlera jetëgjata të larta e të dëshmuara në letërsinë tonë shqiptare, si poet, novelist dhe studiues i pasionuar i letërsisë sonë, i njohur si mbëltues i gjuhës sonë letrare, për disa dekada të shekullit të kaluar, na duket se ka qenë i padrejtë dhe bukur i rreptë ndaj vetvetes. Por modestia dhe qëndrimi i tij ndaj vetvetes është shprehje dhe vlerë e moralit dhe e ndjenjës së përgjegjësisë, që e shquajnë Mitrush Kutelin.

Lëndën që e mori nga epika popullore dhe “e ktheu në prozë duke krijuar, jo vetëm një prozë origjinale dhe magjepsë, por tërë asaj vepre madhore të krijuesve (këngëtarëve) anonimë, i dha një infuzion

e gjak të ri. Në tregimet e Mitrush Kutelit, të atij grupi që i thonë *Poezi*, që qarkullon magjiplotë ai “skelet” është ngjallur me mish, me zemër dhe me shpirt të atyre personazheve mitikë dhe legjendarë, të trimave dhe heronjve me cilësitë më të bukura njerëzore, si dhe ngjarjeve dramatike dhe të magjishme shpirtërore, në shtigjet dhiare përbinjoreje, trimëritë mitike madhore dhe fismëri të shpirtit shqiptar. Fatet e personazheve janë të lidhura me qeniet mitike: me zanat e orët dhe me shtojzovallet, që jetojnë nëpër bukuritë përrallore të natyrës; në pyjet e larta e të dendura me dru të llojllojshëm, në lugina e sheshe të gjelbra përrallore, me gurgullimë të përrenjve të rrëmbyeshëm, me burime të pashtershme gurrash, ku shuajnë etjen zanat dhe trimat, që kthehen nga luftërat dhe dasmorët që kalojnë gjithandej të lodhur e të plagosur. M. Kuteli relievin e tokës shqiptare e përshkroi me peizazhe romantike-realiste. Elementi romantik anon kah ai mitik – përrallor, ndërsa ai realist kah njerëzit e thjeshtë, modestë dhe të varfër. Muji dhe Halili ishin barinj, që ndiznin zjarrin, mbathnin dhe shalonin kuajt, ndërsa Ajkuna, sikurse malësoret e zakonshme, shkante në mal për dru dhe kryente detyrat e shtëpisë.

Kjo vepër, pas parafjalës, fillon me tregimin “*Rozafati*”, që ka për bazë baladën legjendare të kalasë së Shkodrës, Drishtit, Bashtovës a të Elbasanit dhe të urave: *Ura e Fshejtë* – afër Gjakovës dhe *Ura e Artës*. Flijimi i njeriut – veçanërisht i gruas, është elementi më i dhembshëm i zakoneve dhe i miteve shumë të lashta të besimit dhe botëpasurimit njerëzor. Këtu shpaloset besa e shkelur nga dy vëllezërit e mëdhenj ndaj më të voglit, i cili nuk i tregoi në mbrëmje gruas së vet, se për çfarë kishin biseduar dhe lidhur besën, për të murosur një rënë prej grave, që ura të ketë stabilitet dhe të mos rrënohen muret pas këtij flijimi.

Përshkrimi i qëndrimit të paluhatshtëm i nuses së vëllait të vogël është moralisht madhështor, nga njëra anë, dhe, nga ana tjetër, tronditës shpirtëror, për faktin se ajo pranoi të muroset, por kërkoi syrin e djathtë, dorën e djathtë, gjirin e djathtë dhe këmbën e djathtë t’ia lënë jashtë murit, pasi kishte djalin e vogël dhe sa herë të qante, ta shikonte, t’i jepte gjë, ta ledhatonte dhe ta përkundte djepin e djalit të vogël.

Këtu ndeshen dy vlera morale: ajo e larta dhe ajo e ulëta – besnikëria – dhe tradhtia – virtyti i lartë dhe morali i ulët.

Në tregimin „Besa e Konstandinit“ e Mitrush Kutelit, që është hartuar sipas dy baladave arbëreshe: të *Doruntinës*, që këndohet në Sicili, dhe të *Garentinës*, që këndohet në Kalabri, janë shkrirë në një të vetme. Ajo që ka më shumë dhimbje, më shumë psherëtimë, me një përgjëratë dhe përdëllim shfaqet ajo e *Doruntinës*, pasi vetëm nga familja e saj janë vrarë dymbëdhjetë vëllezërit për mbrojtjen e Atdheut.

Doruntina është martuar me pëlqimin dhe propozimin e vëllait më të vogël – Konstandinit, që ishte i dymbëdhjeti vëlla dhe kishte vetëm një motër – Doruntinën e bukur mbi të gjitha shoqet, të njëmbëdhjetë vëllezërit nuk ishin bashkë me t’ëmën të një mendimi, që të mos e martojnë diku larg Doruntinën. E ëma donte ta kishte afër Doruntinën. Konstandini i premtoi e ia dha besën t’ëmës se do t’ia sjellë Doruntinën, sa herë të donte e të kishte nevojë për të. Por në luftë për mbrojtjen e atdheut u vranë të dymbëdhjetë vëllezërit. Nëna shkoi te varret e të bijve. Mbi çdo varr bëri nga një vajtim. Por mbi varr të Kostandinit e thirri tri herë...Kostandini zgjohet nga varri dhe ia solli t’ëmës Doruntinën...Në fund, kur edhe Doruntina merr vesh se janë vrarë të dymbëdhjetë vëllezërit, nga pikëllimi i madh plasin të dyja, nënë e bijë.

Sipas një balade tjetër, Mitrush Kuteli hartoi prozën “*Besa e Halil Garrisë*” e ngjashme me atë të arbëreshëve “Besa e Kostandinit”. Janë të ngjashme për nga vlerat estetike, por, siç thotë autori, “ndryshojnë për nga rrethanat jetësore dhe historike, që ndryshojnë nga ato të baladës së arbëreshëve, pasi këtu ka mjaft elemente të moralit islamik”.

Në një motërzim të kësaj balade, thotë autori, thuhet se vëllezërit janë grindur dhe janë vrarë njëri me tjetrin. Kjo pasqyron luftërat vëllavrasëse te populli ynë në një periudhë shumë të gjatë historike. Megjithatë, dashuria e vëllezërve për motrën e tyre të vetme është shumë e madhe, e sajuar me mjete lirike.

Për çka e shquan këtë vepër të Mitrush Kutelit në krahasim me veprat e autorëve pa emër të këngëve epike?

- Poezia epike popullore është poezi e mirëfilltë e popullit, që jeton me shekuj – brez pas brezi – si vlerë shpirtërore e artit të vet. Edhe proza popullore, sikurse poezia e autorëve individualë e të

shkruar, ka vargjet e veta, që e joshin lexuesin dhe e përcjellin gojë më gojë dhe brez pas brezi. Por tregimet e Mitrush Kutelit janë proza poetike, të prozatorit të talentuar me një kulturë të gjerë, me përvojë krijimtarie disa deceniesh si poet, novelist, romancier dhe studiues i letërsisë.

- Në veprën “Tregime të moçme shqiptare“ të magjeps e të mahnit gjuha e pastër dhe e begatë, duke të tërhequr me magjinë e vet fjalë pas fjale dhe tregim pas tregimi. Nga ai “skelet” i mbetur i këngëve epike popullore, të cilat e kanë begatuar me variantet e këngëtarëve të talentuar me ndjeshmëri poetike janë kthyer në një kompozicion me gjeturi të veçantë për secilin tregim, si në portretizimin e personazheve, ashtu edhe në paraqitjen e ngjarjeve që lidhen me tregimin. Çdo tregim, i shkurtër apo i gjatë, shtruar ka në një kompozicion – mbarështim të nevojshëm, që ka fillimin, zhvillimin dhe mbarimin si ngjarja, ashtu dhe personazhet e tregimit. Ai portretizon luftëtarin dhe heronjtë me të tëra tiparet shpirtërore dhe morale, me virtytet dhe veset e tyre, me dashuritë dhe urrejtjet – me bukuritë e natyrës pitoreske ku ata jetojnë, gjallërojnë, luftojnë dhe vdesin natyrshëm, por edhe tragjikisht apo heroikisht në fusha betejash. Ata kanë gëzimet dhe hidhërimet e tyre si çdo njeri, por gati të gjithë nuk vdesin me krye në jastëk. Ata kanë mençurinë që shfaqin në gjuhën e tyre të thjeshtë e të pasur, si shprehje dhe pasqyrim i mendjes së tyre të shëndoshë. Mitrushi e ka pasuruar atë gjuhë të epikës sonë të shëndoshë. Mund të themi se, si mbëltues i këtyre tregimeve është dëshmuar si artist i gjuhës sonë, që krijon neologjizma në një fjalor të pasur të shqipes, me një ritëm, me një muzikalitet, që edhe kur lexohen në heshtje të tingëllojnë magjishëm fjalë pas fjale dhe tingull pas tingulli. Proza e Mitrush Kutelit “**Tregime të moçme shqiptare**” është aq sugjestive, aq e gjallë, aq tërheqëse, sa të krijon një atmosferë shpirtërore, thujse edhe t’i si lexues je një nga personazhet e asaj morie njerëzish të rritur dhe të edukuar, të pajisur me njohuri e aftësi për çdo veprimtari jetësore në një sistem patriarkal, ku nuk ka institucione shtetërore. Në ato kushte e rrethana jetësore, njeriu, që nga fëmijëria e vet, shkollën e vet e ka në odën e burrave, në kullat e ngritura me gurë për të jetuar e luftuar. Në këto tregime të duket se njeriu tërë jetën e vet e çon në ndeshje kundër pushtuesve dhe grabitqarëve, të tokave dhe të pasurive, që

krijohen me mund të madh, me luftëra, trashëgimi këto, që janë të trashëguara nga gjyshërit e stërgjyshërit e tyre.

Në një natyrë të bukur, por edhe të egër, nuk jetojnë e luftojnë vetëm njerëzit e zakonshëm me karakter njerëzor, por edhe me të atillë siç janë balozat, të cilët kërkojnë pasuri dhe gra e vajza të bukura, grabitqarë nga Kralia, të cilëve njeriu i ndershëm dhe punëtor duhet t'u bëjë ballë dhe t'i mundë. Në këtë prozë lexuesi i apasionuar e ndien ulërimën e ndeshjeve, e ndien ofshamën e të plagosurve, përdëllimin e madh të nënave dhe të motrave, që kanë humbur bijtë dhe vëllezërit e tyre në luftëra për mbrojtjen e jetës, të tokës dhe të nderit të vet dhe të grave e motrave të veta. Ky njeri ka edhe gëzimet e veta, kur dashurohet e martohet. Në dasmë marrin pjesë nga treqind dasmorë, që heqin valle nëpër lugjet e verdha. Këta luftëtarë kanë edhe qeniet e veta mitike, të cilat "përcaktojnë" fatet e njerëzve, të popujve, të vendeve dhe të mbretërive e të luftërave të tyre.

Kjo trajtë proze e Mitrush Kutelit e bëri mitologjinë shqiptare më të gjallë, më tokësore, më të afërt, më të kapshme dhe më atraktive për brezat e rinj, që ta mbëltojnë veten me cilësitë më të larta njerëzore dhe kombëtare, të gatshëm për luftë për mbrojtjen e vendit (atdheut), për mbrojtjen e nderit personal dhe të anëtarëve të familjes, me besën e dhënë të pashkelur edhe në rastet më të vështira dhe më të ngushta jetësore, kur u kërcënohet vdekja, me trimëritë e pashoqe dhe të prijësve të mençur, të patrembur e të fismë, që dinë të udhëheqin treqind luftëtarë në ndeshje me armikun, kur kanë në trupin e tyre edhe nëntë plagë të rënda, si Muja e Halili, Gjergj Elez Alia, si Kostandini, (Kostandini i Vogëlthi), të cilët mbrojnë nderin e motrave të bukura me cilësi të larta morale. Këta heronj e trima edhe të plagosur rëndë me nga nëntë plagë të pashërueshme çohen e luftojnë dhe i mundin armiqtë, balozat që plaçkitin vlerat materiale të vendit, ku jetojnë familjet e tyre, gratë dhe vashat e tyre, që ua kërkojnë vashat t'i bëjnë robina dhe poshtërojnë e dhunojnë. Por këta heronj ngrihen çuditërisht edhe nga varri për të mbajtur besën e dhënë sa ishin gjallë, ndaj nënave, ndaj nuseve të saponartuara, madje edhe ndaj vashave të pajisura me bukuri dhe cilësi të larta morale.

Këto ngjarje dhe këto vende me bukuri përrallore të natyrës dhe të njerëzve, në sistemin patriarkal, kur nuk ka pushtet, mbahen dhe mbrohen nga njerëz, që shquhen për trimëri e ndershmëri, që dinë të

organizojnë rreth vetes e kullave të tyre trima të spikatur për zgjuarsi e të fisëm. Këto shtëpi (kulla), që kanë edhe pasuri materiale, kanë në gatishmëri të përhershme nga tridhjetë luftëtarë të shkathtë, të ndershëm, me përvojë, që dinë të përdorin armët: shpatat dhe topuzin e mbi të gjitha janë ngadhënjes. E kur u rrezikohet vendi nga të huajt, atëherë janë të gatshëm e të aftë të mbledhin nga treqind luftëtarë. Edhe kur marrin nuset zakonisht janë treqind dasmorë mbi treqind kuaj, dasmorë që heqin valle e këndojnë këngë kreshnike.

Vendlindja e Mujit dhe e Halilit përcaktohet Klladusha si qendër e Jutbinës. Mujin e quanin Klladushan. Muji e Halili janë trima të lindur, por kanë edhe fuqi mitike. Mujin e kanë ushqyer zanat me tamblin e gjinjve të tyre, që të bëhet më i fortë. Në raste të ngushta ato u ndihmojnë me fuqinë e tyre mitike madhore. Zanat, në ciklin e Mujit e të Halilit, mund të shitojnë dhe të gurëzojnë, të gjithë ata trima, të cilët ua prishin qetësinë ose ua kërcënojnë trojet e tyre fantastike dhe të magjishme, nëse ndokush godit me hir o pahir, i trazon në trojet e tyre. Ato si qenie fantastike nuk kanë e nuk veprojnë në një plan hyjnor: “Ato rrojnë në një botë të përbashkët me heronjtë; bëjnë së bashku një jetë aktive tokësore, duke marrë pjesë madje edhe në ndjenjat intime të njeriut”, thotë autori i tregimeve në veprën e vet “Tregime të moçme shqiptare“. Por duhet të cekim se edhe në veprën e Kutelit “Në një cep të Ilirisë së poshtme” hetojmë mitet më të hershme pellazgo-ilire. Jetën mitike të kësaj kohe na ofron me një përshkrim të magjishëm me një ndjeshmëri poetike, që rrallë kush mund ta stolisë si Kuteli.

Kur thamë se Klladusha ishte qendër e Jutbinës në verilindje të Bosnjës (gati ngjit me territorin e Kroacisë), të marrin si shembull, jo të këndshëm, marrëdhëniet e fiseve ilire: daorsët (ose Daorsonet) u shfarosën nga dalmatët, pasi ishin fis i vogël, që lundronin dhe bënin tregti me grekët nëpër deltën e Neretvës. U zhdukën edhe për arsye se nuk ua paguanin dalmatëve haraçin, por dhe për atë se kishin filluar me të madhe të greqizohen.

Rrënojat e kalasë së këtij fisi ilir gjenden në kodrat e qytezës së lashtë Stollac afër deltës së Neretvës dhe luginës së varrezave të Bogumilëve me stela të mermerta, në të cilat janë të gdhendura epitafe në gjuhën e tyre. Këto epitafe e frymëzuan poetin e Bosnjë-

Hercegovinës për veprën poetike “*Kameni spavaç*” (Gjumash i gurëzuar), vepër kjo që u përkthye nga autori i këtij shkrimi.

Këto plagë të lashta të vëllavrasjeve, të besnikërisë së shkelur dhe tradhtisë, do t’i përcjellin jo vetëm fiset ilire, por, fatkeqësisht, edhe para kohës dhe pas kohës së Skënderbeut, madje edhe vetë Skënderbeun në ngjarjet më dramatike dhe vendimtare të luftërave të tij.

Në tregimet e moçme shqiptare të kësaj kohe kemi më pak elemente mitike sesa të vërteta historike. Edhe këto proza kanë vlerën e tyre të një akribie të shkrimtarit tonë. Edhe këtu janë pikasur personazhet me cilësitë e tyre pozitive dhe negative. Të përmendim vetëm disa nga më të imponuarat për vlerat letrare – estetike, që nuk do t’u mungojnë sa të tjerave këto cilësi: *Arnaut Osmani e Ilysa Radoica, Mrikalemi dhe Dardhojmeli, Vasha e bukur dhe trimi i ushtrisë së Skënderbeut, Milo Shimi dhe Ali Begu, Rina Radhavani, Skënderbeu e Ballabani, Porosia e fundit e Dedi Skurës, Pjetër Shine, e shoqja e Pjetër Shinit* etj.

Por romani më i shquar i kohës së vet, që u laureua me një çmim të lartë në vitet pesëdhjetë është romani “*Skënderbeu*” i Sabri Godos.

Në këtë roman janë shpalosur e kapërthyer në mënyrë brilante tiparet më të shkëlqyeshme të heroit tonë kombëtar – vlerat më të larta morale dhe njerëzore – stolitë e një udhëheqësi – e një strategu që mahniti botën, duke i bërë ballë ushtrisë osmane – ushtrisë më të organizuar që dridhi Evropën. Skënderbeu ishte ajo digë që ndali hovin e rrëmbyeshëm të kësaj ushtrie, që arriti deri në Budimë. Shpëtoi Evropën dhe në tokat shqiptare doli ngadhënjyes i shumë betejave kundër planeve të pashallarëve dhe sulltanëve. Përjetoi shumë ditë ngashënjyese për fitoret e luftërave të veta, por përjetoi edhe hidhërime dëshpëruese, sepse ia kthyen shpinën nipi i vet – Hamza Kastrioti dhe Moisi Golemi – të dy bashkëluftëtarët e vet më të afërt – dy strategë dhe udhëheqës të betejave më të njohura kundër osmanlinjve – që të dytë e tradhtuan Skënderbeun, që ishte i madh edhe si njeri. Dy herë ua fali tradhtinë, sepse ishte zemërgjerë dhe zemërmadh.

Duke përfunduar këtë shkrim, u ndalem një çik te madhështia e heroit të historisë sonë, për arsye se, edhe në kohën tonë, ka pasur dhe

ka patriotë dhe luftëtarë të denjë, por ka pasur dhe ka edhe të atillë, që nuk mund të mburren se i kanë sjellë kombit dhe atdheut tonë ndonjë dobi me veprimtarinë e vet.

Behar GJOKA

PROZA REALITET LETRAR I MËVETËSISHËM

Shkenca letrare e shqipes e radhit Kutelin ndër mjeshtrit e tregimit dhe rrëfimit. Vepra letrare, ku bën pjesë poezia, kritika letrare, përkthimi, proza zë kryet e vendit si literaritet. Proza autoriale dhe studimtaria e shqipes, gjer më tani është kundruar në disa pamje:

A – Si krijimtari e mbështetur fuqimisht në artin gojor. Kësaj ideje i kanë mëshuar F. Zeqo, N. Jorgaqi, R. Elsie, A. Uçi etj. Kjo lidhje është parë si formale dhe si njëra nga vlerat e esenciale të prozës.

B – Lëvrimi i prozës duke huamarrë nga letrarja librore, e ku përafritë kërkohen te Gogoli, Borges, Markez etj., hipotezë e mbrojtur nga A. Plasari, S. Bashota etj.

C – Proza e Kutelit e ndërlidhur me veprën përkthimore të K. Kristoforidhit e të F. Nolit, ide që mbahet nga S. Hamiti.

D – Proza e Kutelit si një realitet letrar i mëvetësishëm, e hedhur nga M. Camaj në idenë se Kuteli është “mik treditësh i rrymave letrare”.

Proza e Kutelit përfshin të gjitha llojet letrare, qysh nga rrëfimi, rrëfenja, përralla dhe tregimi, novelat “Vjeshta e Xheladin Beut”, “E madhe është gjëma e mëkatit”, romanin triologjik mbi Ilirinë. Rrokja e gjithë llojeve, si dhe lëvrimi i prozëshkrimit modern, nuk e kanë penguar të aspironte një realitet letrar të mëvetësishëm.

Është e pashmangshme që të sqarohet koncepti realitet letrar i mëvetësishëm. Çfarë përfaqëson në raport me letraren? Realiteti letrar i mëvetësishëm është shenjë dhe shënjëzim i shkrimit letrar, të vetvetëshëm, ku brenda shkruhet esenca artistike. Realiteti letrar i

mëvetësishëm shërben për të prekur dhe shijuar nivelin letrar, në përjasje me letraren gjithëkohore dhe gjithëhapësinore.

Realiteti letrar i mëvetësishëm në nivel formal ka të bëjë me origjinalen, vetjaken e një autori. Pra, realiteti letrar i mëvetësishëm përfaqëson prurjen e një shkrimtari në marrëdhënie me përvoja të tjera shkrimore. Realiteti letrar i mëvetësishëm bart mbi vete si tipare thelbësore: vetëvetishmërinë dhe vetëmjaftueshmërinë. Vetëvetishmëria si sendërtim i një realiteti letrar, por edhe në procesin e leximit. Vetëvetishmëria shpërfaq lidhjet e ndërlikuara tekstologjike, ku e brendshmja dhe sipërfaqësorja, janë në raporte ndërlidhnie të anasjellë. Vetëmjaftueshmëria, tipari më qenësor i realitetit letrar të mëvetësishëm, në prozën e Kutelit ka të bëjë me praninë e shenjave autoriale.

Realiteti letrar i mëvetësishëm, tekembramja, shënon stilin e shkrimit, i cili rrok nivelet përmbajtjesore dhe fomësuese, larminë e zhanreve. Atëherë, realiteti letrar i mëvetësishëm, shenjon ndryshimin dhe dallimin nga autorët e tjerë. Ndryshimi në mes të shkrimtarëve, si ligjësoni teorike dhe praktikë shkrimore, mund të jetë:

- Ndryshim i paplotë, që buron nga fakti imitues i faktologjisë artistike orale dhe librore.

- Ndryshim i masës mesatare, ku është mjaft e vështirë të prekësh kufirin ndarës.

- Ndryshim thelbësor në mes të teksteve shkrimore.

Në shtegtimin e letrave shqip, gjithëshkrimore, ndryshimet e para janë ligjësoni letrare. Koncepti i Xh. Kaller-it, se “teoria letrare e shkatërron letraren”, përndrit diçka prej karakterit të mëvetësishëm të realitetit letrar. Megjithatë, nuk ka mënyrë tjetër, përpos tejqyrjes teorike, për të zbërthyer praninë e shenjave dhe vlerave letrare, për të zbuluar dhe prekur kodet letrare të secilit tekst.

Gjykimi i Kaller-it, pa dyshim edhe i studiuesve të tjerë si, Barthes, Zhenet, Todorov, Kalvino, Eko etj., mban të ndezur dritën jeshile si interpretimi tekstologjik, kompozicional dhe formësues, i realitetit letrar të mëvetësishëm, përpos diferencës, ka si tipar edhe praninë e shenjave të njëjta dhe të përafërta. Kështu që realiteti letrar i mëvetësishëm ka të bëjë me tërësinë e materisë letrare, por edhe me thelbin vetjak. Realiteti letrar i tërësisë, së prozës së Kutelit, ka të bëjë me shenjat e materializuara.

Realiteti letrar i tërësisë së mëvetësishme, projekton:

- Laryshinë e prozave të thurura prej tij, madje dhe variantet dhe versionet.

- Frymën e plazmimit të qenies njerëzore, shpirtin e botës shqiptare, në prozat që skicojnë karaktere, e kjo ngjet me “Xha Brahua i Shkëmbanores”, “Qysh e Gjeti udhën e Zotit Ago Jakupi”, rrëfenjën “Rinë-Katerinëza”, novelat “Vjeshta e Xheladin Beut” dhe “E madhe është gjëma e mëkatit”, si dhe romani mbi Enkelinë.

- Mjeshtërinë rrëfimore, me tipat e larmishme të rrëfimitarëve, autor, personazh, rrëfimitar i lirë dhe kuvendar.

- Përzgjedhjen e fjalës rrëfyese, përshkrimore, dialoguese, duke e përzierë me poezinë. Këta tregues, përvijojnë të përgjithshmen e realitetit letrar, i cili ndërkomunikon me realitetin letrar përtej kohor dhe përtej hapësinor. Realiteti letrar i tanësisë së mëvetësishme, përbëhet:

Së pari: Nga realiteti letrar oral, që i përket rrafshit të miteve, legjendave, rrëfimeve dhe përrallave. Kjo prani, fryma dhe mendësia e mitizuar dhe legjendarizuar, të shpie vetiu te nocioni i tekstit si paratekst. Dihet, se vepra e Homerit, poemat “Iliada” dhe “Odisea” i kanë rrënjët te mitologjia antike. Po ashtu romani “Don Kishoti” i Servantesit, lidhet me kallëzimet kalorsiake. Dramatika shekspiriane mbështetet në legjendat anglike, edhe “Fausti” i Gëtes buron nga tregimet gjermanike kushtuar doktor Faustit. Prania e tipologjisë së ligjërimit letrar gojor në prozën e Kutelit nuk ka shanse të shënojë përjashtim.

Së dyti: Nga realiteti letrar libror. Prej vatrës së imitimit, krijohet marrëdhënia intertekstuale, ku teksti parak? dhe dytësor brendashkruhen në materien letrare. Kështu ka ngjarë me dramaturgjinë e Eskilit, Sofokliut, Euripidit, “Eneidën” e Virgjilit, që tekstet e tyre letrare, huamarrin në mitologji dhe te Homeri. Udhëtimi në botën e përtejme te “Ferri” i Dantes të sjellë ndërmend heronjtë e Homerit dhe Eskilit, të përkujton kalvarin e personazheve të Kuranit dhe Biblës. Hije të ngjashme përshkojnë tragjedinë “Hamleti” të Shekspirin. Në letërsinë moderne “Ulisi” i Xhojsit realizon një rimarrje të përmbysur, ndërsa letrarja e Borgesit ngrihet duke pasur si paratekst letraren e mëparshme.

Nisur nga prania e dyfishtë e letrares gojore dhe librore, e cila shtegton nëpër tekstet shkrimore, mund të flitet për "... një harmoni polifonike të vlerave estetike" të Roman Ingarden-it, që sugjeron realitetin letrar të mëvetësishëm. Ky realitet, në larminë e prozës është trajtuar në nivel formal. Shpesh është hedhur ideja e meritës së shkrimtarit për mbështetje në legendat popullore. Mbështetja në krijimtarinë popullore nuk është as meritë e as vetëm prani gjuhësore, por përbën një fakt letrar të pashmangshëm:

- Të lidhjes së prozës së autorit me fondin letrar dhe gjuhësor të realitetit?.

- Të lidhjes së domosdoshme dhe të pashmangshme të letërsisë me visaret gojore.

Në këtë situatë të dyfishësisë vjen në ndihmë ideja e T. Todorov-it kur shprehet "Ligji i mospërsëritjes [sado e vështirë që të jetë për të besuar se mund të imagjinohet një ligj i tillë estetikë], një tekst autentik nuk ka përsëritje." [2000 : 16].

Ky fakt ndërlidhnie, ku endet arti i fjalës, nuk zvogëlon Homerin, Eskilin, Danten, Shekspirin etj., madje shënon thelbin e ekzistencës së artit gojor në gjirin e artit të shkruar. Atë që është ligjëSORI letrare, në interpretimin e prozës kuteliane, në disa raste, e vështrojnë dhe e paraqesin si të dyzuar:

Në radhë të parë: Si vlerë e prekshme lidhnie me artin gojëdhanor.

Në radhë të dytë: Si vlerë e mirëpranuar, nga të gjithë studiuesit.

Në radhë të tretë: Si vlerë e përqasjes e rrafshit libror me letraren e kultivuar.

Në radhë të katërt: Si vlerë e krahasimit pa bërë përqasjen e teksteve të ndryshme.

Këto pika shqyrtimore të prozës, tashmë do të duhet interpretuar realisht me argumente në shqyrtimin e teksteve letrare. Pikërisht, nisur prej kërkimit të shenjave artistike, mundësohet edhe sendërtimi i realitetit letrar të mëvetësishëm, i cili bëhet i prekshëm:

- Në praninë e një ndjesie humaniteti, ku njerëzorja kundrohet si altari ekzistencial i jetës dhe lumturisë. Shkrimtari në prozën e shkruar shkrihet midis jetës dhe vdekjes, mes të gjallëve dhe të vdekurve, siç

ndodh me fatin e heroinës së “Rinë – Katerinëzës”. Po në emër të lumturisë shuhet dhe ndizet etja për jetën te novela “E madhe është gjëma e mëkatit”. Humaniteti i përthyer, si pafytyrësi dhe shëmtim në prozën “Vjeshta e Xheladin Beut”, si marrëzi dhe ambicie e tregimit “Lumi i madh”, si lumturi bohemësh në tregimin “Fshati im e pi rakinë”, si tmerr i mjerimit në faqet e novelës “Në fshatin e qepëve”, si kërkim dhe kthim në udhën e zotit, në shinat hyjnorë te “Qysh e gjeti udhën e Zotit Ago Jakupi”.

- Në shtjellimin linear të ngjarjeve, pa harruar edhe përthyerjet e papritura. Regjimi i Xheladin Beut vjen i shkallëshkallshëm, gjersa mbërrihet në zenitin e ndodhisë, kur ai merr vesh se do të përdhunonte të bijën. Rrjedha subjektore e kësaj proze, pavarësisht varianteve të shkruara, është një prej shenjzimeve artistike. Shtjellimi i ndodhisë, e radhit ndër tekstet e rralla të letrave shqipe.

- Në praninë e një hartografie rrëfimore të ngjeshur:

A – Si rrëfimtari i gjithëdijes, ku autori njej, tregon dhe shtjellon universin e tekstit letrar. Rrëfimtari i gjithëdijshëm e sendërton realitetin letrar prej vetes, prej votës shpirtërore individuale, në kërkim dhe materializim të një universi.

B – Si rrëfimtari i jashtëzuar, i cili e braktis gjithëdijen dhe ndërton një realitet letrar specifik. Brendashkrimi rrëfimor, në prozën e shkrimtarit, përveçohet edhe prej grafikës shkrimore. Kjo mënyrë shkrimi është një tipar i pranishëm në prozën e autorit. Brendashkrimi letrar, si spektër rrëfimor origjinal, e zgjeron dhe pasuron tipologjinë rrëfimore.

C – Si rrëfimtari personazh integrohet në prozëshkrim. Rrëfimi i personazhit, dëshmon se proza shqipe po hynte në hullinë e lëvritimit modern.

D – Si rrëfimtari i lirë, i cili përfshihet në materien rrëfimore befasisht. Ky lloj rrëfimtari operon me një leksik bisedor, futet në momentet kulmore për ta shtendosur ngjarjen. Rrëfimtari i lirë, është një gjetje kuteliane.

E – Si rrëfimtari kuvendar. Ky tip komunikimi lidhet me përvojën orale, të një kumti të ligjërimit bisedor. Rrëfimi kuvendim, e shpupuris narratologjinë kuteliane me një tis purpuror. Ajo çfarë e

dallon prej ngjyresave të tjera rrëfimore është ritmi i shtruar, toni patetik, si dhe përdorimi i stilemave të ngurtësuara.

Tipologjia narrative me këto rrafshe është shenja unike e mëvetësisë së prozës së autorit. Autentikja, mëvetësia shkrimore e prozës kuteliane, gjendet edhe në frymën që përcjell, në velin mjegullor të pranishëm në prozëshkrim. Interpretimi i letrares së mëvetësishme sugjerohet nga Jakobson kur nënvizon “Objekti i shkencës së letërsisë, nuk është letërsia, por letrarja, e cila bën që një vepër, të konsiderohet letrare.” [2004 : 48], te libri “Teoria Letrare Moderne”. Autentikja e një realiteti letrar të mëvetësishëm lidhet edhe me përzjerjen e ngjyresave artistike:

- Të një realizimi kritik, si akuzë therëse ndaj realitetit të kohës dhe më përtej tij.

- Të shenjave të qarta fantastike, e ku mbinatyrorja shërben për ta zbukuruar letraren.

- Të shënjëzimeve të pastra të realizimit magjik, si finiturë e lëvrimit të prozës moderne.

- Të ngjyresave të krijimtarisë orale, që e shpërndrit prozën e shkrimtarit.

Shumëngjyresia e pranishme në prozat e shkrimtarit, e rrit gravitetin shprehës. Këto shënjëzime të shumëngjyrta e formatojnë prozën e Kutelit, si realitet specifik dhe i mëvetësishëm. Ligjërata mbi mëvetësinë shkrimore kuteliane, merr kuptim edhe nga sugjerimi i K. Klark kur shprehet: “Koha e veprave nuk është koha e kufizuar e të shkruarit, por koha e pafundme e të lexuarit: hapësira letrare është kujtesa e njerëzve.” [2000 : 62], te libri “*Qytetërimi*”.

Në këtë kuptim, realiteti letrar i mëvetësishëm ekziston si dyfishësi e prurjes me shkrirjen e përvojës së mëparshme, ku personalja shënon thelbin e letrares. Një realitet letrar specifik në pikëpamje të thurjes dhe shpalimit letrar. Shqyrtimi i këtij niveli, madje, mundëson kapjen e veçanësisë, si dhe për të prekur rrafshet e mëvetësisë. Vetjakja, shenja autoriale bart gjedhen letrare të vetvetishme, të vetëmjaftueshme si kumt dhe kumbim artistik.

Ali ALIU

MITRUSH KUTELI PËR POEZINË E LASGUSH PORADecIT

Në vitin 1929, Mitrush Kuteli 22-vjeçar, në një nga shkrimet e para, merr përsipër t'u rekomandojë lexuesve – Gazeta shqiptare në Konstancë – novelën e Papa Kristo Negovanit “Donat Argjendi”. Pasi e cilëson atë si vepër me tendencë pedagogjike – njëlloj Emili, - thotë Kuteli, e përflet shkurtimisht përmbajtjen e tekstit në fjalë...

Po përmendim shkrimet e para kritike të Kutelit për të vënë re se tiparet e fillimit do të ruhen në shkrimet e tij të këtij zhanri për tridhjetë e më shumë vjet, gjatë të cilave, ai do vazhdojë të shkruajë. Ja disa nga këto veçori:

1. Do të lexojë dhe do t'u rekomandojë bashkatdhetarëve të vet vepra dhe autorë, shqiptarë dhe të huaj, që shquhen për misionarizëm, përkatësisht që vihen në funksion të ndjenjës patriotike, kulturore... politike të kombit.
2. Në shkrimet kritike të Mitrush Kutelit shquhet ngjyrimi emocional, me theksim të fuqishëm personal, që përjetohet si jehonë e traditave impresioniste në kombinim me ato biografiko-pozitiviste...
3. Fryma e atdhetarisë do të jetë me përparësi në përzgjedhjen e teksteve për lexim – ato të kenë lidhje të vërtetë me shpirtin e vendit – thotë Mitrushi.

Lindur në fillim të shek. 20, që mban mend dhe e përjeton bërjen e Shqipërisë, jehonën madhore të rilindësve drejt kësaj ëndrre, që do përjetojë marrjen nëpër këmbë të Shqipërisë të saposhpallur, nga të huajt dhe nga vetë shqiptarët e të tjera drama të fillimshekullit

shqiptar, - të gjitha këto rrethana së bashku pra, nuk mund të mos nxirrnin në sipërfaqe një intelektual të ri që shkollohej përjashtë duke qenë dëshmitar i kthesave vendimtare në historinë e kombit, e që para së gjithash ishte i lindur krijues – një nga më të shquarit të letërsisë shqipe. Në korpusin e veçorive të kritikës letrare kuteliane mund të përmendim formimin dhe informimin e tij letrar, sidomos atë ruse të shek.19, që e dëshmojnë shkrimet e shënuara të tij mbi veprën e Gogolit, Turgenjevit, Shevçenkos etj. Shkrimet kritike të Mitrush Kutelit kanë sharm të veçantë gjuhësor dhe, të shkruara nga dora e një krijuesi, me prirje të theksuara eseistike dhe polemike, duke kombinuar gjykimin mbi artin e veprës konkreteme të dhëna karakteristike nga jeta dhe biografia e autorit të veprës, lexohen me ëndje të veçantë...

Kështu, duke lexuar edhe një herë shkrimet e Mitrush Kutelit për poezinë e Lasgush Poradecit, rilexova edhe tekstet e tjera kritike të tij të shtrira në rreth 300 faqe, të cilat të tërheqin spontanisht njëri pas tjetrit qoftë si ekspresion gjuhe qoftë si ngjyrimin emocional personal, qoftë për kulturën e madhe dhe vulën e fuqishme të kohës në këtë fushë.

Shkrim-studimi më i gjatë e më komplet i Mitrush Kutelit (mbi 50 faqe) është ai mbi veprën *Ylli i zemrës* i Lasgush Poradecit, shkruar më 1937.

Në dhjetë faqet e para të studimit Kuteli merret me historikun e botimit të veprës së parë të Lasgushit, *Vallja e yjeve*, më 1933. Pason teksti nga fizionomia bibliografike dhe tekstologjike – variantet në poezinë e e poradecarit. Pjesa më atraktive e këtyre dhjetë faqeve është teksti i titulluar si Një padi letrare ku Mitrush Kuteli shfaq prirjet e një polemisti efikas. Në fakt ai ngre disa çështje që kanë të bëjnë me atmosferën letrare shqiptare të kohës, që tingëllojnë aktuale edhe sot: nuk kemi kritikë letrare në kuptimin e vërtetë shkencor të fjalës, thotë Kuteli. Gjykimet e bëra në shtypin e atëhershëm për veprën e parë të Lasgushit – pra për *Vallja e yjeve*, nuk e hetojnë fare as thelbin artistik e as mendimin e saj, thotë ai. Ç’komentime dhe ç’lavdërata ironizon Kuteli, duke mos i denjuar shkruarit e tillë as emrat t’ua përmendë,

pos Gaetano Petrotës, i cili në librin e tij, botuar më 1931, - për popullin shqiptar gjuhën dhe letërsinë shqipe, pat komentuar edhe ato poezi të Lasgushit Poradecit, botuar deri atëherë në shtypin e kohës. Petrota e lavdëron talentin e poetit të ri dhe e qorton në disa pika, por edhe njëherë edhe tjetrën e bën me fraza të përgjithësuara që mund t'i shkojnë çdo fillestari në këtë fushë, thotë Kuteli, duke mos e kursyer nga ironizimi për “dashamirësinë” e tij ndaj letërsisë shqipe, meqë studimi i tij është një thes që mbledh ç’gjen rrugës dhe që synon t’ua bëjë qefin të gjithëve.

Le të vërejmë me këtë rast se edhe Mitrush Kuteli, duke kundërshtuar dhe polemizuar mendimet e Gaetano Petrotës, përkatësisht duke e mbrojtur poezinë e Lasgushit, kryesisht, shërbehet me argumente të përgjithësuara pa mbështetje në tekstin poetik konkret. Kështu, vërejtjes së Gaetano Petrotës se Lasgushi ngutet, Kuteli i nxjerr faktin se poeti i ri, që nga viti 1921, kur boton poezitë e para dhe deri më 1931, pra kur Petrota e boton librin në fjalë, Lasgushi nuk paskësh botuar më shumë se dyzet vjersha...Pra kjo do të ishte dëshmia e Mitrushit për mosngutjen e Lasgushit në krijimtari.

Po në këtë pjesë të tekstit Një padi letrare, Kuteli zë ngoje edhe përkthimet nga letërsitë e huaja, që bëhen pa asnjë sistem përzgjedhjeje dhe funksioni e që s’komunikojnë fare me shpirtin e vendit, duke e përfunduar këtë kapitull të parë të studimit polemik me Petrotën në shenjë të shpalljes së Lasgush Poradecit si kulmin e artit poetik shqiptar...

Pjesa kryesore e këtij studimi mbi poezinë e Lasgushit, që vjen pas pjesës së tekstit të përfolur më sipër e që sjell të dhëna edhe për ambientin dhe klimën krijuese të Shqipërisë së asaj kohe, titullohet: Vështrim kritik mbi veprën e Lasgush Poradecit.

Ç’pëlqente zëshëm dhe ç’kapërcente heshturazi Kuteli në poezinë e Lasgush Poradecit?

Po nis nga të dytat.

Siç është e njohur, Mitrush Kuteli, në kritikën e vet mbi poezinë e Lasgushit nuk u ndal fare rreth fenomenit variante, aq të shpeshtë në praktikën krijuese të këtij poetit. Në fakt praktikën variante Mitrushi

Kuteli e përmend shkarazi në polemikën me Petrotën, duke iu përgjigjur atij në vërejtjen se Lasgushi nuk i laton sa duhet vargjet e veta: jo vetëm që i merr dhe i rrimet nëpër duar dendur poezitë e veta, por ka raste kur Mitrush Kuteli nxjerr edhe njëzet variante të së njëjtës poezi, siç është rasti me poezinë *Naimi*, si kundër argument në vërejtjen e Petrotës për ngutjen e poetit. Vetëm kaq. Ç’ndodh me poezitë e variantit të parë, ç’pësojnë ato gjatë rishkrimit, sa është fjala për latim të natyrshëm pa e kaluar pragun e lejueshëm, përkatësisht a është i mundur, në laboratorinë krijuese të poetit të përsëritet situata shpirtërore, ndjeshmëria e zënies initiale të frymëzimit të parë edhe gjatë shumëzimit të varianteve poetike në përgjithësi, pra edhe në rastin e Lasgush Poradecit. Fundja, të paktën do të mund të vërehej fuqia shprehëse e artit poetik lasgushian në një krahasim të mundshëm mes ngjizjes së parë dhe variantit si rrjedhim i latimit... Diçka edhe është thënë në shkencën tonë letrare mbi këtë fenomen, aq karakteristik për Lasgush Poradecin, e, megjithatë, mbetet për të thënë.

Çështja tjetër të cilën Mitrush Kuteli e zë ngoje dhe e le në gjysmë të rrugës ka të bëjë me ngritje rëniet poetike të njohura të Lasgush Poradecit. Në një shkrim të dytë të tij për poetin, të botuar gjashtë vjet pas të parit, pra më 1943, me titull “Disa fjalë mbi vjershat e reja të Lasgush Poradecit”, Kuteli do bëjë fjalë për fenomenin. Dhe, pikërisht në këtë shkrim, edhe pse tërthorazi, shfaqet një si distancim nga studimi i tij i viti 1937. Sipas Mitrush Kutelit, meqë shkrimi i parë për veprën poetike është parathënie e librit “Ylli i zemrës”, pra fjala në emër të editorit, autori është përqendruar vetëm në majat poetike të Lasgushit, pa u ndalur tek ato të radhës së dytë apo edhe të tretë, thotë Kuteli. Ai ndien nevojë tani, pas gjashtë-shtatë vjetëve ta bëjë këtë dallim, pikërisht që t’i hapë udhë vetes, në cilësinë tani të lexuesit, jo të editorit, të bëjë disa nga vërejtjet serioze. Ja në të vërtetë për çfarë është fjala: “Vjershat e reja të Lasgushit ne i ndajmë më dysh: një pjesë e shkruar me tonin madhor të poezisë dhe pjesa tjetër e një inspirete minore, dekadente”, do të shprehet Mitrush Kuteli në vitin 1943. Nga ky korpus vargjesh minore ai do të sjellë si shembull edhe strofat:

Nuk janë këngë vjershërie
 nuk janë vjersha këngërie,
 po janë iskra vjershërie,
 po janë gjëmë djalërie,
 dhe janë lotë vashërie...

Me këtë rast nuk po komentoj ndarjen dhe klasifikimin e tillë të poezisë së Poradecit nga ana e Mitrushit, por dëshiroj të vërej mungesë konsekuence. Lexuesit të studimit kutelian do t'í bjerë në sy se, kur ai shkruan për poetin si editor, vargjet e tilla, - vjershat e rimat zinxhir, monotone, vargjet e ngjashme me të cituarat më sipër, që ngjajnë me paratë e prera aq dobët sa edhe kovaçi i fshatit mund t'í falsifikojë - citojmë gjithnjë Mitrush Kutelin, mund të gjejë edhe te poezitë, të cilat ai, në cilësinë e editorit, i kalon me notën më të lartë, si, për shembull:

Trimi ç'paske dhëndëruar
 vasha ç'paske nusëruar,
 zotin ç'paskan lavdëruar,
 jetën ç'paskan trashëguar,
 shpirtin ç'paskan shenjtgëtuar, etj.

Krejt kjo sikur le të hapur diç të pa thënë deri në fund. Natyrisht që Kuteli ka të drejtë kur thotë se shkrimtarët, edhe më të mëdhenjtë, maten sipas kulmeve të veta, sipas tavaneve që i vënë vetë, por kjo nuk e përjashton mundësinë, të mos themi edhe nevojën, për të zënë ngoje edhe ato të dorës së dytë apo të tretë, siç i emërton vargjet e kritikuara Kuteli. Çështja, ndërkaq, është më e thellë: a është fenomen i rëndomtë, e natyrshme luhatja të themi nga majat e artit poetik në fund të tyre, dukuri që te Lasgush Poradeci nuk ndodhi vetëm me vargjet e shkruara gjatë diktaturës, por siç mund të shihet edhe para luftës së fundit, pra para vitit 1943...

Cilin rreth tematik lasgushian preferon Mitrush Kuteli.

Kur kemi parasysh filozofinë e tij mbi artin përgjithësisht, është e natyrshme që pjesa më joshëse për të, në poezinë e Lasgushit do të jetë lirika patriotike, para asaj refleksive dhe erotike, që janë tri shtyllat e frymizimit që i veçon ai në këtë vepër poetike të shqipes.

Atdheu fizik dhe metafizik – thotë Kuteli, është matrica prej nga burojnë edhe poezitë filozofike edhe ato erotike të Poradecit. Dashuria e poetit për Shqipërinë fizike, për relievin gjeografik, male fusha liqere e dete, Poradeci e Mali i Thatë, janë ato që frymëzojnë Lasgushin, edhe për emocione intime, erotike edhe për përsiatje refleksive, beson Kuteli... Ndërsa atdheu metafizik, sipas Kutelit, është shpirti i traditës nëpër shekuj, frymë nga e cila thith frymëzimin poeti...

Është e qartë, pra, se Kuteli e kërkon dhe sipas tij e gjen me çdo kusht atdhedashurinë si inspirim të parë të poezisë lasgushiane. Dhe refleksi më i qëlluar do të thosha është ideja, bindja e Mitrushit është ai mbi lirikën patriotike moderne të Lasgushit: “Lasgushi krijoi një mistikë të re të dashurisë së atdheut, pa kujtuar fare në vargjet e veta argumentet e vjetra ballkanike, si thika, baruti e dyfeku, e të tjera sende kapadaillëku të kujtuar dendur prej sa e sa poetësh”, që tingëllon si i shqiptuar sot.

*Pandeli Pasko KUTELI***VËSHTRIM MBI SHPREHJEN E NDJESIVE
SHQIPTARE PËR FE NË VEPRËN E KUTELIT**

Prania e disa besimeve fetare ndër shqiptarë dhe ruajtja e marrëdhënieve vëllazërore mes tyre pa dallim feje ka qenë e mbetet një nga shtyllat themelore të ekzistencës si komb. Për shumë studiues a gazetarë të vendit e të huaj, ky tipar thellësisht shqiptar na është bërë një nga subjektet më të diskutuar. Mund të thuhet se, krahasuar me vendet fqinje, kohët e fundit në Shqipëri e Kosovë po harxhohet shumë më tepër penë e bojë për çështjet fetare. Trajtimi i përkatësisë fetare apo i mbizotërimit të njërës apo tjetrës fe, mjaft herë ka zhvendosur vëmendjen nga çështje mjaft më të ngutshme për zgjidhje dhe ka sjellë lëndime të panevojshme e madje të dëmshme.

Përse sot po flitet e shkruhet kaq shumë për çështjet fetare? Kuteli shkruan: *“Organet e shëndosha ekzistojnë, veprojnë, kryejnë funksionin e tyre dhe nuk ndjehen fare. Të gjithë kemi mëlçi, veshka, sy, por askush nuk i përmend sa kohë që këto nuk janë të sëmura, por veprojnë rregullisht. Nuk flitet për ujë, sa kohë që ka ujë me bollëk për të gjithë. Por flitet shumë atëhere kur uji mungon.”* (Kuteli: Puna ime në fushën e monedhës dhe të bankës, Hylli i Dritës, 3-4, Tiranë, 1994). A thua që shtimi i shkrimeve mbi këtë çështje të jetë tregues i afrimit të ndonjë ngjarje jo të zakonshme ndër shqiptarë? A thua ndokush po kërkon të cysë ekstremizmat dhe të vërë në provë edhe një herë ndjesitë shqiptare për fe? Nuk duhet të harrojmë historinë e 200 vjetëve të fundit në Ballkan: sa herë janë cytur çështjet fetare Shqipëria ka dalë me humbje të konsiderueshme njerëzore e territoriale.

Në të vërtetë, sot shqiptarët po përjetojnë një moment historik shumë të rëndësishëm. Gati 100 vjet mbas daljes së Shqipërisë shtet i

pavarur dhe i copëtuar nga luftërat ballkanike, të cilat kishin për qëllim moskrijimin e një shteti shqiptar (por copëtimin e plotë të tij mes fqinjësh), jemi në prag të krijimit të shtetit të dytë shqiptar. Me gjithë hemorragjinë e pashembullt demografike, sidomos mbas shekullit XV – shtegtime dhe asimilime të shqiptarëve në vise fqinje e jofqinje (për të cilën duhet të zëmë vendin e parë në botë), me gjithë pushtime dhe qeverisje nga pushtetarë antikombëtarë, shqiptarët ja dolën mbanë të bëhen përsëri faktor në Ballkan.

Pa folur për botimin e të dhënave të pavërteta dhe tendencioze e të porositura mbi përkatësitë fetare të shqiptarëve, në diskutimet e sotme duket sikur duar të padukshme nxisin ithtarë të zjarrtë fetarë të valavisin flamuj dritëshkurtër të mbizotërimit numerik, kulturor, patriotik, etj. të feve të ndryshme në periudha të ndryshme. Duhet thënë se kjo është një dukuri e re te ne. Në hapjen e polemikave të tilla nuk u mbajt parasysh porosia e Faik Konicës, i cili me kthjelltësi e dashuri të padyshimtë për vendin, kur trajton çështjen fort delikate të fesë të shqiptarët, këshillon të shmangen debatet nëse konvertimi i shqiptarëve iu sollti të mira apo të këqija me fjalët: *“E meqë historia nuk ecën kurrë së prapthi dhe ne nuk mund ta zhbëjmë të kaluarën, del që është e kotë t’i gërmojmë më tej këto çështje.”*

Kujtojmë se kur krijoheshon qeveritë e para shqiptare nuk diskutohej përqindja e përkatësive fetare nëpër kabinete. Në kabinetin e qeverisë së Ismail Qemalit e kishin të njëjtën peshë myslimanët e të krishterët pa u kushtëzuar nga përqindjet në popullsi. Ky veprim, i cili buronte nga parimet e Rilindjes shqiptare, duket se synonte të korrigjonte sa më shpejt ndarjen e shqiptarëve në qeverisës me fe zyrtare dhe raja, të cilën e pat sjellë regjimi shekullor osman. Ndjesitë shqiptare kënaqeshin kur shihnin Ismail Qemalin të mbante pranë Imzot Nikoll Kaçorin e Luigj Gurakuqin, Faik Konicën përkrah At Fan Nolit, At Anton Harapin përkrah Fuat Dibrës e Lef Nosit. I ndarë në disa vilajete, i përçarë, pa shkolla amtare dhe në prapambetje të plotë, shqiptari vërtet edhe u vra për të huajt për shkaqe të ndryshme, por kurrë nuk luftoi vëlla me vëlla për çështje feje.

Asohere vargjet e Vaso Pashës *“Feja e shqyptarit asht shqyptarija”*, përkrah vargjeve të Naimit, Çajupit dhe rilindësve të tjerë, patën ngjitur mirë në ndërjegjen e shqiptarëve.

* * *

Në këtë mjedis historik e kulturor u rrit e mbrujt Mitrush Kuteli i lindur më 1908 në një shtëpizë të vogël në Pogradec. Në vatrën familjare, aty ku gatuheshin dashuria për atdhe, tolerancat etnike e fetare, Kuteli njohu qysh në fëmijëri si shtypjen e pushtuesve të ndryshëm kalimtarë dhe disa patriotë të mëdhenj shqiptarë. Më vonë ai vetë shkruan:

“...i ndjeri im atë ka qenë një nga përhapësit e parë të librit shqip në rrethin e Pogradecit, që në kohën e Turqisë, përpara hyrietit..”

Dhe më tej:

“..Babai u bë për shumë kohë ndërlidhës në Shqipërinë e mesme. I thoshin me të tallur “shqiptari” dhe e kishin burgosur shumë herë në kohën e Turqisë (dhe më tej në kohën e okupacionit serb e bullgar) për çështjen shqiptare. Shtëpia jonë bastisej dendur për libra shqip. Po aty, në shtëpinë që sot është gërmadhë, Babai kish pritur herë pas here luftëtarët e kohës: Dervish Himën, Avdyl Ypin, Mihal Gramenon, Telemak Gërmenjin, Memdu Zavalanin (këta tre të fundit i mbaj mend edhe unë), Themistokli Gërmenjin me shokë (Pasa Pemën, Vasil Tromarën) dhe shumë të tjerë.”

Babai i Kutelit kundërshtonte leximin greqisht të ungjillit dhe për këtë arsye nuk shkonte më në kishë aq sa filogrekët e quajtën të mallkuar dhe të vulosur në shpinë nga qoftëlargu.

Një mjedis i tillë familjar, ku vinin rëndom edhe dervishë e hoxhë e ku bisedohej për Shqipërinë e ku fjala shqiptar shembte dhe zgjeronte kufijtë e saj përtej dallimeve fetare, duket se i ka pëlqyer fort Kutelit qysh herët. Një nga këngët e fëmijërisë, të cilën Kuteli e revokon dy herë në rrëfimet e tij (‘Fije nga jeta e Theofil Kostorit’ dhe ‘Më kot..’), është:

Prifti ne mana, / Hoxha ne thana; Jemi vëllezër / S'na ndajnë dot.

Dhe vijon më poshtë te ‘Fije nga jeta e Theofil Kostorit’:

“Kur thesha “prift” sikur më fanitej përpara vetë Papathanasi ynë, me mjekër e mustaqe të kuqëshme si duhani i Elbasanit (ay vetë ish i ardhur nga Elbasani) dhe unë, pa një, pa dy, e vinja të rrijë ne ay mani i zi i arës së Mulla Açes, aty ne Ulica. Edhe hoxhën e kisha zgjedhur: Mulla Arifnë mjekër-thijurin. Po thanën ku e gje? Se thanat ishin larg, përmi gështenja. Dhe gjer atje s’më kish shkelur këmba kurrë. Po kënga ish këngë...”

Të njëjtës periudhë të fëmijërisë i përket edhe kujtimi i një bronkopneumonie të rëndë të mjekuar me gjithë ‘arsenalin’ e mjekësisë së asaj kohe, përfshirë namatisjet e të kënduarat e priftit dhe hoxhës – Papamanasit e mulla Sulit të Rëmënjit.

Në këtë kohë, kur, siç tregon Kuteli, dëgjonte këngët e kënduara më shpesh nga Nëna, janë bërë mbase edhe skicimet e para të personazheve tashmë fort të njohura të letërsisë shqiptare si Ago Jakupi, Kapllan Aga i Shaban Shpatës, Malush Agaj, Bendo Shapërdani, Argjir Vlonjati, Xha Brahua i Shkumbanores, Asim Qerimi nga Kosova, Xhezari nga Devolli e shumë të tjerë.

* * *

Kuteli rrëfen e duke rrëfyer shpalos karaktere e situata të natyrshme në marrëdhëniet mes shqiptarëve myslimanë e të krishterë. Me delikatesë e ndonjëherë edhe me tone didaktike, Kuteli i përshkruan me të njëjtën dashuri personazhet e tij e sidomos marrëdhëniet vëllazërore mes tyre. Një mënyrë e veçantë dëshmimi se të krishterë e myslimanë shqiptarë janë një, është paraqitja e poemit kosovar me pseudonimin Izedin Jashar Kutrulija. Edhe këtu ai ndoqi shembujt e mëparshëm të Trank Spiro Beg (alias Faik Konica) apo Bilbil Rushit Gramshi (alias Fan Noli). Por identifikimi i Kutelit me

shqiptarin e Kosovës nuk merr fund me përzgjedhjen e pseudonimit të radhës. Kuteli e vendos atdheun përmbi fenë, koncept i cili vështirë se pranohet nga ata që studiojnë kanunet fetare e që rrahin të gjejnë sa më shumë ndryshime mes feve. Në Poemin kosovar të krijuar pas shëmbëllit të poezive të Nolit, siç e pranon edhe vetë (Poeti Fan S. Noli, vështrim panoramik, Mall e Brengë, Tiranë, 1943), Kuteli “*gdhend në krastë*” dhe këndon:

*Jam kosovar
pra jam shqiptar,
Zot e krenar,
- Zot e bujar -
mbi këtë dhe
q' e kam si fe
e përmbi fe:
E kam Vatan!
e kam Atdhe!*

Brenda kësaj poeme Kuteli – Izedin i thotë vetes Asim Qerim dhe shtjellon një nga tragjeditë e shumta familjare kosovare:

*Ma thonë emrin Asim Qerim,
mbetur jetim
që n'vogëli.
Se babën tim ma vranë
naçallnikët,
podpuruçnikët
edhe gllavnikët*

*Ma vranë,
Se urdhër dha Vojvodi
e Krali- vetë:*

*Të vritet
Se ish Kosovar!
Dhe se ish zot
mbi këtë Dhe.*

Ashpër e sulmon Kuteli pushtuesin serb, i cili shtypte dhe organizonte shpërngulje të njëpasnjëshme të shqiptarëve nga trojet e tyre, po ama asnjë fjalë kundër fesë, mbasi feja pat qenë veç një nga instrumentet e përdorur. Mesazhin e këtyre vargjeve e vërtetuan edhe një herë luftërat e fundit në Kosovë e në Ballkan, qëllimi i vërtetë i të cilave ishte pushtimi i territoreve dhe jo feja, por ama i fshehur bukur mirë nën petkun fetar.

Në rrëfimet e Kutelit vriten edhe peshkopë edhe myftinj, por kurrsesi për fe, por si armiq të përpjekjeve shqiptare për pavarësi.

Larg cilësimit të shqiptarëve si orientalë, Kuteli flet për një specifikë shqiptare, të cilën Perëndimi nuk e kupton. Në parathënien e ‘Sulm e Lotë’ lexojmë:

“Kështu janë edhe njerëzit. I vështron të veshur thjeshtë, i dëgjon të flasin thjeshtë dhe sa thesarëkanë në shtëpitë e tyre, në shpirtin e tyre!”

Në rrëfimin ‘Lugetërit e fshatit tonë’ elementi përrallor e magjik gërshtetohet me të përditshmen; disa të vdekur bëhen të prapë, kthehen mbi dhe e vijnë e turbullojnë të gjallët. Çdokush mund të gjejë në këtë rrëfim alegoritë që do t’i pëlqenin (edhe me ditët e sotme), po Kuteli përsëri tjerr fillin që e ka fort për zemër: të krishterë e myslimanë mblidhen e shtrëngohen pranë njëri-tjetrit, vuajnë së bashku, mundohen githë bashkë të largojnë hijet e rënda e zullumet e lugetërve. Citojmë:

*.. qirinj pe dylli, në kishë e në xhami.
Të shkrojtura an’e kënd, në prift e hoxhë.*

Ose më tej:

Dha urdhër të falet gjithë robi sikush pas besës së vet – bes'e Krishtit mënjane, bes'e Muhametit më tjetër.

Kuteli rrëfen mjedisin shqiptar me përpikëri, pra rrëfen edhe një aspekt krejt normal për Shqipërinë: miqësinë e fortë mes të krishterëve e myslimanëve, shpesh të trashëguar brez mbas brezi. Kështu, Komi Poçari është në mbrojtje të kapedan Kajo Babjenit, trimat Bendo Shapërdani dhe Suli Aga Starova luftojnë e fitojnë bashkë kundër ushtrive të sulltanit, etj. Një i huaj, qoftë edhe ballkanas (e mbase edhe më shumë nëse është ballkanas), e ka vështirë të kuptojë këtë mesazh. Aq më pak mund të kuptohet nga mjedisi joshqiptar një personazh si ai i Xha Mihos, i cili përshkruhet në radhën e njerëzve nga të cilët mblodhi folklor në Pogradec ('Këngë e Britma nga Qyteti i Djegur). Ky Xha Miho ose Mihua i Postolit nga Potkozani i Mokrës:

Ushtarëve grekë që i hynë në kohën e luftës e i vodhë shtëpinë u bërtiste turqisht nga dritarja: "jazëk, bre, jazëk – ben kristian".

Në një atmosferë rrëfimesh brenda rrëfimit në 'Natë Qershori', Kuteli shtjellon edhe mekanizmin aq të fortë të kujtesës gojë mbas goje të shqiptarëve, ku familja e Rrapos të Mukes, në miqësi të trashëguar me familjen e Mërtirit po nga Pogradeci, zbulon lidhjet e gjakut me arbëreshin e ardhur nga Italia. Ndërkohë që në kujtesën e trashëguar të familjes së krishterë kanë humbur elementet e toponomastikës së vjetër, këto së bashku me gjenealogjinë e përpiktë të trungut familjar janë ruajtur fort mirë në kujtesën e familjes myslimane nga një grua e moçme me emër tepër të vjetër - Hana.

Në takimin prekës të arbëreshit Mërtir apo 'frëngut', si i thoshin në fshat, me Rrapon e Mukes, valon atmosferë vëllazërimi mes shqiptarësh të ndarë tashmë me qindra kilometra largësi e qindra vjetë ndarje:

- "Ç'u bë i pesti?" pyeti Rrapua. A mos i thoshin Bitri?" Atëhere frëngu u hodh si kaposh, i vuri duart mbi sup Rrapos – "Ku ma di ti Bitrin e Pjetrit?" Edhe Rrapua i vuri duart mbi supet. U shikuan sy në sy: Rrapua kokëthinjur, me mëngore të

bardhë me ato mëngët si kambana të ngushta lart e sa vjen e më të gjëra poshtë, në llërët, me çepkene shajaku, fustane e tirqe të bardhë, me opinga kau. Ay tjetri kokëzi si qymyr gështenje, me rroba kadyfeje nga ato të Frëngjisë, të ngushta, me një si lidhkë në qafë; Rrapua me një palë mustaqe të gjata, të mbushura, të thinjura, të përdredhura gjer rrëzë veshit; frëngu me mustaqe shkrumb të zeza, të qethura anës. Ama të dy burra të mëdhenj, kokëgjatë, të shtypur prapa, ballëmëdhenj, hundë me samar. Ta vishnje frëngun me rroba vëndi nuk ndryshonte fare nga njerëzit tanë. U shikuan, u zunë për qafe: dual kushërinj, një vatre.

Po në këtë rrëfim të gjatë Zafir Furxhiu (evokim i gjyshit të vetë Kutelit) mban me bukë hapsanikët, të burgosurit që luftonin me Dovletin dhe krijon miqësi të reja.

Atmosferë e ngjashme me hidhërime e gaze, të cilën mund ta ndiejnë e shijojnë si duhet veç shqiptarët, na sjell rrëfimi ‘Kapllan Aga i Shaban Shpatës’ me gaze e hidhërime shqiptare. Xha Ndini e Kapllan Aga të cilët duhen ‘si vëlla e shkuar vëlla’ kujtojnë kohët e shkuara e dreka-darkat ku myslimanë e të krishterë mblidhen së bashku rreth sofrës. Por këtu, përkrah gëzimit të kthimit të Destanit nga luftërat e Turqisë, na shfaqen edhe faqe shumë të hidhura të historisë sonë kur shqiptarët shkonin nizamë e vriteshin për të huajt. Destani kthehet gjallë, po si tregon vetë ai:

“Ishim shumë veta nga viset tona. Ca shpëtuam, ca u vranë. Na është vranë aty një Shahin nga an’e Ersekës, një Belul nga Skrapari e nja tre veta nga Gora. Aty u firos edhe Suli i Kapos s’onë.”

Kjo linjë tragjike e vrasjes së shqiptarëve jo drejtpërdrejt për fe, por viktimë të palëve ndërluftuese të identifikuar me fe të ndryshme mbërrin kulmin e vet në tregimin ‘Më kot’, ku shqiptarë myslimanë që luftojnë për Turqinë vriten me shqiptarë të krishterë që luftojnë për Greqinë. Të plagosur për vdekje shqiptar me shqiptar në një fushë beteje, e cila nuk është kurrsesi beteja e tyre, Xhezari nga Devolli e Guri nga Sinica vëllazërohen në orët e fundit të jetës, pendohen për

plagët që i kanë hapur njëri-tjetrit, flasin për nënat që i presin, flasin për fëmijë, por tepër vonë. I tërë tregimi ka për lajtmotiv psherëtimën e fundit të Xhezarit.

- U vramë e u premë vëlla me vëlla. Më kot...

* * *

Pa dyshim që një perceptim më të thelluar të ndjesive për fe Kuteli na e sjell me rrëfimin “Qysh e gjeti Ago Jakupi udhën e Zotit”. Aty gjejmë edhe jehona e përzierje paqësore të besimeve të ndryshme, ku mbizotëron përfytyrimi monoteist i Zotit me pamje njerëzore. Ago Jakupi në ëndrrat e tij gati profetike kujton se takon vetë Zotin. Nga njëra anë, ky është guxim i madh për një vdektar të thjeshtë, por, në anën tjetër, është vetë Kuteli, i cili na e sjell disa herë dëshirën njerëzore për të takuar Zotin. Kështu, në ‘Poemin e Shëndaunit’ nëna shqiptare me foshnje e burrë të vrarë takon Nënë e Zotit, Shërmërinë, shenjtorë e profetë. Edhe Tat Tanushi merr kumtin për t’ardhmen e tij në ëndër ku gjendet përballë Zotit Krisht.¹

Ashtu si popujt e ndryshëm përfytyrojnë Zot e shenjtorë me pamjen e racës të tyre, edhe Ago Jakupi e përfytyron Zotin jo vetëm me fytyrë shqiptare, po madje të veshur si shqiptarët e asaj kohe, me fustanellë. Edhe lutja e Ago Jakupit është e drejtpërdrejtë dhe e thjeshtë:

“- Zot, o Zot, sa i math je!”

“- Hej, Zot me të math tënd!”

... Po shpirtin e ka plot me këto çudit e Zotit...

Dhe

¹ Zoti Krisht – trajtë e vjetër shqiptare e përdorur rëndom edhe nga Mehdi Frashëri në librin e tij ‘Probleme Shqipëtare’ përkrah trajtës tjetër të shqiptarizuar ‘Zoti Muhamet’.

“- Hej, shyqyr, o Zot, hej shyqyr, që më fale edhe një ditë.”

Por besimi në Zot i Ago Jakupit nuk ndalet në fjalë. Nga indiferent dhe i mënjanuar nga problemet e të tjerëve, Ago Jakupi i afrohet rrugës së Zotit në zbatim të mesazhit që i pat sjellë në ëndërr ‘Njeriu nër të bardha me krabë në dorë’:

“- Pajtoju me njerinë, Aga, që të pajtohesh me Zotin, se Zoti i sheh të gjitha, i shkruan të gjitha.”

Dhe Ago Jakupi nis e bën të mira për të tjerët, ndihmon kë mundet, pëson atë që sot quhet edhe ‘konvertim’ dhe këtu qëndron edhe moraliteti i figurës së tij. Na bën fort përshtypje se ky koncept kutelian i konvertimit jo me fjalë, por me punë e me vepra dhe brenda fesë së vet, është shumë pranë me atë ç’ka shprehur Nënë Tereza:

‘Në se bëhemi më të mirë në realitetin tonë indu, mysliman, të krishter apo tjetër, nga që jemi bërë më të mirë i afrohemi gjithnjë Atij. Në se e pranojmë tërësisht në jetën tonë, ky është kthim në një fe.’ (‘Për dashuri të Krishtit’, Romë, 1996).

Duket sikur djepi i këtyre gjykimeve tejet barazuese mes feve është trualli shqiptar dhe ajo urtësi e shqiptarëve, të cilët kanë pranuar me tolerancë fe të ndryshme, pa pyetur nga e si kanë ardhur në këto troje, por duke iu vendosur kushtin e madh të pashkruar të bashkëjetesës e harmonisë mes tyre.

* * *

Të njëjtën temë të ndjesive të shqiptarëve për fe Kuteli e trajton edhe në ese e në shkrimet kritike. Në pjesët ‘Vargje mbi gurë varresh’ dhe ‘Në Prizren midis të vdekurve dhe të gjallëve’ Kuteli përshkruan varrezat ku flenë myslimanë e të krishterë. Lexon e komenton shkrimet mbi varre, ngazëllehë kur gjen fjalën ‘kryshkrim’, fjalë e re

për të, në varrin e Haxhi Rexhep Vaqarit, i gëzohet fjalës shqipe që shkruhej mbi varre edhe në kohë të vështira për të:

Ah, këtu në varret e katolikëve të Prizrenit ka mbishkrime shqipe! Shqipe – në kohën e Turqisë dhe të Serbisë!

Dhe ngashërehet kur gjen strofën e Naim Frashërit aq të dashura për të në një varr tiranas.

Adhurimi i të bukurës nuk njeh kufij feje te Kuteli dhe atij i vjen keq ‘*se nuk di të lëçit mishkrimet me elegante shkronja arabe të varreve të vjetër*’. Më tej, në parathënien e librit ‘Sulm e Lotë’ (‘Një fjalë mbi dy shokë e mbi vepërzën e tyre’), dhe në të njëjtën ese për varret e Prizrenit, Kuteli na sjell përshkrime të bëra me shumë dashuri të xhamive të bukura të Prizrenit – Xhamisë së Sinan Pashës e Xhamisë së Bajrakliut ‘*me minare çuditërisht të hollë si fije kallmër*’. Edhe vitet e fundit, me gjithë censurën e kohës, Kuteli gjen shteg e përshkruan përsëri minaren e hollë të Xhamisë së Zajmit, përballë shtëpisë ku pat jetuar për 14 vjet në Tiranë.

Në një shkrim pak të njohur ‘Si e shohim letërsinë shqipe’, botuar në Revista Letrare më 1944, Kuteli zbulon drejtpërdrejt mendimin e tij lidhur me marrëdhëniet e shkrimtarit shqiptar me fenë:

Cili duhet të jetë qëndrimi i shkrimtarit kundrejt fesë?

Dëgjonani:

Kombësia në raport me fenë është si lënda në raport me trajtën.

Një popull mund të veshë, gjatë historisë, nga pikëpamja fetare, trajta të ndryshme, suksesive apo paralele si mund të veshë edhe rroba të ndryshme.

Për hatrin e trajtës, të veshjes e çveshjes (si njëri heq kapellën e tja tri z bath këpucët kur i lutet Zotit...) ne nuk ndahemi vëlla me vëlla!

Shkrimtari duhet t’i afrojë njerëzit, jo t’i ndajë. Më parë njerëzit e kombit të tij, pastaj komb me komb. Kuptohet vetiu: bashkim e kuptim në caqet e të drejtave të sikujt!

Ky është mendimi ynë.

Dhe në vijën e këtij mendimi kemi për të shkelur natë e ditë.

Dëshmojmë se jemi veriga në zinxhirin e brezave. Jeta nuk fillon me ne, as mbaron (mos e dhëntë Zoti!) me ne. Kemi gjetur gjurma nga të parët e do t'i lemë pas.

Sot, mbas 63 vjetësh nga shkrimi i këtyre rreshtave, porositë e Kutelit i përngjajnë një testamenti, të cilit jo gjithnjë i janë përmbajtur shkrimtarë e gazetarë të sotëm.

Duke komentuar artikullin e Lasgush Poradecit “At Gjergj Fishta, Vazhdimtar në Mendimin e Kombit” (botuar në ‘Shënime Letrare’, 1944), Kuteli komenton thelbin e këtij artikulli e thotë se

“kulmet e mendimit dhe të ndjenjës shqiptare, që janë poetët, kalojnë kufiret e ngushta të fesë të tyre duke kënduar çdo hero shqiptar – i çdo feje qoftë.”

* * *

Në vend të përfundimit do të shënonim sa më poshtë.

Mesazhet e Kutelit lidhur me shprehjen e ndjesive për fe të shqiptarëve janë ende aktuale kur diskutohen përkatësitë fetare dhe marrëdhëniet mes feve të ndryshme në Shqipëri. Këto mesazhe mund edhe të habisin cilindo, të huaj apo vendas, që kërkon me çdo kusht t’u mëshojë ndryshimeve e jo përngjasive mes shqiptarëve me fe të ndryshme, por ato përkojnë me trashëgiminë kulturore shqiptare.

Duke i mëshuar njëjtësisë karakteriale të shqiptarit, pa dallim feje, asaj që Kuteli e quan ‘*specifikë shqiptare*’, ai zbulon indirekt padrejtësitë historike të bëra në shpinë të shqiptarëve, duke i shitur herë si turq e herë si grekë, kryesisht nga politikanët aspak miqësorë fqinjë, nga disa politikanë të Fuqive të Mëdha dhe dhe sidomos nga makina propagandistike shumë e fuqishme e tyre.

Vija e mendimit të Kutelit për ndjesitë fetare të shqiptarëve ec në hullinë e hapur më parë nga Naim Bej Frashëri, At Gjergj Fishta, Faik Bej Konica, At Fan S. Noli, At Anton Harapi, Fuad Bej Dibra, Mehdi Bej Frashëri e shumë të tjerë.

Komentit të Kutelit se “*kulmet e mendimit dhe të ndjenjës shqiptare, që janë poetët, kalojnë kufiret e ngushta të fesë të tyre duke kënduar çdo hero shqiptar – i çdo feje qoftë*” i duhet shtuar edhe fjala ‘prozatorët’, kategori në të cilën hyn edhe ai vetë, duke iu shtuar listës së Lasgushit të *Vazhdimtar-ëve në Mendimin e Kombit*.

Dëshirojmë të shënojmë se ky element i rëndësishëm për paanësinë fetare të një shkrimtari sidomos në Ballkanin e përzier me etni e me besime të ndryshme nuk vërehet në veprat e shkrimatrëve të njohur ballkanas si Ivo Andriç apo Misha Selimoviç, të cilët me të vërtetë e kanë bërë të njohur Ballkanin me veprat e tyre, por ama renditen në mënyra të ndryshme në krahun e një etnie me fe të përcaktuar.

Nëse shqiptarët do të vazhdojnë të kenë ushqim shpirtëror veprat e poetëve dhe prozatorëve *Vazhdimtarë në Mendimin e Kombit*, atëherë kombi shqiptar do ndihet më i fortë përballë sfidave të mijëvjeçarit të tretë.

Mehmet KRAJA

PËRMBI DISA VEÇORI TË VEPRËS “E MADHE ËSHTË GJËMA E MËKATIT...” TË MITRUSH KUTELIT

Përcaktimi i zhanrit

Sapo ta marrësh në dorë për herë të parë veprën e Mitrush Kutelit “E madhe është gjëma e mëkatit...”, më shumë duke parë vëllimin, të krijohet ideja se bëhet fjalë për një novelë. E këtij zhanri shpesh është quajtur edhe nga studiuesit, të cilët në krah të këtij përkufizimi kanë pasur edhe argumente të tjera, siç është subjekti i veprës, linja e thjeshtëzuar e ndodhisë, personazhet e pakta, tematizimi vetëm i një çështjeje etj., të gjitha këto të vendosura përballë një fakti të njohur dhe të pranuar botërisht, se romani është gjëni shumë më komplekse nga ç’ofron argumente kjo vepër e Kutelit që të quhet pikërisht roman. Ky përkufizim mbështetet te koncepti tradicionalist i zhanreve letrare, të cilin, edhe nëse nuk e pranojmë plotësisht, shpesh i nënshtrohemi sipas inercisë. Por “E madhe është gjëma e mëkatit...” e bën roman në konceptin modern të zhanrit diçka tjetër, që nuk ka të bëjë me subjektin, as me temën, as me ndodhinë dhe as me personazhet, por thjesht me një komponente të brendshme të veprës: me dendësinë e madhe të rrëfimit. Është plotënia e rrëfimit ajo që e bën “E madhe është gjëma e mëkatit...” roman në kuptimin e plotë të fjalës. Është ky një rrëfim aq i kondensuar, aq i ngjeshur, sa që, pas leximit sado të shkujdesur, lexuesi e heton plotëninë. Lexuesit nuk i duhet më shumë se kaq rrëfim, as për Tat Tanushin, as për trazimet dhe dilemat e tij shpirtërore dhe mendore, as për përjetimet dhe pësimet e tij, madje as për vendin dhe kohën e ndodhisë. Në të gjitha pikat, referencat e autorit janë substanciale, madje idiomatike. Edhe kur përshkruan, ai është i saktë; edhe kur futet në sferën

dilemore ose meditative, ai është konciz; edhe kur përsërit ndonjë situatë, ai e bën këtë sipas premisave logjike krejt të pranueshme; edhe kur zhvillon dialog ndërmjet personazheve, ai e bën këtë në vendin dhe kohën e duhur. Pra, te kjo prozë e Kutelit, ndryshe nga prozat e tjera të tij, hetohet një plotëni dhe koncizitet i njëhershëm, që në përgjithësi arrihet vështirë te proza e gjatë.

Mistikja dhe premiset meditative

Në këtë prozë të Kutelit ka misticizëm. Madje, subjekti rrëfimor është vendosur në një kontekst fillim e fund fetar. Në një kuptim më të gjerë, rrëfimi është ndërtuar i mbështetur fort te situata biblike e “Këngës së këngëve” të Solomonit. Motivi biblik është bartur në kohë dhe hapësirë, ashtu siç bëhet zakonisht në raste të këtilla. Por, kur bëhet fjalë te ne për misticizmin, në eter sikur ndihet njëlloj refuzimi, kështu që kjo mund të jetë një nga arsytet përse kjo prozë e Kutelit nuk ka arritur t’i vërë nën hije veprat e tjera të këtij autori, veçmas ato me tematikë sociale, ndonëse artistikisht është vepra e tij më e arrirë. Tani shtrohet pyetja e thjeshtë: Përse shkrimtari nuk u dashka të jetë mistik? Përse Kuteli nuk u dashka të marrë për trajtim një tematikë fetare? Arti dhe tematika e tij nuk njohin kufizime të këtilla. Në rastin e Kutelit, mistikja e tij kap esencat e jetës dhe në shqyrtimet e tij në këtë pikë ndodh si me të gjithë shkrimtarët e mëdhenj të përbotshëm: ai shkon një hap më tej se kodi fetar, kërkon shpjegime që nuk i gjen në arsyetimet logjike dhe i kthehet misticizmit si mundësi e vetme për të gjetur shtegdalje. Mistikja e shndërruar në situatë jetësore, kjo është veçoria themelore e kësaj proze. Kuteli, përmes Tat Tanushit, na e thotë vetë në një rast, se ai, pra Tata, gjërave që i lexonte në librat e shenjtë, u jepte “kuptimin e mishit, jo të frymës”. Ndërkaq, në një rrethanë tjetër rrëfimore, ndërsa Tat Tanushi bën dialog me Imzot Nikanorin, në gojën e këtij të fundit Kuteli vendos këto fjalë: “Ato që duken të pamundura me anë të lëndës, bëhen të mundura me anë të frymës”. Por, sikundër mund të vërejmë herë pas here, korniza fetare e rrëfimit, veçmas në planin meditativ, paraqitet e ngushtë, e domosdoshme që të tejkalohet. Janë plot dilema njerëzore, ekzistenciale, të cilat nuk arrin t’i zgjidhë as besimi dhe misticizmi meditativ. Në një rast Tata i thotë Nikanorit: “Kam shekuj që

mendothem, Imzot, mbi çudinë e kulmeve: dielli kur lint i ndrit ata më parë se grykat, kur perëndon vonohet nër ‘ta pas grykave – përse?’ Kjo pyetje dilemore, dhe të tilla si kjo, shtrihen mbi krejt rrëfimin dhe mbi krejt tekstin e kësaj proze. Ndonëse situata e Tat Tanushit gjen një zgjidhje irracionale, dilemat dhe pyetjet e tij racionale vazhdojnë edhe më tej të qëndrojnë pezull, përgjithmonë, si dilema të pazgjidhura për njeriun dhe botën. Kjo prozë e Kutelit është e vetmja e këtij lloji në letërsinë tonë që i shtron këto dilema. Parë në këtë plan, por edhe nga aspekti i misticizmit, “E madhe është gjëma e mëkatit...” e Kutelit zgjeron rrethin tematik të prozës shqipe dhe letërsinë tonë e vendos në të njëjtat rrjedha me letërsinë evropiane të shekullit XX. Po të ishte botuar në kohën kur ishte shkruar, kjo prozë e Kutelit do të kishte rol emancipues dhe modernizues për letërsinë shqipe, e cila për shumë kohë realizmin e shekullit XIX e konsideronte si vlerë identifikuese.

Lirizmi, teksti, gjuha

“E madhe është gjëma e mëkatit...”, sikundër e thamë edhe më parë, është ndërtuar mbi një eksplikim lirik të motiveve biblike të “Këngës së këngëve”. Lirizmi, për nga mënyra se si e shpërndërron racionalen, qëndron krejt afër mistikës. Prandaj mund të thuhet se Kuteli në këtë prozë e ka gjetur mënyrën e përshtatshme të lidhjes së tematikës me tekstin dhe gjuhën. Në të vërtetë, Kuteli ndërton një tekst lirik mbi një tematikë mistike dhe këtë model e gjen jo vetëm në Dhjatën e Vjetër, por më shumë në vetë natyrën e lidhjes së pashkëputur të shenjës gjuhësore me argumentin. Ai e heton këtë lidhje organike dhe prandaj tekstin e ndërton mbi premisa krejtësisht lirike dhe meditative. Dilemat e Tat Tanushit janë ekzistenciale, ekzistencialja e pashpjegueshme është misticizëm, misticizmi i ngritur në nivel gjuhe është poezi. Mbase për këtë arsye, lirizmi në këtë prozë të Kutelit duket i natyrshëm dhe krejt organik me rrëfimin. Megjithatë, në disa raste, Kuteli si prozator lirik do të dalë jashtë kësaj skeme, veçmas atëherë kur shpërthimet emocionale kërkojnë barasvlerën e tyre tekstore. Në rrethana të këtilla, Kuteli bëhet lirik i papërmbajtur, ta zëmë, siç është rasti i përshkrimit të Liqerit të Ahridës, pra Liqenit të Ohrit, që në të vërtetë është një odë më vete kënduar natyrës, nga

më të bukurat në letërsinë shqipe. Zhdërvjelltësia dhe figurshmëria e gjuhës, që Kuteli e zotëron në krejt prozën e tij, në rastin e “E madhe është gjëma e mëkatit...” merr disa konotacione paralele. E para, ajo është gjuhë e lirizmit të thellë, me depërtime të forta emocionale. E dyta, ajo është gjuhë e nocioneve abstrakte, që vendos korrelacione filozofike ndërmjet premisave themelore ekzistenciale. E treta, ajo është gjuhë e aktualizimit të vokabularit mistik dhe arkaik, veçmas atij biblik. E katërta, ajo është gjuhë-model, se si koineja lokale ngrihet në nivelin e tekstit të kultivuar artistik. E pesta, ajo është gjuhë që krijon drejtpeshim të palëkundur ndërmjet tekstit dhe kontekstit.

Si e këtillë, proza “E madhe është gjëma e mëkatit...” mbetet vepra më e arrirë e Mitrush Kutelit dhe njëra nga veprat më të rëndësishme të prozës shqipe. Po u mor për bazë data kur është shkruar kjo vepër, sot do të mund të pohonim pa shumë hamendje, se proza moderne shqipe fillon shumë kohë më parë se ajo të promovohet nga diskursi kritik dhe studimor për letërsinë tonë.

Sadik BEJKO

NJERIU NË PROVËN E MËKATIT DHE TË NDËSHKIMIT TE TREGIMET “ATË SERGEJ” I L. TOLSTOIT DHE “E MADHE ËSHTË GJËMA E MËKATIT” I MITRUSH KUTELIT

1. Njeriu dhe mëkati

Tregimi *Atë Sergi* i Leon Tolstoit dhe *E madhe është gjëma e mëkatit* i Mitrush Kutelit trajtojnë jetën e dy klerikëve ortodoksë: të Stepan Kasatskit, me emrin fetar atë Sergi, në tregimin e Tolstoit dhe të priftit Tat Tanushi në tregimin e Mitrush Kutelit. Vëmendjen më të përqendruar autorët e drejtojnë mbi raportin e një kleriku me mëkatin dhe mbi rrugët e shpëtimit prej tij, pra, trajtojnë temën e përsosjes së njeriut.

Çështja e mëkatit mbetet nga nyjat më të rëndësishme të të gjitha religjoneve. Sipas hebraizmit, mëkati është rebelim ndaj perëndisë, ndaj mëkati lahet me gjak, me jetë.

Edhe për krishterimin njeriu është mëkatar nga natyra, por Krishti në kryq pagoi me jetën e tij mëkatet e gjithë njerëzimit dhe e bashkoi njeriun me perëndinë. Njeriu nëpërmjet besimit vihet nën hirin e perëndisë. I krishteri mëkaton, pendohet, e rrëfen mëkatin dhe hiri, dashuria qiellore, e shpëton. Ky hir hyjnor shpëton edhe kriminelët më të mëdhenj, kur ata venë kokëulur para perëndisë. Madje këta plangprishës të penduar perëndia i do ca më shumë nga të tjerët.

Në teologjinë induiste shpirti i njeriut vdes e ringjallet pandërprerje në trupa të tjerë, derisa, me provat që ka dhënë, është pastruar dhe e meriton të pranohet në Nirvanë.

2. *Dy klerikë mëkatarë*

Stepan Kasatski (Atë Sergi) i Tolstoit, fisnik, oficer i ri, që po ngjitej në majat e karrierës dhe të shoqërisë së kohës, pas një zhgënjimi në dashuri, rreh të gjejë strehë në kishë. Vesh rrasen e murgut, pastaj mbyllet eremit në një shpellë të humbëtirave ruse. Vitet e thinjat nuk e përkulin: mbetet ekstremisht i rreptë me veten dhe krejt i kyçur në botën asketike. Një vejushë e bukur e shtresës së lartë i vjen qëllimisht në shpellën e eremitit. Për të shmangur mëkatimin me të, Atë Sergi pret me sëpatë gishtin e madh të dorës. Fama për shënjtërinë e tij merr dhenë. Por demonët nuk janë jashtë te bota që e kishte mohuar, janë brenda tij. Një vajzë 22-vjeçare me mendje fëmije, që ia kishin sjellë në strehën e eremitit për ta shëruar, e tundon dhe atë Sergi... mëkaton.

Braktis jetën kishtare, bëhet pelegrin dhe zbulon se kushërira e tij, Pashenka, që i shërbente me nënshtrim familjes së saj me shumë halle dhe që shkonte rrallë në kishë, ishte më e shenjtë se ai dhe se sa gjithë ç'ishin fetarë. Fundi i tij është Siberia. Gjen paqe si shërbëtor i zotit, pa emër, pa identitet, tek punon kopshtin dhe u jep mësimet fëmijëve të një muzhiku.

Te *E madhe është gjëma e mëkatit* Tat Tanushi, prift dhe artist, është i lumtur me kishën dhe me gruan e tij. Mitrush Kuteli e thyen këtë lumturi me vdekjen e gruas së dashur. Kjo e lëkund rrënjësisht personazhin si njeri dhe si klerik. Më tej Tat Tanushi mëkaton me një grua tjetër dhe pas kësaj mbi të bie mallkimi. Ai do të endet si oshënar dhe eremit për qindra e qindra vjet i mallkuar aq keq, sa edhe vdekja nuk e pranon. Më së fundi, peshkopi Nikanori ia fal mëkatet, Tat Tanushi merr hirin e perëndisë dhe vdes i kthyer sërish në Bubutimën e tij.

3 Prova apo hiri e shpëtojnë njeriun?

Nga sa thamë, vërehen ngjashmëri dhe dallime midis dy tregimeve. Dallimet thelbësore janë dy. Njëri e pranon hierarkinë kishtare si të vetmen strehë shpëtimi, tjetri e mohon atë krejtësisht. Njëri mendon se me prova mund ta rifitosh devotshmërinë, tjetri thotë

se shenjtëria arrihet me shërbime të përlura dhe me dashuri ndaj njerëzve. Nuk blihet hiri me prova, por ai që është i zgjedhur si shëbetor i zotit, jep prova të shenjtërisë.

Tregimet janë në kundërbalancë me njëri-tjetrin dhe brendapërbrenda tyre. Atje ku ndal njëri, e rimerr temën tjetri. Në pjesën e parë Kuteli na thotë se laikja është e shenjtë: dashuria femër-mashkull e përkushtuar gjer në vetëmohim është e tillë. Në pjesën e dytë thotë se e shenjtja është e kanonizuar nga kisha, jo tjetër. Tolstoi në pjesën e parë na thotë se e kanonizuara nuk është e shenjtë. Në të dytën thotë se vetëm laikja që mbron me themel parimet e krishtera, është e shenjtë.

Stepan Kasatski rebelohet dy herë: së pari, ndaj jetës laike, duke kërkuar mbrojtje tek ajo kishtare, dhe, së dyti, rebelohet ndaj jetës kishtare, e cila qenka e mëkatshme dhe e pambrojtur prej mëkatit njëlloj si e para. Në të dyja rastet vendimet i merr nga përvoja e vet. Kishte mohuar botën, por bota e ndoqi deri në shpellën e eremitit. Kishte pandehur se do ta mundte të keqen brenda vetes, por kishte dështuar. Përfundimisht, e pranon veten dhe botën. Për Tolstoin njeriu është mëkatar. Si i tillë ai duhet ta pranojë natyrën e tij dhe të jetojë jetën e përditshme me shërbime deri në mohimin e vetes.

Pra, i shenjti është te njeriu i zakonshëm, te të vegjlit, tek ata që do të fitojnë mbretërinë e qiellit, tek ata që as i mban kush, as e mbajnë veten për të tillë.

Rebelimi i Tat Tanushit vjen se i morën Kalijen, dashurinë që mbase për të ishte më e lartë se sa perëndia. Tat Tanushin e mallkojnë dhe e zbojnë nga kisha urdhra që vijnë nga altari. Ai ngrin, mbetet as gjallë as vdekur, endet që me bamirësi ta rifitojë daljen nga mallkimi. Tolstoi e nxjerr në jetë eremitin mëkatar, Kuteli e kthen në eremit të përjetshëm priftin mëkatar. E kthen ngulshëm te praktika dhe tradita kishtare. Tat Tanushi kështu përçon tezën e traditës së kishës së Lindjes që me prova të pafundme meritohet hiri i perëndisë. Sipas Ungjillit, hiri është dhuratë hyjnore, që kurrë nuk meritohet me fuqitë e njeriut. Po të ishte për provat (Atë Sergi i Tolstoit), edhe njeriu më i ashpër me veten do të dilte i humbur.

Tolstoi ka qenë i çkishëruar nga kisha ruse e kohës se ishte për kthimin e besimit te thjeshtësia ungjillore, te ngjashmëria me ndjekësit

e Krishtit (peshkatarë, muratorë, gra të dyshimta), të cilët në jetën e përditshme ishin njerëz të gabueshëm, por edhe të shenjtë se i pranonin dhe pendoheshin për mëkatet.

Dallimet janë edhe në formën edhe në botën e tregimeve. Si Tolstoi edhe Mitrush Kuteli u referohen shkrimeve të shenjta në tekstet e tyre, por gjithmonë në shërbim të atmosferës poetike të Kuteli dhe të zbulimit realist të jetës së personazhit të Tolstoi. Tolstoi i përmbahet poetikës së realizmit, ngjarjet në tregimin e tij ndjekin rrjedhën shkak-pasojë. Përmes këtyre ngjarjeve zbulohet imtësisht dhe hap pas hapi jeta shpirtërore e personazhit. Te Kuteli tregimi thuhet në pjesën e dytë e të tretë, mjedisi dhe figura e Tat Tanushit mitizohen, marrin përmasa të reals. Tolstoi është prozaik, Kuteli është poetik në vizatimin e situatave, të personazhit, po edhe në ngjizjen dhe thyerjen subjektore. Tolstoi sistematik dhe epik i jep rëndësi motivimit të mesazhit, Kuteli për nga afëria me elementet poetike e fantastike u shkon më pranë tregimeve të Gogolit. Tregimi i Kutelit përmban zëra hyjnorë, hije të të vdekurve, oshënarë shëtitës, engjëj, aureola drite mbi kryet e personazheve, fërfëllima të pëllumbave (simbole të shpirtit të shenjtë), ikona, numrin dymbëdhjetë etj. Me këto ai e përforcon karakterin thellësisht mistik të kishës së Lindjes. Tolstoi është i thatë dhe fare larg nga kjo mistikë e krishterë.

Nuk e dimë pse Mitrush Kuteli i kushton kaq vëmendje provës. Ungjinjtë japin shumë shembuj të faljes së mëkatarëve. Synimi, me ç'duket, është gjetkë. Edhe shtrirja mitike e ngjarjeve nga hershmëritë ilire e deri në kohët tona, edhe ndëshkimi i konvertuesve (tregimi i Nikanorit mbi Anastasin), edhe shpërblimi pas mundimeve për devotshmëri i njerëzve si Tat Tanushi, e nxjerrin Mitrush Kutelin një mbrojtës të krishterimit tradicional. Theksimi i kësaj vazhdimësie dhe historie të provave të përjetshme e vënë Mitrush Kutelin përballë kohës së tij, kohë që mohonte lidhjet me kulturën tradicionale shqiptare në emër të një bote të re në luftë me gjithçka të vjetër, sidomos në luftë me vjetërsinë në institucionet dhe me besimet të cilat u shpallën armiqësore. Mitrush Kuteli mendonte se kjo kulturë, që ka dhënë prova të mëdha, do të dijë të rezistojë.

Për Tolstoin nuk kanë rëndësi as prova, as vetë institucioni i kishës, ai e vë theksin te fryma ungjillore jashtë të gjitha strukturave.

Për Kutelin, për kushtet që iu vunë përpara, jeta do të kërkonte prova të rënda. Dhe Mitrush Kuteli i hoqi ato mbi shpinën e vet.

Por edhe një diçka tjetër: meqë shqiptarët ashtu si Tat Tanushi nuk janë as klerikë, as njerëz të pamëkatshëm, madje janë dhe të konvertueshëm, Mitrush Kuteli kërkonte përsosjen e tyre me prova të larta dhe të pandërprera. Hiperbolizonte që në titullin e tregimit gjëmën e mallkimit të përjetshëm si ndëshkim për mungesë devotshmërie. Atëherë si përsoset njeriu? Me besimin dhe praktikimin e mësimëve të shenjta {Tolstoi}, apo me prova e mundime shekullore të pastrimit sa ta meritojë hirin hyjnor, dheun dhe varret e të parëve si Tat Tanushi? Pavarësisht rrugëve, kërkesa për përsosmërinë e njeriut sot e kurdoherë është një ideal i mirëpritur. Dhe ky është një mesazh i madh i shkrimtarëve që marrin përsipër të jenë mësuesit e popujve të tyre.

4. Femra, ajo që ia përmbys jetën një burri

Femra, sado dytësore, ka rolin e vet në të dy tregimet. Te Tat Tanushi Kalija (Noemi) është e bukura, e dashura, gruaja, frymëzuesja e krijimit artistik. Ajo poetizohet me gjalljen dhe deri me vdekjen e saj. Ajo hyn midis Tat Tanushit dhe Hyjit, duke marrë një vend të parë ose pothuaj të barabartë me Hyjin. Femra e dytë që hyn në jetën e Tat Tanushit, më shumë se sa një personazh është mishërimi i mëkatit që pason mallkimin e gjëmshëm. Simbolizon mëkatin e mishit, i cili i torturon dhe i mposht të dy klerikët.

Te *Atë Sergi* i Tolstoit gruaja është në rolin e demonit më së shumti. Ajo, si edhe te Mitrush Kuteli, ia ndryshon jetën një burri. E fejuara, kontesha Meri Korotkova, ia përmbys jetën Stepan Kasatskit, e bën që të urrejë botën me fund dhe me themel. Sa merr vesh që ajo ishte e përlyer si dashnore e Carit, ky njeri me vullnet të pashtershëm, i jep shkelmin karrierës së shkëlqyer e gjithçkaje tjetër që kishte arritur.

Vejusha e bukur, e cila çdo burri që t'ia vinte syrin, e shihte nën këmbët e saj, e pësoi nga atë Sergi. Ai u gjymtya dhe nuk e pranoi atë. Më tej, kjo vejushë e shtresës së lartë, e penduar për rolin e ulët që kish ndërmarrë, u fut në manastir.

Femra e tretë, Marija, vajza e re, e sëmure dhe fyçkë, e mposhti atë Sergin me lehtësi, me naivitetin e saj. Atë Sergi i dha kështu fund krizës brenda tij: jeta kishtare nuk i kishte dhënë paqen e dëshiruar.

Femra e katërt, kushërira e moshuar Pashenka, Praskovja Mihajlllovna, një njeri jo i përkryer, grua fatkeqe, por e devotshme gjer në flijim ndaj të vetëve, i jep atë Sergit modelin e njeriut që duhet të ndjekë. Ajo ishte me zotin, pa e ditur se ishte e tillë.

Asgjë nuk është poetike te këto gra të Tolstoit, siç është Kalija e Tatë Tanushit e denjë për t'u kënduar sipas modelit të Këngës së Këngëve të Solomonit, e denjë për t'u pikturuar në ikona. Por gjithçka është brenda konceptit të Tolstoit: të mos mitizojë, përkundrazi, të çmitizojë edhe Carin, edhe klerikët e lartë, edhe eremitët e murgjit.

5. Humanizmi: si ta përsosim njeriun

Synimi i Mitrush Kutelit është teologjik dhe nacional (tipare këto të kishës së Lindjes). Mesazhi i Tolstoit është më universal: përsosja dhe kërkimi i së vërtetës është një punë e mundimshme dhe e gjatë, brenda vetes, së pari, dhe pastaj me shërbime ndaj të tjerëve.

Tolstoi ngjan pak me protestanët. Kuteli shkon drejt Dhjatës së Vjetër. Në mos edhe më tej, drejt induizmit, ku duhet të vdesësh e të ngjallesh pa fund, derisa të pastrohesh. Hyji i Mitrush Kutelit ngjan shumë me Jehovain. Mallkimi i Tat Tanushit të çon te mallkimet e lashtësive biblike. Tolstoi fisnikun e vesh me rroba muzhiku. Njeriu i Kutelit, pasi pastrohet, flet me engjëj. Ky njeri është i ndërtuar mbi filozofinë e Kishës ortodokse, mbi teozën, doktrinën mbi njeriun-zot, njeriun në një lartësi me Perëndinë. Ndaj, në fund të tregimit Tat Tanushi dhe Zoti i kërkojnë ndjesë njëri-tjetrit.

Për Tolstoin një njeri i tillë nuk ekziston. Për të bashkimi i njeriut me Perëndinë duhet të realizohet atje poshtë, tek ata që janë krija e tokës, tek ata që rrojnë me mundime, pa bujë dhe pa shkëlqim, por që e kanë të nevojshëm si ajrin praktikimin e krishterimit.

Mitrush Kuteli të rrëmben me shkëlqimin gjuhësor dhe me larminë e shkrimit: poetik, alegorik, simbolik, ekleziastik (S. Hamiti, Vepra letrare, 8, faqe 640, botoi Faik Konica, Prishtinë, 2002). Ky tregim i gjatë i Kutelit (disa e quajnë novelë) është kryevepra e tij, është shkruar më bukur se gjithçka para dhe pas saj.

Dhe sidomos ai të prekë me atë se kujt i refrohet me mesazhet e tij. Njeriu mund të jetë i bukur dhe me shumë cilësi, por po që mëkatar, herët a vonë gjëmat do të bien mbi të pafundësisht. Ky trualli ynë dje dhe sot ka nevojë për porosi të tilla morale. Ndaj tregimi i tronditi të gjithë ata që e lexuan dhe shkruan për të. Mesazhi tingëlloi profetik: u lexua mbas gjysmëshekulli ndalese, por në një kohë që kishte nevojë ulëritëse për mallkim dhe ndëshkim të të mallkuarve. Po. Ai Mitrush Kuteli i kishte parashikuar gjërat: do të mbeteni as në tokë, as në qiell, as dheu, as vdekja nuk do t'iu pranojnë. Pastrohuni që ta meritoni vdekjen, dheun e të parëve dhe një varr pranë varreve të tyre. Shoqëria shqiptare ende nuk është e pastruar nga kjo prangë e mallkim-ndëshkimit. Por a e pastron veten njeriu ndonjëherë? A përsoset dot? Ndaj ky tregim do të ketë dhe lexime të tjera.

Së fundi, kjo pranëvënie me Tolstoin na e zbulon më mirë Mitrush Kutelin. Edhe pa pranëvënie të tilla Mitrush Kutelit i mjafton vetvetja dhe vendi i merituar që ka zënë në letërsinë shqipe. Krahasimi me kryeveprat botërore i veprave të autorëve tanë, një porosi kjo, mbase dhe e keqkuptuar e Konicës, do të sillte më shumë objektivitet në gjykimin mbi trashëgiminë e tyre. E them këtë se ende kritika jonë nuk u ka shpëtuar përfshirjes së faktorëve jashtëletrarë në vlerësimet për autorë dhe vepra.

Post scriptum: Takimi me Kutelin

Dhimitër Paskon, alias Mitrush Kutelin, e kam takuar për herë të parë nën një gjysmëterr të zgjatur qershori në një rrugicë të Tiranës. Në rrugicën "Him Kolli". Viti 1965. Gjatë gjithë atij takimi të rastësishëm fizionomia dhe gjithë figura e tij vinte pak si e harkuar, si e shtëmëngur. Shpirt që frymonte përmes një ajri të rralluar. Bimë e prirur, e gatshme për t'u fshirë nga çasti në çast. Një gjallim që njëherësh ishte dhe nuk ishte i këso bote.

Gjysmëterri i gjatë i asaj mbrëmjeje dhe i atyre viteve e bënte edhe më të tëhuajtuar këtë takim. Takim me një shkrimtar, që zyrtarisht ishte dhe nuk ishte i gjallë. E dinte dhe e dinim të tillë: autor i madh, por i botës "së vdekur", mjeshtër i fjalës, por i ndaluar, autor i gjallë nën cipë terri e nënterri. E maktshme të flisje me një që kish

brofur prej andej matanë. Mbase të tillë ma sjellin vitet. Edhe ai, edhe ne sikur nuk donim të ishim të vërtetë në ato çaste. Muzgu që po dendësohej e mpiksej na ndihmonte. Dhe ja (pos të tjerash, pos të tjerash), ja, bomba që ai lëshoi nga goja: lexoni Biblën dhe Kuranin, në doni të dini gjërat më të vyera për humanizmin, më të lashtat. Ju, të rinjtë, t'i lexoni, t'i lexoni patjetër këta dy libra.

Për kohën, porosia ishte pëlçitëse. Mbase shumë herë më surreale se sa ai rrëzim i qetë gjysmëterri mbi tjegullat e qerpiçët e shtëpive të ulëta të Tiranës së atëhershme. Një porosi që gati t'i shqyente sytë dhe trurin. Por sado t'i shqyeje, prapë mbeteshe në errësirë. E para, se nuk kishe ku t'i gjeje libra të tillë. Dhe, e dyta, politikisht ishte gati si të varroseshe për së gjalli, po të lexoje dhe të pranoje filozofi të tilla. Profesorët tanë zyrtarë këta libra i kishin shpallur si kulmi i idiotësisë dhe i mjerimit intelektual. Gjithë takimi mbeti me shijen e atij gjysmëterri të pakontrolluar nga askush, nga ai muzg që po teptisej me shpejtësi, derisa në fund të tij ne nuk mund të shihnim dot se më kë po bisedonim. Mitrush Kuteli e ruajti distancën. Foli si tej vetes dhe fare përtej nesh. I ftohtë dhe neutral. Një zë nga matanë... Donte që modestisht të ishte nën hije, një zë që ia lejonte vetes shkretimin dhe muzgun. Por atë që donte të thoshte, e tha. Pa i dhënë rëndësi mënyrës, përcjelljes, së asaj që foli.

Nga ana tjetër, ai foli në mirëbesim: përpara kishte djalin e mikut të tij të vjetër, Ilon, të birin e Sterio Spasses. Isha dhe unë, që më paraqitën si mik të Spasseve.

Kujtim M. SHALA

ELIPSA: VEPRA LETRARE E MITRUSH KUTELIT

Elipsa: Vepra letrare e Mitrush Kutelit nënvizon kërkimin e diskursin e përqendruar. Vepra letrare e M. Kutelit jepet në nyjat themelore të saj, duke u karakterizuar plane strukturore, tekste të veçanta, duke u lexuar idetë dhe, shpesh, duke u përgjithësuar rezultatet në model teorik.

Elipsa: Vepra letrare e Mitrush Kutelit sintetizon kërkimet autoriale të veprës së Kutelit në një tekst karakterizues/paraqitës.

1. Elipsa: Personi / Shkrimtari

Dhimitër Pasko është Personi; Mitrush Kuteli është pseudonimi letrar i tij.

Dhimitër Pasko lindi në Pogradec, një shekull më parë (1907), dhe vdiq në Tiranë, më 1967. U shkollua në Pogradec, Selanik e Bukuresht.

Në Shqipëri u kthye më 1942.

Më 1947, u arrestua e u burgos. U lirua më 1949. Pas kësaj, u caktua përkthyes te “Zëri i Popullit”; aty punoi deri më 1952. Nga këtu, u transferua në shtëpinë botuese “Naim Frashëri” të Tiranës, në të cilën punoi përkthyes deri në fund të jetës.

Mitrush Kuteli është pseudonimi letrar më i njohur i Dhimitër Paskos. Ai filloi jetën letrare sa ishte në Bukuresht. Është nga tregimtarët themelorë të modernitetit letrar shqiptar. Është autori i

parë në kërkimet shqipe, që botoi libër kritik: *Poeti Lasgush Poradeci* (1937).

Kuteli njihet me rrëfimet e rrëfenjat, me *Poemin kosovar* e *Poemin e Shëndauimit*, me studimet për poezinë e L. Poradecit e të F. S. Nolit.

Proza e tij është një variant i shkollës moderne shqipe. Kodi narrativ i saj buron nga oraliteti e nga *Shkrimi Shenjt*, gjithnjë duke u shpërndërruar/riformuluar nën shtysën e dorës së autorit. Dominon rrëfimi i shtruar, që herë thur ngjarjet e herë rirrëfen rrëfime për ngjarjet. Teksti, në të shumtën e rasteve, ka dy plane narrative (ekstradiegeza e intradiegeza), në raste të shoqëruara me shtresime epidiegetike. Prozën e Kutelit e shoqëron një fill psikologjik. Format e prozës së Kutelit janë tregimi e novela.

Poemat e Kutelit njohin strukturat retorike të poezisë së Nolit, model të cilin Kuteli e pranon hapur. Aty, ai një herë është i ashpër/sulmues, pastaj lirik/vajtues.

Kritika letrare e Kutelit hyn në qarkun e kërkimeve implicite të tipit formalist e të morfologjisë së tekstit. Kuteli interpreton duke analizuar së pari format tekstore. Në planin e metodës, më sistematik është te studimi për poezinë e Poradecit. Kuteli krijoi një traditë leximi të kësaj poezie: format/ estetika e tekstit, përballë shkollës së kërkimit të ideve/ideologemave, përballë leximit ideologjik të letërsisë.

Veprat më të njohura të M. Kutelit janë: *Netë shqiptare* (1938), *Ago Jakupi e të tjera rrëfime* (1940), *Kapllan Aga i Shaban Shpatës* (1944), *Sulm e Lotë...* (1944), *Shënime letrare* (1944), *Tregime të moçme shqiptare* (1965), *E madhe është gjëma e mëkatit...* (1993, e shkruar më 1947).

Kuteli ka përkthyer *Kujtimet e një gjahtari* të Turgenjevit, *Tregimet e Petërburgut* dhe *Shpirtra të vdekur* të Gogolit, *Zotërinj Gollovlinovë* të Shçedritit, ka përkthyer Tolstoin, Gorkin, Nerudën etj.

2. Proza

Kategorialiteti

Prozat e veta, në plan çfarësie, Kuteli i kategorizon *rrëfime* e *rrëfenja*.² Në këtë tipologji, ai u referohet *kodeve tematike* /relacioneve, duke i parë temat e *rrëfimeve* si referenciale/mimetike, ndërsa ato të *rrëfenjave* si fantastike, me burim themelor oralitetin. Strukturalisht/kategorialisht, *rrëfimet* dhe *rrëfenjat* e Kutelit kanë strukturë *tregimi* e *novele*. Kriteri përcaktues (*kodi tematik*) i Kutelit *rrëfimit* e *rrëfenjës* u jep status *variacioni tematik* (të tregimit e të novelës), pra status *intrakategorie*, lloji letrar e jo zhanri. *Rrëfenja*, e parë për nga kodi tematik, hyn në *gjininë fantastike* - gjini kjo tipike për oralitetin. Duket se Kuteli teorikisht vë kufirin ndërmjet *tekstit oral* e *shkrimit autorial*; por, ky i dyti ka përreth (*arkiteksti*) e në trup (*interteksti*) të parin, si një *kujtesë*.

Rrëfenja, gjykuar në këtë princip, nënkupton edhe *përrallën* e *legjendën*. Në llojin e tillë Kuteli nuk rrëfen ngjarje, por rirëfen rrëfime për ngjarjet.

Përcaktuesi *rrëfenjë*, shenjon, së pari, relacionin me *gjenokategorinë*. Funkzioni intertekstual i *gjenotekstit* te proza e Kutelit prek disa nivele tekstore, nga *kategoria* te *diskursi* e *transnarrativiteti*.

Duke pasur si *përparatekst* rrëfenja orale Kuteli shkroi *Tregime të moçme shqiptare*. *Gjenzhanri* i teksteve të këtij vëllimi është: legjendë, këngë kreshnike, epikë historike; që të gjitha në vargje për nga *forma*. Relacioni i tekstit të Kutelit me tekstin oral te *Tregime të moçme shqiptare* është hipertekstual e arkitekstual. Tash, ndryshe nga rastet e tjera, tekstet e *Tregime të moçme shqiptare* Kuteli i çfarëson *tregime*. Ky përcaktues sikur do të theksojë që *teksti* e mund *arkitekstin* e vet. Është tregimi, zhanri i famshëm i literaritetit, që përfitohet nëpërmjet *ritregimit* të *tekstit oral*. Ritregohet objekti *gjeno*; fitohet zhanri letrar autorial; tekstet *rikualifikohen* në *planin arkitekstual*. Por, bota e këtyre teksteve mbetet fantastike (*kodet tematike* e *syzhetë*). Tashmë, kriteri që më parë për Kutelin

² Shih paratekstin e *Kapllan Aga i Shaban Shpatës*, botim i autorit, Tiranë, 1944.

përcaktonte/determinonte *kategorinë letrare*, në këtë rast s'e ka këtë funksion.

Përfundimisht, kriteri kategorializues i Kutelit, më shumë se strukturës kategoriale në gjithë shtrirjen e saj, i referohet temës.

Struktura narrative

Proza e Kutelit, në të shumtat e rasteve, njih dy plane/nivele të *rrëfimit*; njëri i lidhur me Tash, tjetri me Atëherë. Këto plane/nivele rrinë në relacionin *ekstradiegeza / intradiegeza*. Niveli i dytë përdegezohet në nivele të tjera, *degë-nivele*, po në kohën e shkuar.

Rrëfimtari i prozës së Kutelit flet si *Ai* (heterodiegetik) e si *Unë* (homodiegetik). *Ai* lidhet me Tash (*ekstradiegeza*); *Unë*, me Atëherë (*intradiegeza*). Si *Ai* është rrëfimtari tipik; si *Unë* është personazh-rrëfimtari.

Rrëfen Rrëfimtari e jo Autori. Te *Tat Tanushi...*, ai që merr përsipër *t'i shkruajë* (për Ne) dy legjendat pogradecare për Tatën është Autori, por i rrëfen Rrëfimtari, meqë „Rrëfyesi iu beson atyre që rrëfen, madje edhe atëherë nëse rrëfen vetëm *gënjeshtër*. Dhe, njëmend, ai mund të gënjejë, sepse beson. Autori nuk mund të gënjejë. Ai vetëm mund të shkruajë mirë apo keq”.³

Rrëfimi i Kutelit vjen i *gjallë*, si në rrëfimet orale. *Rrëfimi i gjallë*, ai i oralitetit e ai i Kutelit, Personazhin, në një masë, e ofron „të gjallë”, pra si Person. Nga „marrja seriozisht e personazheve fiktive”⁴ çon edhe *relacioni i tekstit të shkruar me tekstin oral. Narrativiteti intertekstual* (rrëfimi i hapur) është rezultat jo vetëm i bartjes së personazhit nga një tekst në tjetrin (nga një rrëfim në tjetrin), por edhe të referencialitetit me *modelin e personazhit* të një teksti/mediumi tjetër. Natyrisht, ky relacion ndërliqësohet përfundimisht nga dialogimi i strukturave narrative. Tipik është rasti i modelit të personazhit të *oralitetit në tekstin e shkruar* (autorial). Jashtë kësaj s'mbetet as *situata narrative*, e cila shpesh e determinon personazhin.

³ Wolfgang Kajzer: *Kush e rrëfen romanin*, në *Çështje të romnait*, Rilindja, Prishtinë, 1982, f. 139.

⁴ Umberto Eco: *Gjashtë udhëtime nëpër pyjet narrative*, Asdreni, Shkup, 1997, f. 228.

Të dy këto nivele, *modeli i personazhit e situata* (tipike për oralitetin), dalin te proza *Rinë-Katerinëza*. Te ky tekst dominon *invarianti* strukturor i rrëfimit oral, i *situatës* e i *zhanrit*. *Rinë-Katerinëza* njeh si paramodel, në nivelet e nënvizuara, përrallën e baladën orale. Aty, komunikimi ndërmjet Të gjallës e Të vdekurit është krejt i natyrshëm; për këtë *situatë*, kërkohet *procedurë* e veçantë. *Rinë-Katerinëza*, në tekstin në *prozë*, ka *vargje* të ndërfitura. Proza është lënë në dispozicion të *rrëfimit*, derisa nëpërmjet poezisë komunikojnë E gjalla me Të vdekurin. Proza për këtë Jetë; poezia për përjetësinë, edhe për lidhjet e kësaj Jete me Përjetësinë. Patjetër, edhe për të shenjuar formën e shpeshtë të fantastikes orale: poezia.

Përgjithësisht, *internarrativiteti* mundësi më të mëdha gjen te tekstet e *kodit fantastik*. Jo pak të tilla shkroi Kuteli. Shkalla/statusi i fantastikes te këto proza është çështje tjetër.

3. Poezia

Sulm e Lotë... është libri poetik i njohur i Kutelit. Është strukturuar në dy tërësi dhe paraprihet nga një koment autorial, me pretendimin për të qenë një tip çelësi për ta interpretuar librin (*Një fjalë mbi dy shokë e mbi veprëzën e tyre*). Strukturimi i tillë u referohet temave e diskursit të teksteve: *Sulm*, e përbërë nga *Poem kosovar* dhe *Balta shqipëtare*, është tërësia e fortë/ashpër, një tip himni; *Lotë*, e përbërë nga *Poemi i Shëndaumit* dhe *Po të vdes në dhe të huaj*, është tërësia e përmallshme, elegjiake e baladike e librit. Diskursi i *Sulm* është substancial; ai i *Lotë* lirik. Kuteli gjëmon e vajton mbi temat e etnisë. Struktura e tillë është shenjë për librin e konceptuar mbi principin e temave/diskurseve e të zhanreve.

Sulm është firmosur me pseudonimin Izedin Jashar Kutrulija, për të shenjuar temën edhe me anë të një emri më tipik për kosovarin. *Lotë* është nënshkruar me Mitrush Kuteli, për të shenjuar një temë jugore (*Poemi i Shëndaumit*).

Sipas paratekstut (*Një fjalë mbi dy shokë e mbi veprëzën e tyre*), *Poem kosovar* duket të jetë shkruar gjatë qëndrimit të Kutelit në Kosovë. Si i tillë, është tekst i emocionit autorial e tekst i empirisë

autoriale. Është poezi e njeriut që njihet e prek plagën e Kosovës. Është vepër e jugorit me zemër kosovari.

Titulli i kësaj vjershe mund të lexohet edhe si përkufizues i zhanrit të saj: *Poem* (poemë). Është poemë me narrator autorial, që deklaron, dëshmon e rrëfen. Shenjat e fabulës s'dalin në trajtën/shfaqjen klasike, sepse tekstit i mungon veprimi. Duke mbindërtuar shenjat fabulative, më tepër se fabulën, hetojmë një *recitim/deklamim* (e retorikë) të narratorit. Ky narrator është edhe personazh i tekstit. Në asnjë gjykim, ky personazh s'është epik. Ai është rezultat i konvertimit të emocionit autorial në simbol e diskurs simbolizues, ndaj është personazh-simbol e personazh simbolizues.

Poema ka pesë pjesë (*këngë*): *Qëndrimi, Durimi, Sulmi, Ndërtimi, Qëndrimi*. Teksti, në planin e diskursit, thuret nëpërmjet *monologut deklarativ* me karakter identifikues; shenjat narrative e lirike dalin bashkë, të shkrira. Ky tip monologimi e mbulon gjithë poemën. Kështu, Kuteli del autor, narrator i identifikuar me kosovarin/subjektin e tekstit; thurës i tekstit e produkt i tij.

Edhe pse tekst i shkruar gjallë, në Kosovë, *Poemi kosovar*, para së gjithash, duhet të lexohet si letërsi. Letërsia e madhe, çfarë është edhe kjo vjershë, i prek përhershmerinë.

4. Kritika letrare

(Libri kritik, metoda, format)

Kuteli, siç u nënvizua, është autor i librit të parë kritik në literaturën shqipe: *Poeti Lasgush Poradeci* (Bukuresht, 1937). Ai botoi edhe një libër tjetër: *Shënime letrare* (Tiranë, 1944).

Kuteli kritik letrar jeton me dilemën mbretërore të kërkimeve/teorizimeve letrare: *Ç'është letërsia?* Kjo dilemë e shoqëron diskursin kritik të tij, qoftë kur merret me tekste e autorë të caktuar, qoftë kur shqyrton fenomene e kur polemizon, si te *Poetë dhe detraktorë*.

Kërkimi i Kutelit, në esencë, është imanent, larg biografizmit, i përqendruar fuqishëm te forma/morfologjia e tekstit. Kuteli lexon formën si esencë të tekstit, trajtat e procedurat, *shkrimin e bukur*. Leximi, nga format e shpie te temat/idetë.

Teksti i Kutelit për poezinë e L. Poradecit prek esencat e poezisë, identifikon sistemin poetik/të strukturimit të tekstit/teksteve/veprës së Lasgushit; dialogon fuqishëm me poezinë, me veçantitë e me sistemin. Shenja e kërkimit të Kutelit, në kuptimin emërtues, del vetëm në titull: *Poetika e Lasgush Poradecit* (me këtë titull është botuar teksti më 1938). D.m.th. nënvizohet Poetika.

Shënime letrare është strukturuar në dy tërësi: e para përbëhet nga kritika për poezinë e Nolit, si dhe nga një numër recensionesh e esesh; ndërsa e dyta, e titulluar *Viti letrar 1943*, është një kronikë letrare/kulturore e Shqipërisë së vitit 1943. Pjesa e dytë është më tepër informative, e përqendruar në shënimin/evidencimin e ngjarjeve letrare-kulturore. Substantivi *Shënime*, i vënë në titull, i përshtatet së pari kësaj tërësie. *Viti letrar 1943* ka status regjistri ngjarjesh, duke i konceptuar ato si manifestime të veçanta të fenomeneve letrare/kulturore. Strukturalisht, tërësia e dytë jep informacione për gjendjen e përgjithshme letrare/kulturore; jep panoramën e librit (botime e ribotime) shqip e të përkthyer; panoramën e revistave dhe të gazetave. Struktura e tillë e bën tërësinë *Viti letrar 1943* një katalog të veçantë të jetës letrare/kulturore. Një tip “sociologjie e letërsisë”,⁵ do ta përkufizojë atë I. Rugova.

Nga shkrimet kritike të Kutelit dalin/përfitohen disa terma/përcaktues: shënime letrare, vëzhgim, analizë, interpretim. Çfarësuesi *analizë* kujtoj të ketë kompetencën më të madhe për të shenjuar kërkimin e Kutelit në sprovat e tij më të suksesshme.

Ndërsa, në kuptimin *statutar*, të kompetencës së kërkimit, karakterizuesi *studim* shenjon llojin e teksteve diskursive themelore të Kutelit. Por, meqë Kuteli ka shkruar edhe tekste të tjera që s’afrohen me studimin, mbetemi te çështja e kompetencës/zhanrit. Zhanre të tjera të kritikës së Kutelit janë: recensionit, trajtesa, eseja.

Duke iu referuar zhanreve të evidencuara dhe duke qenë zhanret shfaqje të formës, kritika e Kutelit njih: formën pragmatike (kritika gazetareske), formën akademike dhe kritikën e shkrimtarëve.

⁵ Ibrahim Rugova: *Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983*, Eurorilindja, Tiranë, 1996, f. 148.

5. Moderniteti

Proza e Kutelit, si ajo e N. Gogolit dhe në përqasje me të, jo rrallë është konsideruar *realiste* - në kuptim të një poetike. Gogoli vështirë se mund të përmblihdhet brenda realizmit.⁶ Novelat/prozat e tij rrënojnë *kodin realist*, për t'u artikuluar si prozë përplot shenja të fantastikes.

Në prozën e Kutelit kufiri ndërmjet Kësaj e Asaj bote relativizohet, zhduket, pastaj rishfaqet si të mos ishte gjë. Personazhet e tij lëvizin nga njëra te tjetra, si në prozën orale. Duke u thyer kufijtë ndërmjet botëve, artikulohet një botë tjetër, fantastike/metafizike, larg *kodeve realiste*, përtej një kohe e ambienti. Shumë përtej procedimit *paraqitës* të prozës e të letërsisë së realizmit, proza e Kutelit artikulohet sipas ligjësive të imagjinatës, të fikSIONIT. Fiksioni kthehet në realitet diegjetik (poetik).

Proza e Kutelit është një variacion i prozës moderne. Mesazhi i veprës së tij është produkt i estetikës dhe në funksion estetik, pa jetuar natyrën bindëse/jashtëletrare. Në krye të saj del novela *E madhe është gjëma e mëkatit...* Për më tej, temat e *rrëfenjave* të Kutelit janë kryekëput të kundërtat e *kodeve tematike* tipike për realizmin. *Kodet tematike*, ndërkaq, kërkojnë *diskurset* e veta.

Duke iu referuar *modusit*, poetikës, M. Camaj karakterizonte Kutelin „mik tri ditësh”.⁷ Për Camajn, Kuteli „nuk i përket asnjë rryme letrare plotësisht”.⁸ Kjo është veçori e modernitetit. Tekstet moderne ruajnë *shenjën e autorit* dhe u largohen „kallëpeve të - izmave”.⁹ Pretendimet për të krijuar iluzionin e referencës, vetëm sa e theksojnë autorin nga një pikë tjetër: si autor/përcaktues të *strategjisë së komunikimit* të marrësit me tekstin.

Relativiteti i përkatësisë në poetika është shenjë e modernitetit letrar. Karakterizimi i autorëve si *modernë* është „i sigurt” aq sa edhe

⁶ Boris Ejhenbaum: *Teoria e metodës formale*, në revistën *MM*, nr. 6-7, Prishtinë, 1997, f. 317.

⁷ Martin Camaj: *Kuteli ende i pazbuen*, në *Jeta e re*, nr. tematik për M. Kutelin, Prishtinë, nr. 5, 1995, f. 587.

⁸ Po aty.

⁹ Po aty.

jo i tillë. Moderniteti funksionon si shumësi variantesh. Variantet, së bashku, japin *konglomeratin poetik*: poetikën/poetikat moderne.

Bibliografi

I.

Kujtim M. Shala: *Shenjat e tekstit*, Prishtinë, 1999.

Kujtim M. Shala: *Kujtesa e tekstit - Mitrush Kuteli*, Prishtinë, 2003.

Kujtim M. Shala: *Miniatura (Logos, Prologos, Metalogos)*, Prishtinë, 2005.

Kujtim M. Shala: *Kuteli i pa/zbulluar*, Prishtinë, 2006.

II.

Ibrahim Rugova: *Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983*, Tiranë, 1996.

Sabri Hamiti: *Vepra letrare 8 (Letërsia moderne)*, Prishtinë, 2002.

Aurel Plasari: *Kuteli midis të gjallëve dhe të vdekurve*, Tiranë, 1995.

Jeta e re, nr. tematik për M. Kutelin, Prishtinë, nr. 5, 1995.

Hasan Hasani: *Leksikoni i shkrimtarëve shqiptarë 1501-2001*, Prishtinë, 2003.

III.

Boris Ejhenbaum: *Teoria e metodës formale*, në revistën *MM*, nr. 6-7, Prishtinë, 1997.

Gérard Genette: *Nouveau discours du récit*, Paris, 2000.

Umberto Eco: *Gjashtë udhëtime nëpër pyjet narrative*, Shkup, 1997.

Volfang Kajzer: *Kush e rrëfen romanin*, në *Çështje të romanit*, Prishtinë, 1980.

Spiro GJONI

KUTELI PROZATOR, POR... EDHE POET

Sa herë është folur e shkruar për Mitrush Kutelin dhe veprën e tij letrare, vëmendja kryesore është përqendruar në vlerat e prozës së tij, në mënyrë të veçantë, në prozën e tij të shkurtër, me rrëfimet e rrëfenjat e papërsëritshme. Shumë pak, studiuesit i kanë drejtuar sytë nga krijimtaria poetike e këtij autori. Por, teksa përballesh me veprën letrare të Kutelit, në tërësinë e saj, nuk mund ta anashkalosh atë pasuri krijimesh poetike që ajo të ofron.

Duke qenë të bindur se vlerat më të qenësishme të veprës së Kutelit shfaqen e i përkasin prozës, nuk mund të mohojmë se vlerën dhe formën e saj të plotë, kjo vepër e shpreh në tërësinë dhe kompleksitetin e saj, ku krahas rrëfimeve e rrëfenjave, gjejmë edhe shkrime publicistike, dhe krijime për fëmijë, edhe përkthime, por edhe poezi mjaft të arrira.

Si gjithë krijuesit, edhe Kuteli hapat e parë i hodhi me vargëzime poetike. Kujtojmë këtu vjershat: “Skënderbeut”, “Mëmës Shqipëri”, të frymëzuara nga dashuria për atdheun dhe ndjenja e krenarisë për figurat e ndritura të kombit shqiptar. Më pas, në vitet e pjekurisë, të cilat përkojnë me përfundimin e formimit të tij intelektual, talenti i Kutelit shpërthen në një tjetër drejtim. Tashmë ai hidhet në fushën e prozës, ku spikat me rrëfimet dhe rrëfenjat. Megjithatë, Kuteli nuk e harroi dhe as e braktisi poezinë. Përkundrazi, ai shkroi gjatë gjithë jetës poezi, duke dëshmuar se dashuria për këtë gjini të letërsisë nuk ishte thjesht një pasion i viteve të tij të rinisë, apo një shkëndijë që u shua shpejt.

Megjithëse frymëzimi i poetit rrok pothuajse të njëjtën tematikë që ai na ofron në prozat e tij, përsëri mund të themi se poezia e tij është e pasur dhe e larmishme. Për sa i takojnë nivelit artistik të poezisë së

Kutelit, do të thoshim se mjafton dhe vetëm një lexim i prozës dhe poezive të tij për të kuptuar se balanca anon dukshëm në anën e prozës. Sidoqoftë, gjejmë ndër krijimet poetike të autorit edhe poezi mjaft të ndjera e me një nivel të lartë artistik. Poezi të tilla si: Balada e pyllit të gështenjave, Kartë nga Shëndaumi, Baltës shqiptare. Po të vdes në dhe të huaj, etj., janë një dëshmi e qartë e individualitetit krijues të Kutelit, në gjininë e poezisë, e cila, duke e cituar studiuesin Nasho Jorgaqi, “është një rrjedhë tjetër në shtratin e gjerë krijues të Mitrush Kutelit”.¹⁰

Vështruar në tërësinë e tyre tematike, krijimet e Kutelit janë historia e popullit tonë, dashuria për atdhe, natyra, jeta e dashuria.

Poezia më e mirë e këtij autori të bind se, në aktin e tij krijues, ai gjithmonë udhëhiqet nga ndjenja dhe, për rrjedhojë, ajo nuk është asnjëherë e kërkuar. Do të mjaftonin vetëm disa vargje për ta kuptuar se ajo është një poezi që buron së brendshmi dhe që, në këtë kontekst, shquhet për lirizmin e saj.

Të të pushtoj
 të më pushtosh
 të të shtrëngo
 të më shtrëngosh
 e të më tretësh
 si gjysh-stërgjyshët
 e si po tret ah, flokëbardhin
 e shtatzhuriturin
 babanë!¹¹

Megjithatë, poezia e Kutelit nuk është vetëm lirike. Të shumta janë dhe krijimet e tij që karakterizohen nga tone epike. Këto tone janë të pranishme kur frymëzimi i poetit ngacmohet nga historia e popullit tonë, nga lufta dhe heroizmi i tij në shekuj, nga ngjarje e figura të shquara të vendit tonë. Në këto raste ngazëllimi, por dhe dhimbja e shpirtit të poetit dalin më në pah dhe uni i tij poetik depërton labirinteve të jetës, ku ndesh

¹⁰ N. Jorgaqi, “Parathënie” – Vepra letrare e M. Kutelit. Tiranë 1990, f. 41.

¹¹ M. Kuteli, “Baltës shqiptare”. Vepra letrare 5, Tiranë 1990, f. 66.

ngjarje e heronj, ku ndeshet me të mirën dhe me të keqen, duke u bërë njëkohësisht bashkëlufëtari me të drejtën, lirinë e humanen, por dhe armik i papajtueshëm me padrejtësinë, dhunën, të shëmtuarën e çnjerëzoren.

Dridhmave të shpirtit të poetit i shkon për shtat dhe drithërima e vargut, e fjalës dhe e mendimit, sepse drama e të tjerëve është dhe drama e autorit.

Kjo dramë është e Atdheut, që lëngon nën thundrën e pushtuesit!

Po ku erdhi italian
 pendërkorbi si shejtani
 ngriti sharrën e sharroi
 ngriti top' e copëtoi
 ndezi zjarr e përvëloi
 gjithë popullin ma shkretoi
 gjithë vendin ma shëmtoi¹²

Është e bijve dhe bijave të popullit që flijohen për Atdhe:

Po gjaku derdhet si rrëke përdhe...
 - Unë, shokë, vdes:
 Kujdes ma kini Shqipërinë.¹³

Drama është në fatin tragjik të këmishëziut dhe fundin e tij të turpshëm:

Kalbet kryqi përmbi dhe,
 Kalbet kërma poshtë tij...
 E pyeta: - Cili je?
 - Jam, -më tha, -këmishëzi.¹⁴

¹² M. Kuteli. "Balada e popullit të gështenjave", Vepra letrare 5, Tiranë 1990, f. 19.

¹³ "Letra e fundit e një djaloshi partizan", Po aty, f. 48.

¹⁴ "Varr milici", Po aty, f. 61.

Kjo dramë shfaqet dhe në mallin e dhimbjen e pafund për vuajtjet dhe fatin e keq të mërgimtarëve:

Sa m'i lumtur jam i fjetur
sesa i mërguar
mot pas moti arratie
zemërcopëtuar...¹⁵

Drama e poetit shtrihet në kohë dhe në hapësirë, duke dëshmuar në këtë mënyrë karakterin dhe përmasat e dhimbshme të saj. Ajo i ka rrënjët thellë në fatin e bashkëkombësve të poetit dhe të atdheut të tij. Aktet dhe skenat e saj, që na shfaqen herë në formën e tragjikes dhe herë në atë heroike, shprehen nëpërmjet një sensi poetik të tendosur.

Sa tmerr o zot, sa tmerr
Ta njomësh pendënë në vrer!
Kaq tmerr të zi e lemeri
Që panë sytë e mi
S'ka parë asnjeri.¹⁶

Natyrisht, ky sens, ka të tjera ngjyime emocionale kur frymëzimi i poetit merr krahë nga ngjarjet lapidare të historisë së popullit të tij. Në këtë rast mendimi i tij shtegton ndër shekuj, kalon nga lashtësia, kur “bardhoshja Teutë ilire”, i preu kokën romakut nopran e vjen te bijtë dhe bijat që u flijuan për gjuhën dhe baltën shqiptare, për lirinë dhe truallin stërgjyshor. Në këto raste ne e ndiejmë ngazëllimin e poetit, i cili vjen e shfaqet si një shkrim dufi e lumturie, por dhe krenarie të ligjshme.

Në poezitë, që marrin shkas nga jeta e përditshme, ky kolorit emocionesh pasurohet me të tjera shfaqje, ku mbizotërojnë tonet lirike. Lumturia, gëzimet dhe kënaqësia e ditëve të reja bartin në

¹⁵ “Po të vdes në dhe të huaj”. Po aty, f. 107.

¹⁶ “Kartë nga Shëndaumi”, Po aty, f. 49.

vargun e Kutelit ndjenjën e besimit dhe optimizmit, duke konstatuar fuqishëm me të kaluarën e rëndë dhe vështirësitë e saj.

Pa dyshim, kjo dukuri konkretizohet më së miri, nëpërmjet një tabloje plot ngjyra, ku mbizotërojnë ato më të ndezurat, në poezinë: “Dje dhe sot në fshatin tim”.

Në fshatin tim, vdekja
ish shtruar këmbëkryq
dhe hante jetën tonë.

Tani, në fshatin tim
nuk bien më
dyfeqe natën
ndër prita hasmërie

tani,
në fshatin tim
nuk vdesin më foshnja të njoma
as djem të rinj, as vajza të reja
as burra në kulmin e moshës

Tani,
në fshatin tim,
të rinjtë dhe burrat
nuk marrin më mërgimet e largëta

Tani,
në fshatin tim
shtëpitë, rrugët, oborret, sheshet
kumbojnë nga këngë fëmijësh.¹⁷

¹⁷ M. Kuteli, “Dje dhe sot në fshatin tim”. Po aty, f. 75-76.

Një tjetër dukuri, e pranishme në krijimtarinë poetike të Kutelit e që ndryshon nga proza e tij, lidhet me praninë në pjesën më të madhe të saj të elementit bashkëkohës. Objekti i krijimeve të tillë si: Balada e pyllit të gështenjave, Balada e udhës nëpër natë, Kartë nga Shënaumi, Pranverë në Enkelanën e re, etj., janë ngjarje apo përjetime bashkëkohëse të poetit. Këtyre mund t'u shtojmë dhe një numër lirikash erotike e të natyrës, të cilat gjithashtu janë reflektim i ngacmimeve që kjo pjesë e botës bashkëkohëse të poetit ushtron mbi të.

Sa iu takon lirikave, do të thoshim se të gjitha ato dëshmojnë që poeti dashurinë, këtë ndjenjë të fuqishme njerëzore, nuk e percepton e as kufizon vetëm në planin intim. Përkundrazi, koncepti i tij për dashurinë shtrihet në një plan shumë më të gjerë, ku përfshihet dashuria për gjithçka të mirë e të bukur që gjallon në këtë botë. Ajo është dashuri për vashën që kish drithëruar e djegur zemrën e poetit.

Kurmi yt porsi pranverë
më jep jetë nëpër dej...
M'u shkëpute përnjëherë
hape perden tejpertej

Edhe hëna e brylltë rrodhi
brenda dhomës si fildish
hovn' e këngës seç ma vodhi
ritm'i hedhurë m'u prish.¹⁸

është dashuri për natyrën:

Dhe një ditë
Një fllad i kaltër
Bëri të plasim gonxhet e fryra
Dhe përnjëmend
Filluan të vallojnë në erë

¹⁸ “Ëndërrimet e një nate Prilli”. Po aty, f. 114.

Flakë të bardha dëbore
 Lart e më lart
 Në qiellin e kaltër.¹⁹

 për njerëzit:

Hutohem shumë: “E mora vesh!
 “Ke një të fshehtë; s’ e nxjerrë shesh.

Ti ke një brumë që s’ e ka njeri
 Dhe ja, ky brumë bën mrekulli.²⁰

Kronologjia e krijimeve poetike të Kutelit përfshin, siç e thamë dhe më sipër, një periudhë të gjerë kohore. Poezitë e para i përkasin vitit 1925, ndërsa ato të fundit janë të vitit 1967.

Brenda këtij intervali kohor, bazuar në dy kritere të ndryshme; (kohor dhe tematik) mund të bëjmë një grupim të poezive. Një grup përfshin poezitë e shkruara në vitet ’20, një grup tjetër ato të viteve ’30 dhe grupi i tretë krijimet e viteve ’60. Përjetimet dhe emocionet që transmeton poeti në secilin grupim janë të veçanta. Në tërësinë e tyre ato iu ngjajnë dritave të ylberit, ku fatkeqësisht është dhe një gri e errët.

Është grija e vuajtjeve dhe vështirësive, jo të pakta, të jetës së poetit, të cilave u shtohen dhe zhgënjimi e pesimizmi i viteve të fundit të kësaj jete. Gjendja shpirtërore dhe fizike e rënduar e mjaft e turbullt, ka ndikuar në unin poetik të autorit, duke sjellë në krijimet e tij (Lutje, Epitaf, etj.) një botë të zymtë, të zvogëluar e të rrudhur tej mase. Është si bota e “vreshtës së vjelë“, veshulët e ëmbël të së cilës; siç shprehet plot dhimbje vetë poeti, - “verë u bënë për ngazëllimin e dëfrimtarëve, ndërsa mbi mua u shtua bryma, që fletën ma ndryshku.²¹

¹⁹ “Pranvera e plepit plak”. Po aty, f. 125.

²⁰ “Shtëmbari”. Po aty, f. 80.

²¹ M. Kuteli, “Hylli i Dritës”, Tiranë 1994/3,4, f. 80.

Jo vetëm “bryma” dhe “fleta e ndryshkur”, por dhe mjaft elemente të tjera poetike të krijimeve të tij, të kësaj kohe, si: litari, skëterra, përdhuna, hekurat, zinxhirët, një vegim i bardhë apo një bardhoshe këmbëlehtë, të cilën poeti e grish që të vijë e ta marrë sa më parë në krahët e saj, të marra së bashku, janë ato që formojnë grinë e errët të koloritit emocional të poezive të viteve '60.

Dihet se, në përgjithësi, jeta e Kutelit nuk pati shumë gëzime. Përkundrazi, në të mbizotërojnë lodhja dhe vuajtjet. Për rrjedhojë, në një periudhë të caktuar, që përkon me vitet e fundit të jetës së tij, ai kërkon të shijojë pak qetësi. Dikush e lodhi, lëndoi dhe e dhunoi në jetë. Dhe ai u përpoq t'i bënte ballë e t'i rezistonte kësaj gjendjeje, por një ditë u lodh dhe e ndjeu veten, deri diku të pafuqishëm. Pikërisht në një çast të tillë, vargu i tij shpreh dhimbje dhe një farë pesimizmi:

O ju që mbeti pas në jetë
Të fle më lini, të fle i qetë
Harresën dua...²²

Kjo thirrje e dhimbshme dhe tronditëse përsëritet, duke bartur mbi vete kësaj here dhe akuzën e fortë ndaj gjithë atyre që e luftuan tërë jetës:

O ju që mbeti pas në jetë
Bini tingullit, siç doni vetë.
Askush s'ju mban dot dorën kurrë
Hidhni gurë, hidhni gurë.²³

Prania e poezive të tilla është tregues i një momenti të rënduar emocional. Tonet pesimiste që karakterizojnë këtë lloj poezie, megjithatë, nuk na japin të drejtën ta quajmë këtë si tipar dallues të poezisë së tij, bile as si tipar karakteristik të periudhës së tretë, sipas grupimeve që bëmë më sipër. Në kundërshtim të një përfundimi të

²² M. Kuteli. Po aty, f. 79.

²³ M. Kuteli. Po aty, f. 79.

ZPillë do të mjaftonte të përmendnim se poezitë e krijuara në këtë frymë, janë një pjesë e vogël dhe e papërfillshme në raport me gjithë krijimtarinë poetike të Kutelit. Dhe në kuadrin e krijimeve të v. 60, mund të themi pa asnjë rezervë se pjesën dërrmuese të tyre i përshkon një tjetër frymë dhe të tjera emocione. Në to gjejmë poetin që mrekullohet dhe krenohet me ndryshimet në vendin e tij, që dashurohet dhe përulet me nderim ndaj njeriut të punës, që i këndon plot ndjenjë dhe lirizëm panjës flakëndezur dhe prillit magjistar, hënës së humbur apo bajames së vogël, gjithë natyrës së bukur dhe njerëzve të mrekullueshëm të vendit të tij.

Gjithçka thamë për veprën poetike të Mitrush Kutelit, duke shtuar dhe faktin se në këtë vepër gjejmë mjaft poezi të ndjera e me nivel të mirë artistik që i kanë rezistuar kohës, na shtyn ta marrim në konsideratë dhe këtë pjesë të trashëgimisë letrare të këtij autori. Si përfundim, do të thoshim se Kuteli e lëvroi poezinë, duke na lënë një pasuri jo të vogël, në këtë gjini. Kjo pasuri ngërthen mjaft krijime me vlerë për gjuhën e tyre tejet të përpunuar, për figuracionin e pasur dhe mjaft të larmishëm, si dhe për idetë e mesazhin që përcjellin. Megjithatë, autori i tyre nuk arriti të mbetet poet për lexuesin dhe për letrat shqipe.

**MITRUSH KUTELI NË
100-VJETORIN E LINDJES**

Botues

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Lektor:

Sheremet Krasniqi

Redaktor teknik:

Valon Fetahu

Realizimi kompjuterik:

ASHAK

Madhësia: 8¼ tabakë shtypi

Tirazhi: 300 copë

Formati: 16x24 cm

Shtypi:

GRAFOPRINT

Prishtinë

Katalogimi në publikim - (CIP)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

821.18.09(063)

929(496.5)(063)

Mitrush Kuteli në 100-vjetorin e lindjes : tryezë shkencore, 8 qershor 2007 / Këshilli redaktues Enver Gjerqeku, Ali Podrimja, Eqrem Basha. - Prishtinë : Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës : Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 2008. - 130 f. ; 24 cm.

Titulli paralel në gjuhën angleze

1. Gjerqeku, Enver 2. Podrimja, Ali 3. Basha, Eqrem

ISBN 978-9951-413-66-4